



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË  
MINISTRINË E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJITIKËS PËR  
KONCESIONIN NË LUMIN DEVOLL**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**MBI PËRPUTHSHMËRINË E PROJEKTIT KONCESIONIT “PËR  
PROJEKTIMIN, FINANCIMIN, NDËRTIMIN, MARRJEN NË PRONËSI,  
SHFRYTËZIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E  
PROJEKTIT TË HIDROCENTRALEVE NË LUMIN DEVOLL NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË ”**

**JANAR 2023**

Nr.	Përmbajtja	Faqe
<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	4
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe opinionin e auditimit	15
<b>II.</b>	<b>HYRJA</b>	17
1	Objekti i auditimit.....	17
2	Qëllimi i auditimit.....	17
3	Identifikimi i çështjes.....	17
4	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	18
5	Përgjegjësitë e audituesve.....	19
6	Kriteret e vlerësimit.....	19
7	Standardet e auditimit.....	21
8	Metoda e auditimit.....	22
9	Dokumentimi i auditimit	22
<b>III.</b>	<b>PËRSHRIMI I AUDITIMIT.....</b>	23
1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	23
2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	23
2.1	<p>Mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit, për realizimin e kontratës së Koncesionit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si Autoritet Kontraktues dhe A. A., S. A. dhe D. H. SHA, si bashkë-koncesionarë, për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Projektit të Hidrocentralit në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë.</p> <p><b>a.</b> Hartimi i detyrës së projektimit nga specialistë të fushave përkatëse (sipas komponentëve të projektit) të Ministrive/Bashkive apo çdo Institucion Publik, të përfshirë, si pikënisje (faza paraprake) e identifikimit të një projekti të mundshëm të koncesionit.</p> <p><b>Studimi i fizibilitetit nga Autoriteti Kontraktues mbi përgatitjen e studimit paraprak të projektit, me të gjithë elementët e saj si dhe përcaktimi i kostos paraprake të projektit. Analiza e faktit nëse projekti i hartuar si një koncesion është ekonomikisht më i favorshëm, krahasuar me alternativën e prokurimit tradicional.</b></p> <p><b>b.</b> Hartimi i studimit për ndërtimin e projektit dhe preventivit të zbatimit për punimet e ndërtimit objekt i kontratave koncesionare.</p> <p><b>c.</b> Ngritja dhe funksionimi i njësisë së zbatimit të koncesionit dhe komisionit të dhënies së Koncesionit.</p> <p><b>ç.</b> Përgatitja e dokumenteve dhe auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të Koncesionit.</p>	23
2.2	<p>Monitorimi dhe zbatimi i kontratës/kontratave të ndërtimit dhe mbikëqyrjes nga Ministrinë/Bashkitë apo çdo Institucioni Publik, të përfshirë në ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Projektit të Hidrocentralit/Hidrocentraleve në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>- Realizimi i projektit të zbatimit, sipas përshkrimit konstruktiv, arkitektonik, funksional dhe teknik të projektit të miratuar dhe të zbatuar.</p>	36

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kryerja e punimeve civile të ndërtimit sipas preventivit dhe projektit të zbatimit dhe metodat e ndërtimit.</li> <li>- Teknologjia e përdorur, përputhshmëria e të dhënave teknike për makineritë dhe pajisjet e vendosura në vepër, me specifikimet teknike të miratuara.</li> <li>- Cilësia e materialeve dhe e punimeve të realizuara në vepër, përputhshmëria e tyre me Kushtet Teknike të Projektimit (KTP) dhe Kushtet Teknike të Zbatimit (KTZ) si dhe standardet përkatëse të PZ. Zbatimi i grafikut të punimeve.</li> <li>- Ndryshimet në projektin e zbatimit, zbatimi i procedurës për argumentimin dhe miratimin e tyre nga Autoriteti Kontraktues.</li> </ul>	
2.3	<p>Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit, administruar nga Institucionet Publike respektive.</p> <p>a. Realizimi i objektivit të përgjithshëm dhe objektivave specifike të projektit, skenarët teknikë dhe ekonomikë në arritjen e objektivave.</p> <p>b. Skemat e implementimit të objektivit të përgjithshëm.</p> <p>c. Ndikimi mjedisor dhe social nga zbatimi dhe vendosja në punë e projektit me objekt “Ndërtimi i Hidrocentralit/Hidrocentraleve në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë”. Përputhja e treguesve mjedisorë dhe socialë me standardet e BE-së për mjedisin.</p>	50
2.4	Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.	56
<b>IV.</b>	<b>GJETJET DHE REKOMANDIMET.....</b>	<b>69</b>

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### 1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (Autoritet Kontraktues) dhe E. A., S. A. dhe D. H. sha (Bashkëkoncesionarë) është lidhur kontrata e koncesionit “Për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll”, në Republikën e Shqipërisë, datë 19 dhjetor 2008, e ratifikuar nga Parlamenti me ligjin Nr. 10083, datë 23.02.2009, e ndryshuar me Shtesën e I të Marrëveshjes Koncesionare të datës 03 gusht 2010, ratifikuar me ligjin Nr. 10337, datë 21 tetor 2010, Shtesën e II-të të datës 19 mars 2013, ratifikuar me ligjin Nr. 105/2013, datë 28.03.2013 dhe Shtesën e III-të, të ratifikuar me ligjin Nr. 7/2015, datë 12.02.2015.

Bashkë koncesionarët “S. A.” dhe “D. H. ” sh.a. janë angazhuar për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin tek Autoriteti Kontraktues të projektit të hidrocentraleve në kaskadën e lumit Devoll, konkretisht HEC Banjë, HEC Moglicë dhe HEC Kokël, dhe Shtesa e III-të e Kontratës së Koncesionit, miratuar me ligjin Nr. 7/2015, datë 12.02.2015.

Centrali i HEC Banjë përbëhet nga 2 njësi të mëdha turbinash F. dhe një njësi e vogël turbine F. me një kapacitet total të instaluar prej rreth 73 MW dhe gjatë vitit 2021 energjia e prodhuar nga HEC Banjë është 258,632 MWh.

Centrali i Moglicës e merr ujin nëpërmjet një tuneli rreth 10.7 Km të gjatë nga rezervuari i Moglicës. HEC Moglicë përdor dy njësi të mëdha turbinash Francis dhe një turbinë të vogël për

rrjedhën ekologjike pranë digës. Kapaciteti i instaluar është prej 184 MW dhe gjatë vitit 2021 energjia e prodhuar nga HEC Moglicë është 424,642 MWh.

Hidrocentrali i Banjës pas përfundimit të punimeve ka hyrë në prodhim në vitin 2016 ndërsa HEC Moglicë ka hyrë në prodhim në vitin 2020 dhe MIE në zbatim të Kontratës së Koncesionit ka lëshuar Certifikatën e Përfundimit Final për HEC Banjë sipas shkresës Nr. 187/1 Prot., datë 24.10.2017 dhe për HEC Moglicë sipas shkresës Nr. 59/4 Prot., datë 17.11.2020.

Në zbatim të ligjit nr. 1071/2014, datë 01.10.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjorë të tij, shoqëria e Projektit D. H. sh.a është pajisur me Certifikatat e Përdorimit për hidrocentralet e Banjës dhe Moglicës të cilat janë lëshuar nga Sekretariati i Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), pas përfundimit të punimeve për secilin prej tyre, si një dokument zyrtar i cili vërteton se ndërtimi është kryer në përputhje me kushtet e lejes së ndërtimit dhe se punimet e kryera dhe ndërtimi janë të përshtatshëm për përdorim.

Në zbatim të Shtesës së Tretë të Kontratës së Koncesionit, Koncesionari mori përsipër të projektojë, tenderojë dhe ndërtojë Infrastrukturën Zëvendësuese e cila përfshin ndërtimin e rrugës zëvendësuese Banja - Gramsh, Ura e Trashovicës; rruga zëvendësuese Moglicë M15 dhe rruga zëvendësuese Moglicë M03, të cilat janë përfunduar nga Koncesionari dhe i janë dorëzuar Autoritetit Rrugor Shqiptar, në cilësinë e entit shtetëror dhe në përputhje me marrëveshjen mes palëve.

## 2. Përshkrim i shkurtër i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së zhvilluar për përcaktimin e fituesve të koncesionit, lidhjen e kontratës, aprovimet ligjore përkatëse, zbatimin e saj si dhe projektimin, tenderimin dhe ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese e cila përfshin ndërtimin e rrugës zëvendësuese Banja - Gramsh, Ura e Trashovicës; rruga zëvendësuese Moglicë M15 dhe rruga zëvendësuese Moglicë M03, të cilat janë përfunduar nga Koncesionari dhe i janë dorëzuar Autoritetit Rrugor Shqiptar, në cilësinë e entit shtetëror dhe në përputhje me marrëveshjen mes palëve.

## 3. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.

Nga auditimi është konstatuar se:

Nr.	Përmbledhje e gjetjes		Rëndësia	Rekomandimi
1	Në kontratën përfundimtare të Autoritetit Kontraktor me Koncesionarin, të aprovuar me ligjin nr. 7/2015, datë 12.02.2015, dhe me ligjet e mëparshme janë kryer ndryshime të rëndësishme nga dokumentet e procedurës së koncesionit si vijon: Në pjesën e kushteve të kontratës, në formularin e deklarimit të ofertës, ofertuesi konfirmon pajtimin e tij për të firmosur kontratën sipas formularit të Kushteve të Kontratës, nëse shpallet fitues. Në seksionin e Kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të	Pika 1	E lartë	Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në të ardhmen në procesin e finalizimit të kontratave me operatorët fitues, të mos ndryshojë termat e përgjithshme dhe të veçanta të procedurave të përzgjedhjes së ofertuesve pasi sjell shkeljen e barazisë në procedurën e përzgjedhjes së koncesionarit, dhe uljen e transparencës, barazisë,

<p>Kontratës Koncesionare përcaktohet se: A.Terma të Përgjithshme të MK, C. Të drejtat dhe detyrimet e palëve, koncesionari duhet të marrë masa të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet, që eventualisht mund t'i shkaktohen palëve të treta. E. 20. Çështjet e panegociueshme, - Akses të plotë të Autoritetit Kontraktues dhe ERE në regjistrat e punës së Koncesionarit. -Detyrimi i Koncesionarit dhe shoqërisë së projektit për të paguar taksat, detyrimet dhe taksat e tjera sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë. – Pagesa e të drejtës koncesionare do të jetë në % fituese kWh, jo më pak se 2% të vleftës absolute të prodhimit të energjisë elektrike. – detyrimi i koncesionarit për të përmbushur kërkesat e Autoritetit Kontraktues ose ERE për tu përshtatur me detyrimet e shërbimit publik. (citur më sipër). F. Zbatimi dhe interpretimi i kësaj kontrate koncesioni do të bazohet në legjislacionin shqiptar në fuqi dhe çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë kontratë do të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Më pas në shtesat e kontratave kushtet fillestare kanë ndryshuar duke e kaluar riskun te Autoriteti Kontraktues. -Pagesa e detyrimeve fiskale sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, në kontratë është ndryshuar duke e përjashtuar koncesionarin nga tatimi mbi vlerën e shtuar për mallrat e importit dhe ato brenda vendit si dhe të gjitha ndryshimet në taksa gjatë viteve.</p> <p>-Gjykimi i mosmarrëveshjeve mes palëve është akorduar për tu zgjidhur në Gjykatën e Arbitrazhit. Ndryshimi i kushteve thelbësore të kontratës ka sjellë shkeljen e barazisë në procedurën e përzgjedhjes së koncesionarit, veprime në kundërshtim</p>			<p>efikasitetit dhe qëndrueshmërinë afatgjatë në zhvillimin e projekteve të infrastrukturës dhe të shërbimeve publike.</p>
---	--	--	--

<p>me nenin nr.1., të Ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006, i ndryshuar, “Për koncesionet”, ku citohet: Qëllimi i ligjit, Qëllimi i këtij ligji është të krijojë kuadrin e nevojshëm për nxitjen dhe lehtësimin e zbatimit të projekteve koncesionare, të financuara nga sektori privat, duke rritur transparencën, barazinë, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë në zhvillimin e projekteve të infrastrukturës dhe të shërbimeve publike. Ai synon zhvillimin e mëtejshëm të parimeve të përgjithshme në lidhjen e kontratave nga autoritetet publike, nëpërmjet përcaktimit të procedurave të veçanta për dhënien e projekteve koncesionare.</p> <p>-Gjithashtu në pikën 3.7, të shtesës së kontratës është përcaktuar se d) Autoriteti Kontraktues do të jetë përgjegjës ndaj Koncesionarit për të gjitha kostot, dëmet dhe humbjet që lindin nga çfarëdo mospërfundim i Infrastrukturës Zëvendësuese në afatet e përcaktuara;</p> <p>e) Autoriteti Kontraktues do të mbajë të pacenuar dhe do të dëmshpërblejë Koncesionarin për të gjitha pretendimet, dëmet dhe humbjet që vijnë prej furnitorëve dhe kontraktorëve të tjerë ose çdo palë tjetër të tretë në lidhje me planifikimin, projektimin dhe tenderimin e Infrastrukturës Zëvendësuese ose lidhen me Infrastrukturën Zëvendësuese;</p> <p>-Për sa më sipër duke u nisur nga fakti që Koncesionari do kryejë të gjithë procesin e planifikimit, projektimit dhe tenderimin e Infrastrukturës Zëvendësuese, nuk shpjegohen arsyet përse Autoriteti Kontraktues duhet të merrte përsipër risqet për dëmshpërblim për humbjet që mund të vinin nga furnitorët dhe kontraktorët ose çdo palë tjetër në proces.</p>			
--	--	--	--

2	<p>Në lidhje me pikën 6.b, të dokumenteve të procedurës së koncesionit, respektimi optimal i aspekteve ekologjike dhe mjedisore, sigurimi i rrjedhës minimale në shtratin natyral të lumit, i vlerësuar me 5 pikë, ku citohet se projekti duhet të sigurojë një rrjedhje të vazhdueshme në të gjithë shtratin natyral të lumit, në masën jo më pak se 15 % të prurjeve natyrale, për të garantuar zhvillimin e florës dhe faunës në këtë lumë u konstatua se këto kërkesa nuk ishin përcaktuar qartë e saktë në kontratat e lidhura me operatorin fitues.</p> <p>Kërkesës së METE për dhënie mendimi, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, i ka dhënë përgjigje me shkresën nr. 110 Prot., datë 11.01.2009.</p> <p>-Duke qenë se lumi Devoll në pjesë të veçanta të rrjedhës së tij shërben edhe si burim ujor për ujitje, ka kërkuar që në kontratën e koncesionit ndërmjet autoritetit kontraktues dhe koncesionarit, të përcaktohen qartë nevojat për ujë për ujitje, që ka bujqësia gjatë periudhës së ujitjes (periudha Maj-Gusht). Kjo për faktin se me ujërat e lumit Devoll është e lidhur ujitja e rreth 70 000 ha tokë bujqësore dhe në funksion të kësaj janë bërë investime të konsiderueshme në rehabilitimin e infrastrukturës së ujitjes në mjaft zona të vendit. Për bujqësinë nga hidrocentrali i Banjës duhet të merren rreth 150 milion m' ujë nga rrjeti i poshtëm që shfrytëzohen me rrjedhje të lirë dhe konkretisht:</p> <p>-nëpërmjet digës së Vlashukut dhe rezervuarit të Thanës dhe rrjetit ekzistues ujitës merren nga lumi Devoll rreth 100 milion m' ujë në periudhën Mars-Shtator për mbushjen e rezervuarit të Thanës nëpërmjet të cilit realizohet ujitja e rreth 40 000 ha tokë bujqësore në rrethet e Lushnjës dhe të Fierit;</p>	Pika 3	E lartë	<p>Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në të ardhmen në procesin e realizimit të koncesioneve dhe finalizimit të kontratave me operatorët fitues të përcaktohen qartë, saktë dhe me parametra të matshëm objektivat kryesorë të koncesionit.</p>

	<p>-nëpërmjet kanalit lidhës Banjë - Shkumbin duke u kombinuar me rrjetin ekzistues të kanalit Peqin Kavajë (zona e poshtme e Dumresë dhe fushat e Cërrikut, Peqinit dhe Kavajës) shfrytëzohet rreth 40 milion m<sup>3</sup>; nëpërmjet digës së Vlashukut në rrethin e Kuçovës dhe Fierit shfrytëzohen rreth 10 milion m<sup>3</sup> ujë;</p> <p>-bujqësisë për ujë për ujitje nga lumi Devoll gjatë sezonit të ujitjes i arrijnë në rreth 150 milion m<sup>3</sup> ujë.</p> <p>Në këto kushte kërkesa duhej marrë në konsideratë pasi plotësimi i nevojave për ujë për ujitje nga lumi Devoll është jetik për zhvillimin e bujqësisë në zonat fushore të Lushnjës, Fierit, Kavajës Elbasanit, Beratit e Korçës.</p> <p>-Kërkesa e Ministrit të MBUMK, për përcaktime të sakta për ujin për vaditje si dhe parametrat e projektit fillestar për sigurimin e rrjedhës së vazhdueshme të ujit gjatë gjithë vitit për sigurimin e florës dhe faunës së lumit, nuk janë pasqyruar në kontratën përfundimtare mes palëve. Trajtuar më hollësisht në Pikën 1, faqe 7 të Projektraportit të Auditimit.</p>			
3	<p>Me shkresën e D.H., date 31.01.2015, nr. Prot. 2015-TR-00132 - për vitin 2014, dhe shkresën e D.H. date 02.03.2015, nr. Prot. 2015-TR-00349, janë kërkuar rimbursimi i Kostove të Infrastrukturës Zëvendësuese për vitin kalendarik 2014, në përputhje me nenin 7.2.7.5, 7.2 7.7 të Shtojcës se 3-1 të Kontratës së Koncesionit. Shkresave i janë bashkëngjitur kostot e dokumentuara deri me 31 janar 2015 në vlerën 3,972,459 milion euro.</p> <p>Për kërkesat sa më sipër Ministria e Energjetikës dhe Infrastrukturës ka kryer pagesën më datë 27.03.2015, në vlerën 332,604,347 lekë, (2,367,964.88 euro x 140,46 lek) dhe pagesën datë</p>	Pika 4	E lartë	Nga Autoriteti Kontraktor të analizohet vlera 3,972,459 euro, vlerë e cila ka të bëjë me disbursime për shpenzime të kontraktuara jo në kushtet e miratuara dhe jo të monitoruara, dhe të merren masa për tu mos u përsëritur në të ardhmen, pasi kjo vlerë për Buxhetin e Shtetit, përbën shpenzime jo të justifikuara të fondeve publike.



<p>08.04.2015 në vlerën 225,303,064 lekë (1,604,494,12 euro x 140.42 lek).</p> <p>Me urdhër shpenzimin nr. 78, datë 27.03.2015, për certifikatat me nr 11-19, të paraqitura nga D.H., në vlerën 2,367,964,88 Euro. Me urdhrin nr. 80, datë 25.03.2015, z. I. B., në cilësinë e zëvendësit të Ministrit, ka urdhëruar pagesën sa më sipër. Me urdhër shpenzimin nr. 100, datë 08.04.2015, MEI ka urdhëruar pagesën e 225,303,064 lekë për shpenzime të kryera nga D.H.. Për këtë pagesë është lëshuar dhe urdhri nr. 92 datë 02.04.2015, nga Ministri i përfaqësuar nga z. I. B., për shlyerjen e vlerës 1,604,494 Euro.</p> <p>Pagesat e mësipërme i takojnë kontratave që ka lidhur D.H. me kontraktorë të tretë, për projektme dhe punime në Infrastrukturën Zëvendësuese, në periudhën 2013-2014, kur shtesa e tretë e kontratës koncesionare e cila sqaronte kushtet në të cilat do të bëhej lidhja e kontratave është aprovuar në parlament në shkurt të 2015. Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e përfaqësuar nga Zëvendësministri z. I. B., ka urdhëruar pagesat e mësipërme për shpenzime të paaprovuara nga Kuvendi i Shqipërisë, siç përcaktohet dhe në Ligjin për Koncesionet.</p> <p>Në shtesën e tretë të Kontratës së Koncesionit, është përcaktuar se në nenin 1 të Kontratës së Koncesionit “Marrëveshja e Infrastrukturës Zëvendësuese” nënkupton marrëveshjen e lidhur më datë 14.2.2014 midis Autoritetit Kontraktues, Shoqërisë së Projektit dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar për projektimin, tenderimin e Infrastrukturës Zëvendësuese (rrugët dhe urat) dhe ndërtimin e Rrugës M15 të Infrastrukturës Zëvendësuese të</p>			
---	--	--	--

<p>Moglicës, bashkëngjitur si Aneksi III. Pra kjo marrëveshje është pjesë e Kontratës së Koncesionit dhe si e tillë aprovohet në Këshillin e Ministrave, siç përcaktohet në pikën 4 të Nenit 21, Caktimi i ofertuesit më të mirë dhe negocimet përfundimtare, të ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006, i ndryshuar, ku citohet: Pas përfundimit të negocimit për kontratën koncesionare, Njësia e Trajtimit të Koncesioneve, brenda 45 ditëve, jep mendim me shkrim për kushtet e kontratës. *Pas marrjes së mendimit dhe nënshkrimit, kontratat koncesionare me vlerë investimi mbi 20 milion euro paraqiten për miratim në Këshillin e Ministrave. Kontratat koncesionare me vlerë nën 20 milion euro hyjnë në fuqi pas nënshkrimit nga autoriteti kontraktues.</p> <p>Me ligjin nr. 7/2015, miratuar më datë, 12.02.2015, “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 10 083”, datë 23.2.2009, i ndryshuar Këshilli i Ministrave ka miratuar dhe përmbajtjen e shtesës së tretë të kontratës së koncesionit. Në lidhje me procesin e projektimit dhe zbatimit të Infrastrukturës Zëvendësuese”, janë përcaktuar rregulla dhe procedura që do të ndiqen nga D.H., dhe do të monitorohen nga Autoriteti Kontraktor. Me urdhër pagesat e mësipërme janë urdhëruar të likuidohen shpenzime për të cilat nuk janë zbatuar këto procedura si dhe i përkasin periudhës 2013-2014, para se të aprovohej shtesa e tretë e kontratës nga Këshilli i Ministrave. Gjithashtu në shtesën e tretë të kontratës ishte parashikuar se Autoriteti Kontraktues do të monitorojë procedurën e tenderimit të Infrastrukturës Zëvendësuese dhe për këtë qëllim do të caktojë 2 (dy) persona të autorizuar.</p>			
---	--	--	--

	<p>Me autorizimin nr.39/153, datë 14.11.2014 të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë është ngarkuar përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor për të: "Verifikuar procedurat e aplikueshme, dokumentacionin e procedurës, ftesat e nisura në adresë të pjesëmarrësve, ofertat e paraqitura, procesin e vlerësimit, dhe çdo fazë tjetër që lidhet me shqyrtimin dhe vlerësimin korrekt të ofertuesve. I autorizuari ka të drejtë të informojë menjëherë Autoritetin Kontraktues, në rast se do të konstatojë ndonjë devijim nga procedurat apo shkelje në procesin e hartimit të dokumentacionit, vlerësimit e përzgjedhjes së ofertuesve dhe është i detyruar të mos përhap këtë informacion tek personat e tretë". Kontratat për ndërtimin e kësaj rruge (projektimi, ndërtimi dhe mbikëqyrja) janë lidhur gjatë viti 2013-2014, ndërsa përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor është caktuar në datën 14.11.2014. Pa u miratuar, në Këshillin e Ministrave dhe në Kuvend, shtesa nr.3 e kontratës së koncesionit të sipërcituar, menjëherë, pas lidhjes së marrëveshjes në datën 05.09.2013 dhe para lidhje së marrëveshjes së datës 14.2.2014 "Për projektimin dhe tenderimin e Infrastrukturës Zëvendësuese", koncesionari, ka filluar procedurat e konkurrimit për hartimin e projektit të zbatimit të infrastrukturës që do të zëvendësohet: riga Banja-Gramsh dhe Ura e Trashovics, rruga Moglicë M03 dhe mbështetje projektimi për punimet në vazhdim në rrugën Moglice M15. Pra këto kontrata nuk janë nuk janë monitoruar dhe mbikëqyrur nga Autoriteti Kontraktor. Vlera 3,972,459 euro përbën efekte negative financiare për Buxhetin e Shtetit.</p>			
4	- Në dokumentet standarde të procedurës së koncesionit ishte parashikuar si kusht	Pika 4	E lartë	Nga Autoriteti Kontraktor të analizohet vlera

	<p>për shpalljen fitues dhe Tarifa e Koncesionit jo më e vogël se 2 %. Megjithëse në ofertën fituese kjo tarifë ishte 2 %, në kontratën e fundit përcaktohet mos pagesa e tarifës për 15 vjet, siç citohet në pikën 2.10, Në nenin 4.1.1. do të shtohet në fund paragrafi që vijon: “Pavarësisht sa më sipër, Koncesionari nuk do të paguajë Tarifën e Koncesionit sipas këtij neni 4.1.1 “a” dhe “b”, për hidrocentralin e Banjës dhe të Moglicës për një periudhë 15-vjeçare duke filluar nga data e lëshimit të Certifikatës së Përfundimit Final të Hidrocentralit të Banjës”.</p> <p>Shpjegimi i dhënë nga zv. Ministri z. I. B. ishte se heqja e tarifës së koncesionit u bë për arsye se shoqëria e D.H. mori përsipër të kryej shërbimet e tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorëve për projektimin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen e Infrastrukturës Zëvendësuese, duke financuar fillimisht vetë dhe më pas nga financimet e buxhetit të shtetit, por pa vënë në dispozicion llogaritjet dhe relacionet përkatëse.</p> <p>Vendim-marrja për mospagesën e tarifës së koncesionit nuk është shoqëruar me analizat përkatëse, krahasimet e kostos së kapitalit që do të ofronte D.H. me tregun financiar si dhe efektin efektiv të tyre në situatën që Buxheti i Shtetit do të fillonte rimbursimin në vitin 2015 dhe do ta mbaronte në vitin 2019.</p> <p>Përfundimi i pagesës së tarifës së koncesionit prej 2%, ka sjellë të ardhura të munguara për Buxhetin e Shtetit në vlerën 5,119,000 Euro deri në gusht 2022.</p>			<p>5,119,000 euro, vlerë e cila ka të bëjë me përjashtimin e pagesës së tarifës së koncesionarit nga shoqëria D. H. sh.a., dhe të merren masa për tu mos u përsëritur në të ardhmen, pasi kjo vlerë për Buxhetin e Shtetit, përbën të ardhura të munguara.</p>
	<p>- Gjatë auditimit të dokumentacionit justifikues për rimbursimet e kryera u konstatua se D.H. ka vendosur në situacione kosto për shpronësime të truallit si dhe shpenzime sociale dhe ambientaliste. Në shkresën e D.H.,</p>	<p>Pika 4</p>	<p>E lartë</p>	<p>Nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative</p>

	<p>dërguar MIE, datë 31.01.2019, për rimbursimin e këstit të fundit, janë paraqitur si kosto të akumuluar dhe të kërkuara për rrugën zëvendësuese Banjë Gramsh dhe ura e Trashovicës në vlerën 282,316 Euro, dhe për rrugët zëvendësuese të Moglicës 102,626 euro, në total vlerën 384,942 Euro.</p> <p>Në lidhje me shpronësimet e truallit Këshilli i Ministrave ka nxjerrë VKM nr. 674, datë 15.10.2014, “Për shpronësimin, për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Gramsh-Lozhan”, me vlerë totale 2,726,182 lekë, e cila do të rimburohet nga D.H., VKM nr. 285, datë 13.4.2016 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “hidrocentrali i Banjës - Gramsh dhe ura e Trashovicës”, me vlerë 30,929,985 lekë, të cilat do të përballohen nga buxheti i shoqërisë D. H. dhe VKM nr. 464, datë 26.7.2018,” Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rrugët zëvendësuese M03 për ndërtimin e hidrocentralit të Moglicës” me vlerë prej 4,780,005 lekë.</p> <p>Duke qenë se në VKM e sipërcituara përcaktohet qartë se shpenzimet e shpronësimeve kryhen nga shoqëria D. H., si dhe nga konstatimet që në dokumentet justifikuese nuk janë paraqitur fatura ose dokumente për shpenzimet sociale dhe ambientaliste, vlera 384,942 Euro përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.</p>			<p>dhe të gjitha shkallët e gjykitimit, arkëtimin e vlerës 384,942 Euro, nga Koncesionari D. H. Sh.A., pasi kjo vlerë për Buxhetin e Shtetit, përbën shpenzime jo të justifikuara të fondeve publike.</p>
	<p>- Në kërkesën e bërë për rimbursime të shpenzimeve të kryera në periudhën Janar - Qershor 2015, u konstatua zëri</p>	<p>Pika 4</p>		<p>Nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të kërkohet në</p>

<p>kosto supervizimi dhe menaxhimi për rrugën Banjë Gramsh, sektorët 3A dhe 3 B, dhe ura e Trashovicës, me një total prej 631,330 Euro. Pagesa është kryer për 15 specialistë, që renditen nga specialistë të kualifikuar, ekspertë, në punonjës të huaj të rajonit si dhe në punonjës të huaj ndërkombëtarë. Për të parët pagesa orare është 25 euro, ekspertët 40 euro, më pas 100 euro dhe për punonjësit e huaj 250 euro në orë. Në total janë një punonjës i huaj ndërkombëtar i cili ka punuar 821 orë dhe ka marrë 205,250 euro, tre punonjës të huaj të rajonit të cilët kanë punuar 2175 orë dhe janë paguar 217,500 euro. Për sa më sipër në dokumentet justifikuese nuk janë paraqitur proceset e punës të kryera, kualifikimet dhe licencat që vërtetojnë se ishin të aftë për të kryer punët e kërkuara, llogaritjet e orëve së punës për person bazuar në pagën përkatëse dhe shpenzimet e përgjithshme administrative të dokumentuara nga analizat e kostove të shpenzimeve të përgjithshme administrative.</p> <p>Për sa më sipër është në kundërshtim me aneksin V të Kontratës së Koncesionit (e ndryshuar me Shtesën e 3-të të Kontratës së Koncesionit), ku janë caktuar dokumentet që duhet ti paraqiten Autoritetit Kontraktues për Kostot e Infrastrukturës Zëvendësuese të kryera, pika 8 ku citohet:</p> <p>“Dokumentacion nga Shoqëria e Projektit për kostot e veta në lidhje shpenzimet për mbikëqyrje/menaxhim të kontratave. Këtu përshihen dietat dhe shpenzimet e lidhura me kryerjen e punës dhe kostoja për ore pune e personelit e dokumentuar nga përshkrimi i punës i punëmarrësit. Kosto e orës së punës për person do llogaritet bazuar në pagën përkatëse dhe shpenzimet e përgjithshme</p>			<p>rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës 631,330 Euro, nga Koncesionari D. H. Sh.A., pasi kjo vlerë për Buxhetin e Shtetit, përbën shpenzime jo të justifikuara të fondeve publike.</p>
---	--	--	--

	administrative të dokumentuara nga analizat e kostove të shpenzimeve të përgjithshme administrative.” Vlera prej 631,330 Euro përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.			
--	--	--	--	--

### 3. Konkluzion i përgjithshëm dhe opinionit i auditimit.

Ne jemi përpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet të kenë një siguri të arsyeshme, por kjo nuk ka qenë e mundur si pasojë e mos vënies në dispozicion ndaj grupit të auditimit pjesë të qënësishme të dokumentacionit të kërkuar për auditimin nga ana e shoqërisë D. H. sh.a.

Ne kemi përdorur gjykimin profesional dhe ushtruar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave duke mos siguruar garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinionit me siguri të arsyeshme por me siguri të kufizuar.

## OPINIONI I AUDITIMIT

Në vlerësimin tonë, rezultati i auditimit për çështjet e përputhshmërisë së veprimtarisë për projektin e koncesionit “Për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentraleve në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë, për periudhën nga identifikimi i koncesionit deri më 31.12.2021 nuk është në përputhje në të gjitha aspektet materiale me kriteret e përcaktuara në këtë auditim, që kanë të bëjnë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator. Krahas parregullsisve materiale sasiore, në arritjen e opinionit, grupi i auditimit në dhënien e opinionit ka marrë në konsideratë dhe gabime/parregullsi të caktuara të natyrës cilësore, pavarësisht vlerës së tyre.

**Grupi i auditimit bazuar në procedurat e kryera shprehet me siguri të kufizuar mbi procedurat e prokurimit për Strukturën Zëvendësuese të kryera nga shoqëria D. H.Sh.A., për llogari të Autoriteti Kontraktor, MEI për arsye mos pasjen e informacionit për to dhe se subjekti në tërësi nuk është në përputhje, në aspektet materiale me kriteret e zbatueshme duke justifikuar dhënien e një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë.**

**Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë.**

Ne jemi përpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet e tona të kenë një siguri të arsyeshme, por për shkak të kufizimeve të fushëveprimit të auditimit nuk është realizuar (ISSAI 4000.42). Konkluzionet dhe opinionit ynë janë të bazuara në kompetencën për vlerësim objektiv dhe profesional të evidencës së auditimit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga MIE dhe shoqëria koncesionare D. H. cila konsiderohet nga ana jonë e pamjaftueshme, dhe jo të përshtatshme. Ne kemi përdorur gjykimin objektiv dhe kemi zbatuar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinionit me siguri të kufizuar. Auditimi është kryer sipas standardeve të cilat bazohen në Parimet Themelore të Auditimit niveli 3 (ISSAI 100 - 999) të Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Procedurat e auditimit të bazuara në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit: ISSAI 400 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”, ISSAI

1500 (ISA 500)<sup>1</sup> dhe ISSAI 1530 (ISA 530)<sup>2</sup>; Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, si dhe dokumentimi i auditimit kanë shërbyer si bazë për arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit në këtë auditim përputhshmërie.

**Bazuar në punën e kryer të auditimit, nga gjetjet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e opinionit të mësipërm, veçojmë:**

- Janë konstatuar efekte negative në administrimin e fondeve për ndërtimin e strukturës zëvendësuese në Banjë dhe Moglicë si dhe menaxhim pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet i tyre në vlerën 5,528,607 euro.
- Janë konstatuar të ardhura të munguara në procedurën e kontraktimit me konciesionarin në vlerën 5,119,000 euro.
- Janë konstatuar dëme ekonomike në vlerën 1,016,272 euro në rimbursimin e shpenzimeve jo të justifikuara.
- Mangësi në drejtim të plotësimit të kriterëve dhe specifikimeve gjatë procedurave të zgjedhjes së operatorit fitues në kontratën përfundimtare.
- Etj.

**Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të:**

Stafi drejtues është përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve dhe funksioneve të strukturës në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe për përdorimin e këtyre fondeve me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet etj.

**Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Auditimi ka identifikuar çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kriterëve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë në vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Audituesit e KLSH janë përgjegjës për të siguruar cilësinë e auditimit, duke zbatuar procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë gjithë procesit të auditimit, me synim marrjen e sigurisë, se auditimi është në përputhje me standardet e aplikueshme dhe se raporti i auditimit, konkluzionet dhe opinionit i auditimit janë të përshtatshme.

## II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 446/1, i ndryshuar, datë 27.05.2022, miratuar

<sup>1</sup> Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij.

<sup>2</sup> Objektivi i audituesit është të kryejë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objekti.



nga Kryetari i KLSH, nga data 30.05.2022 deri më datë 14.10.2022, në subjektin “*Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës*”, për periudhën nga identifikimi i koncesionit deri më 31.12.2021, u krye “*Auditim Përputhshmërie dhe Rregullshmërie*” me përbërje:

**B. SH., Përgjegjës Grupi,**

A. L.

A. T.

A. T.

A. R.

A. F.

**1.Objekti i auditimit:** Dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me aktivitetin e subjektit, sipas pikave të programit të auditimit., si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e situatës.

**2. Qëllimi i auditimit:** Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator. Objektivi i Auditimit është dhënia e opinionit nëse Projekti i koncesionit “Për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentraleve në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë, në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni është në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse.

Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuar i shkeljes së parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korigjuese nga ana e subjektit të audituar.

Auditimi i përputhshmërisë dhe rregullshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (*sipas ISSAI 400, p 18*).

Me auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të dakortësuara mes palëve të realizuara në periudhën nën auditim.

**3.Identifikimi i çështjes:**

Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi me siguri të arsyeshme i veprimtarisë së koncesionarit dhe autoritetit kontraktor, për periudhën objekt auditimi. Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

-Auditimi mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit, për realizimin e kontratës së Koncesionit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si Autoritet Kontraktues dhe A. A., S. A. dhe D. H. SHA, si bashkë-koncesionarë, për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Projektit të Hidrocentralit në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë.

a. Hartimi i detyrës së projektimit nga specialistë të fushave përkatëse (sipas komponentëve të projektit) të Ministrive/Bashkive apo çdo Institucion Publik, të përfshirë, si pikënisje (faza paraprake) e identifikimit të një projekti të mundshëm të koncesionit.

Studimi i fizibilitetit nga Autoriteti Kontraktues mbi përgatitjen e studimit paraprak të projektit, me të gjithë elementët e saj si dhe përcaktimi i kostos paraprake të projektit. Analiza e faktit nëse projekti i hartuar si një koncesion është ekonomikisht më i favorshëm, krahasuar me alternativën e prokurimit tradicional.

b. Hartimi i studimit për ndërtimin e projektit dhe preventivit të zbatimit për punimet e ndërtimit objekt i kontratave koncesionare.

c. Ngritja dhe funksionimi i njësisë së zbatimit të koncesionit dhe komisionit të dhënies së Koncesionit.

ç. Përgatitja e dokumenteve dhe auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të Koncesionit. -Monitorimi dhe zbatimi i kontratës/kontratave të ndërtimit dhe mbikëqyrjes nga Ministrinë/Bashkitë apo çdo Institucioni Publik, të përfshirë në ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Projektit të Hidrocentralit/Hidrocentraleve në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë.

- Realizimi i projektit të zbatimit, sipas përshkrimit konstruktiv, arkitektonik, funksional dhe teknik të projektit të miratuar dhe të zbatuar.

- Kryerja e punimeve civile të ndërtimit sipas preventivit dhe projektit të zbatimit dhe metodat e ndërtimit.

- Teknologjia e përdorur, përputhshmëria e të dhënave teknike për makineritë dhe pajisjet e vendosura në vepër, me specifikimet teknike të miratuara.

- Cilësia e materialeve dhe e punimeve të realizuara në vepër, përputhshmëria e tyre me Kushtet Teknike të Projektimit (KTP) dhe Kushtet Teknike të Zbatimit (KTZ) si dhe standardet përkatëse të PZ. Zbatimi i grafikut të punimeve.

- Ndryshimet në projektin e zbatimit, zbatimi i procedurës për argumentimin dhe miratimin e tyre nga Autoriteti Kontraktues.

-Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit, administruar nga Institucionet Publike respektive.

a. Realizimi i objektivit të përgjithshëm dhe objektivave specifike të projektit, skenarët teknikë dhe ekonomikë në arritjen e objektivave.

b. Skemat e implementimit të objektivit të përgjithshëm.

c. Ndikimi mjedisor dhe social nga zbatimi dhe vendosja në punë e projektit me objekt "Ndërtimi i Hidrocentralit/Hidrocentraleve në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë". Përputhja e treguesve mjedisorë dhe socialë me standardet e BE-së për mjedisin.

- Menaxhimi financiar i projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare kundrejt nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.

#### **4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:**

Është detyrimi i menaxherëve të njësisë që në kryerjen e veprimtarive, të respektojnë parimet e menaxhimit financiar, të ligjshmërisë e të transparencës në administrim, si dhe të përgjigjen për veprimet e tyre dhe rezultatet që burojnë prej tyre përpara organit që i ka emëruar ata ose të cilëve u ka deleguar përgjegjësinë sipas përcaktimeve në ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar.

"Autoritet Kontraktues" është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ish MEI dhe METE e Republikës së Shqipërisë.

"Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues" është çdo përfaqësues të cilin Autoriteti Kontraktues e ka caktuar për ta përfaqësuar atë në lidhje me zbatimin e ndonjëres nga të drejtat e tij sipas Kontratës së Koncesionit, Neni 3 i Ligjit nr. 10 083, datë 23.02.2009, "Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si Autoritet Kontraktues dhe A. A., S. A. dhe D. H. SHA, si bashkëkoncesionarë, për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Projektit të Hidrocentralit në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë", lidhur mes palëve më 19.12.2008.

Njësia e Zbatimit të Projektit përbëhet nga katër anëtarë dy anëtarë, funksionarë të lartë të shtetit të caktuar nga METE; dhe dy anëtarë, përfaqësues të rangut të lartë të Koncesionarit.

## **5. Përgjegjësitë e audituesve:**

Përgjegjësia jonë (*Audituesit e KLSH-së*) është që nëpërmjet auditimit të realizuar:

-Të vlerësojë nëse, informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (*ISSAI 4000*), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit e ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Ne si Auditues Shtetëror shprehemi me një opinionin mbi përputhshmërinë e aktivitetit të institucionit, si dhe përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare prej tij. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (*INTOSAI*), bazuar në këto standarde ne aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

-Të kryej në mënyrë efektive auditimin (*ISSAI 1300*)

-Të vlerësojë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse. (*ISSAI 1500, ISA 300*).

-Të kryej procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objekti.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në *ISSAI*-n 10 "Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t", si dhe *ISSAI 30* "Kodi Etik", apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipër përmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e opinionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

**6. Kriteret e vlerësimit:** Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë e dytësor, në dispozita të tjera si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të *INTOSAI (ISSAI)*;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (*ISA*) dhe *IFAC*;
- Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të audituesve;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të *IDI-t, INTOSAI* "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit;

- ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë", "Libri Jeshil" i GAO-s, etj;
  - Manualet e Auditimit të Përputhshmërisë të miratuar në Kontrollin e Lartë të Shtetit, Rregullat, Udhëzimet e KLSH-së etj.
  - Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".
  - Ligji nr. 9663, datë 18.12.2006, "Për Koncesionet;
  - Ligjin Nr. 125/2013, "Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat;
  - Ligji nr. 50/2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin 125/013: Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat", i ndryshuar;
  - Ligji nr. 10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar.
  - Ligji nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar;
  - Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar.
  - Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar i ndryshuar me Ligjin Nr.31/2013, datë 14.02.2013;
  - Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011 "për menaxhimin e integruar të mbetjeve" i ndryshuar me: Ligjin. Nr. 156/2013, datë 10.10.2013 dhe Ligjin. Nr. 32/2013, datë 14.02.2013;
  - Ligji nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" i ndryshuar me ligjin nr. 20/2016, datë 10.03.2016;
  - Ligji nr. 8503, date 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare" i ndryshuar me Ligjin. nr.119/2014, datë 18.09.2014;
  - Ligji nr. 10 083, datë 23.02.2009, "Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si Autoritet Kontraktues dhe A. A., S. A. dhe D. H. SHA, si bashkëkoncesionarë, për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Projektit të Hidrocentralit në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë", lidhur mes palëve më 19.12.2008;
  - Ligji nr. 10 337, datë 21.10.2010, "Për një shtesë dhe ndryshim në Ligjin nr. 10 083, datë 23.02.2009 "Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si Autoritet Kontraktues dhe A. A., S. A. dhe D. H. SHA, si bashkëkoncesionarë, për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Projektit të Hidrocentralit në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë" ;
  - Ligj nr. 105/20013, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 083, datë 23.02.2009 "Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si Autoritet Kontraktues dhe A. A., S.A. dhe D. H. SHA, si bashkëkoncesionarë, për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Projektit të Hidrocentralit në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar."
- Ligji Nr. 7/2015, "Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 10 083, datë 23.2.2009, "Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues, dhe e.a., S. as e D. H., sh.a., si bashkëkoncesionarë për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në luminDevoll, në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar;
- VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" i ndryshuar;
  - VKM nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".
  - VKM nr. 575, datë 10.07.2013 "Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat" i ndryshuar me: VKM nr. 313, datë 27.04.2016;

- VKM nr. 634, datë 01.10.2014 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat të punëve publike dhe shërbimeve për ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e rrugëve nacionale” i ndryshuar me: VKM nr. 925, datë 29.12.2014; VKM nr. 111, datë 06.02.2015; VKM nr. 160, datë 01.03.2017; VKM 696, datë 21.11.2018; VKM nr. 174, datë 27.03.2019.
  - VKM nr. 89, datë 03.02.2016 “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”
  - UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Menaxhimi i aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ligji nr. 10164, datë 15.10.2009.
  - UKM nr. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” ndryshuar me: Udhëzimin nr. 4, datë 17.05.2001, Udhëzimin nr. 7, datë 21.11.2001, Udhëzimin nr. 1, datë 22.02.2005 dhe Udhëzimin nr. 1, datë 16.06.2011.
  - Udhëzim nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar me Udhëzimin. Nr.3, datë 16.01.2015.
  - Ligje, VKM, Udhëzime apo Rregullore të tjera mbi të cilat janë bazuar procese të këtij koncesioni.
  - Akte të tjera ligjore apo nënligjore që do të jenë të nevojshme gjatë auditimit.
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë miratuar sipas Vendimit të Kryetarit të KLSH me nr. 66 datë 23.06.2020.
- Dispozitat ligjore dhe nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërisë.
- Të tjera.

## **7. Standardet e auditimit:**

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranura të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Kodi etik i KLSH dhe Rregullorja e Brendshme.
- ISSAI 100- Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;
- ISSAI 400-Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 4000-Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”;
- ISSAI 1500 (ISA 500)- Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; si dhe në praktikat më të mira të fushës.

## **8. Metodatat e auditimit:**

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të Audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme:

- a. *Verifikimi i transaksioneve* – mbi bazën e informacionit në dokumentet e bankave me të cilët subjekti kryen transaksione;

- b. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;
  - c. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit;
  - d. *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* - duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit;
  - h. *Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
  - g. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të Audituesve.
- Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit në tërësi, dhe sipas drejtimeve në veçanti.

**9. Dokumentimi i auditimit:** Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion u konsiderua i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Dokumentimi i punës audituese në terren është bërë në aktet e mbajtura në subjektin e audituar. Në përfundim të auditimit në terren mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, akt-konstatimeve dhe akt-verifikimeve të mbajtura si dhe observacioneve të paraqitura për këto akte dhe për Projekt Raportin përkatës u përgatit dhe u dërgua në subjekt ky Raport Përfundimtar të Auditimit.

### III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

#### 1. Pika III.1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar

Është audituar aktiviteti i Autoritetit Kontraktor për periudhën e auditimit, fokusuar në procedurat e fillimit, përzgjedhjes, realizimit dhe disbursimit të shpenzimeve të MIE për Strukturën Zëvendësuese të Koncesionit.

#### Pika III.2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Raporti Përfundimtar i Auditimit.

## **2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit**

**2.1 Mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit, për realizimin e kontratës së Koncesionit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si Autoritet Kontraktues dhe A. A., S. A. dhe D. H. SHA, si bashkë-koncesionarë, për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Projektit të Hidrocentralit në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë.**

**a.** Hartimi i detyrës së projektimit nga specialistë të fushave përkatëse (sipas komponentëve të projektit) të Ministrive/Bashkive apo çdo Institucion Publik, të përfshirë, si pikënisje (faza paraprake) e identifikimit të një projekti të mundshëm të koncesionit.

Studimi i fizibilitetit nga Autoriteti Kontraktues mbi përgatitjen e studimit paraprak të projektit, me të gjithë elementët e saj si dhe përcaktimi i kostos paraprake të projektit. Analiza e faktit nëse projekti i hartuar si një koncesion është ekonomikisht më i favorshëm, krahasuar me alternativën e prokurimit tradicional.

**b.** Hartimi i studimit për ndërtimin e projektit dhe preventivit të zbatimit për punimet e ndërtimit objekt i kontratave koncesionare.

**c.** Ngritja dhe funksionimi i njësisë së zbatimit të koncesionit dhe komisionit të dhënies së Koncesionit.

**ç.** Përgatitja e dokumenteve dhe auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të Koncesionit.

Në zbatim të pikës nr. 1, të programit të auditimit nr. 446/1 prot., datë 27.05.2022, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Urdhrat e titullarëve të ministrive për procedurat përkatëse
2. Raportet respektive
3. Dokumente të tjera, oferta, korrespondenca etj.

### **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:**

Legjislacioni në fuqi për koncesionet në periudhën e fillimit të procedurave është ligji nr. 9663, datë 18.12.2006, “Për koncesionet”, dhe VKM Nr. 27, datë 19.1.2007, për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve, i ndryshuar me VKM nr. 104, datë 28.02.2007, VKM nr. 87, datë 16.01.2008, VKM nr. 544, datë 1.5.2008, VKM nr. 469, datë 16.06.2010 dhe VKM nr. 269 date 18.04.2012.

### **-Identifikimi i koncesionit të mundshëm**


Identifikimi i projektit të koncesionit për rastet e propozimeve të kërkuara kryhet duke vlerësuar strategjitë sektoriale apo rajonale të zhvillimit, studimet përkatëse që disponohen nga këto organe, si dhe projekt-idetë teknike dhe financiare.

Në Masterplanin e vitit 2003-2015, Për zhvillimin e sektorit të gjenerimit të energjisë elektrike është përcaktuar se për të përballuar nevojat shtese elektroenergjitike dhe për të reduktuar nivelin shumë të lartë të importit, parashikohet të ndërtohen ato HEC-e, të cilat janë me kosto minimale.

Bazuar në studimin e Bankës Botërore dhe në bazë të llogaritjeve të kosto minimale është vlerësuar se kandidatet më të mundshëm për HEC-e te reja janë:

- Bushati (84 MW) dhe Skavica (me 2 opsione) mbi lumin Drin;
- Kaludha (75 MW), Dragot-Tepelena (130 MW) dhe Kalivaçi (100 MW) mbi Lumin Vjose;
- Bratila (115 MW) dhe Banja (80 MW) mbi Lumin Devoll.

Pas diskutimeve mbi opsionet e propozuara ne lidhje me ndërtimin e HEC-eve te reja ndërmjet specialisteve te KESH-it, Institutit te Studimeve dhe Projektmeve Hidroteknike, si dhe specialisteve te D. (studimi i Bankës Botërore) për rritjen e kapaciteteve te reja gjeneruese, është propozuar dhe ndërtimi i HEC-eve në Lumin Devoll: Bratila (115 MW) dhe Banja (80 MW). Karakteristikat kryesore te këtyre projekteve janë dhëne në tabelën më poshtë. Bazuar në konkluzionet e studimit te BB, projekte te tjerë, siç është Sakavica (2 opsionet) janë identifikuar si me pak atraktive, ne veçanti nga pikëpamja ekonomike, dhe për pasojë nuk janë zgjedhur si kandidatë te mundshëm për periudhën 2005-2015, për mbulimin e nevojave. Realizimi i projektit të Banjës i referohet përfundimit punimeve te mbetura. Investimi fillestar përfshin veprat civile për ujtitje për një sipërfaqe 120000 ha.



Lugina e Devollit ndodhet në Jug të Shqipërisë dhe është dega më e madhe furnizuese e lumit Seman. Lumi del nga rrafshnalta e Korçës dhe dega më e madhe furnizuese e tij është Tomorica, në rrjedhat e poshtme të Lumin Devoll. Në kontekst të shfrytëzimit të potencialit hidrik të rrjedhës së lumit Devoll, ndërmjet kuotave 806 dhe 95 m mbi nivelin e detit, përfshirë të gjitha degët është filluar procedura e dhënies me koncesion nga METE.

Kompania E. me seli në Vjenë, Austri, me shkresën nr. 296 Prot., datë 12.01.2007, ka shprehur interesin për përdorimin e energjisë hidrike në lumin e Devoll, duke përdorur parametrat optimal ekonomik, teknik dhe ekologjik për pjesën nga Gostima deri në Maliq.

Në ftesën për ofertë të shpallur nga METE, më datë 03.02.2007, nga Ministri z. G. R., dhe në mungesë dhe me porosi z. E. B. janë kërkuar: Objekti i kontratës: Dhënie koncesioni për ndërtim HEC-i për shfrytëzimin e potencialit hidrik të luginës së Devollit ndërmjet kuotave 806-95 m mbi nivelin e detit, përfshirë të gjitha degët. Kohëzgjatja e kontratës është deri në 35 vjet dhe forma është BOT, ndërtim, operim dhe transferim.



Më datë 10.04.2007, Ministri i METE, ka ngritur grupin e punës për vlerësimin e propozimeve i përbërë nga M. S. kryetare, R. B. anëtare, A. B. anëtar, F. O. anëtare, K. B. anëtare, M. U. anëtare, E. D. anëtar, V. P. anëtare dhe E. A. anëtare.

Në datë 30.06.2007, me Vendimin nr. 6, Kryeministri ka vendosur në parim përdorimin për qëllime hidroenergjitike të rezervave ujore të kaskadës së lumit Devoll, duke përcaktuar kuotat e shfrytëzimit nga 100 m në 805 m mbi nivelin e detit. Sasia e ujit që do të depozitohet në rezervuarin e Banjës të përdoret për prodhimin e energjisë elektrike, prurja mesatare që do të përdoret për qëllime hidroenergjitike të jetë nga 15 m<sup>3</sup>/s deri në 50 m<sup>3</sup>/s, si dhe prodhimi mesatar i energjisë elektrike të jetë rreth 930 GWh deri në 1200 GWh.

### **-Organizimi i procedurave konkurruese të përzgjedhjes**

Me urdhrin nr. 116/14.a datë 03.08.2007, ministri i METE ka urdhëruar fillimin e procedurës për dhënien me koncesion të HEC-eve në kaskadën e lumit Devoll dhe ka përcaktuar anëtarët e njësisë së hartimit të dokumenteve e përbërë nga R. B. kryetare dhe F. O., M. Z., M. A., L. K., dhe V. P. anëtarë. Komisioni i vlerësimit të ofertave përbëhet nga D. K. kryetar dhe K. R., M. S., Z. S., K. B., A. B., P. D., T. Z., S. Xh., Sh. K. dhe E. D. anëtarë.

Me proces verbalin nr.1, datë 03.08.2007, njësia e hartimit të dokumenteve ka përgatitur e miratuar dokumentet përkatëse.

Më datë 03.08.2007 ministri i METE, me shkesën nr. 8880 Prot., ka miratuar ftesën për ofertë, me afat për dorëzimin e ofertave datën 19.11.2007.

Në pjesën e kaskadës së HEC Banjë janë kryer punime të mëparshme, si pjesa e pritës së mësipërme, skema e devijimit dhe galeria e kontrollit dhe çimentimit, në sipërfaqen e bazamentit të gjithë digës së ardhshme kryesore është ndërtuar prita. Qëllimi i rezervuarit të Banjës përveç prodhimit të energjisë elektrike është modulimi gjatë vitit i shkarkimeve të HEC-eve që do të ndërtohen sipër kaskadës e që do punojnë si HEC të pastër piku, të mbrojnë zonën e poshtme nga vërshimet katastrofike, si dhe të përdoret gjatë pranverës dhe verës për qëllime vaditje.

Në kërkesat e Autoritetit Kontraktues, të deklaruara në Dokumentet Standarde të Procedurës Konkurruese dhe Ofertës së Koncesionarit, lidhur me kriteret e vlerësimit të ofertave, ku janë pagesa e koncesionit në %, matrica e kohës së ndërtimit, është dhe bonusi i përfituar nga E. sh.a. i miratuar me VKM nr. 463, dt 18.07.2007 me vlerën 10 pikë. Në VKM është vendosur se: *“1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentraleve, në kaskadën e lumit Devoll, nga kuota 805-100 m mbi nivelin e detit, përfshirë edhe ndërtimin e hidrocentralit të Banjës, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. 2. Miratimin e bonusit prej 10 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “E.” sh.a. Data e shpalljes së njoftimi ishte 06.08.2007.”*

Në pjesën e kushteve të kontratës, në formularin e deklarimit të ofertës, ofertuesi konfirmon pajtimin e tij për të firmosur kontratën sipas formularit të Kushteve të Kontratës, nëse shpallet fitues. Në seksionin e Kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës Koncesionare përcaktohet se: A.Terma të Përgjithshme të MK, 7.

**Koncesionari është i interesuar të investojë në ndërtimin e hidrocentraleve me qëllimin e prodhimit të energjisë elektrike dhe rritjen e sigurisë të furnizimit me energji elektrike të gjithë vendit. 11. Shërbimi Publik, Marrëveshja Koncesionare bazohet në Ligjin për Koncesionet dhe pavarësisht Autoriteti Kontraktues ose ERE mund ti kërkojnë**

**Koncesionarit të përmbushë disa detyrime të shërbimit publik në furnizimin me energji elektrike.**

**C. Të drejtat dhe detyrimet e palëve, koncesionari duhet të marrë masa të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet, që eventualisht mund t'i shkaktohen palëve të treta.**

**E. 20. Çështjet e panegociueshme,** - Akses të plotë të Autoritetit Kontraktues dhe ERE në regjistrat e punës së Koncesionarit. – Detyrimi i Koncesionarit dhe shoqërisë së projektit për të paguar taksat, detyrimet dhe taksat e tjera sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë. – Pagesa e të drejtës koncesionare do të jetë në % fituese kWh, jo më pak se 2% të vleftës absolute të prodhimit të energjisë elektrike. – detyrimi i koncesionarit për të përmbushur kërkesat e Autoritetit Kontraktues ose ERE për tu përshtatur me detyrimet e shërbimit publik. (cituat më sipër).

F. Zbatimi dhe interpretimi i kësaj kontrate koncesioni do të bazohet në legjislacionin shqiptar në fuqi dhe çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë kontratë do të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Ftesa për ofertë është botuar në revistën F. T. U., si dhe në gazetën “K. J.”. Gjithashtu janë dërguar ftesa për ofertë Bankës Botërore, Dhomës së Tregtisë Italiane, ambasadave të ndryshme.

Për dokumentet standarde të procedurës konkurruese kanë shpallur interes, A. spa, D. Albania shpk, E. A., T. Sa. G.G., C. O. Spa, S. , E. shpk, E. H. AD, R. P. K. L.L.C, E. shpk, L.& K.H. dhe K. I. d.d. S..

Në raportin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me nr. 5850/6 datë 30.01.2008, drejtuar Ministrisë të METE, komisioni relaton se u paraqitën dy oferta nga shoqëria L. me seli në Islandë dhe shoqëria E. A.. Nga shqyrtimi i dokumenteve u konstatua se shoqërisë L. i mungonte sigurimi i ofertës, dokumente për kapacitetet financiare, kapacitetet teknike, në ofertën teknike nuk kishte përfshirë HEC-in e Banjës, ka prezantuar plan biznesin vetëm për një Hec. KVO ka vendosur në unanimitet skualifikimin e ofertës dhe me shkresën nr. 5850/5 datë 22.01.2008 ka bërë njoftimin shoqërisë.

KVO ka kërkuar sqarime të mëtejshme nga E.A., dhe pas marrjes së tyre ka shpallur ofertën e tyre si fituese e procedurës me 100 pikë. Bazuar në planin e biznesit do të shpenzohen 950,000,000 euro, nga ku 669,400,000 euro për ndërtime civile dhe 128,600,000 euro për makineri dhe pajisje mekanike e elektrike të një fuqie totale të instaluar prej 319 MWh dhe prodhimin e energjisë elektrike për prurje mesatare shumë-vjeçare prej 985,400 MWh. Analiza ekonomike është kryer në parim pasi investimi për ndërtimin e HEC-eve është kompleks. Norma e brendshme e investimit është 6.5 %. Matrica e kohës së ndërtimit është 6 vjet, pagesa e koncesionit është 2 %, përmbytjet minimale 2,317 ha, sigurimi i rrjedhës minimale në shtratin natyral të lumit 15.6 % dhe ndikimi vizual minimal në vlerën 66.7 %.

METE për negociimin e kontratës koncesionare u këshillua nga eksperti teknik P. me eksperiencë në projektimin/dizenjimin e veprave hidroenergjitike, i cili e vlerësoi projektin në aspektin teknik dhe ekonomik të tij si dhe për anën ligjore u konsultua eksperti ligjor P. & M.. E. ka propozuar për përfshirjen në koncesion të shoqërisë S. A., si ortakë me të drejta dhe detyrime solidare.

Në projektin e paraqitur nga E.. për HEC-in e Banjës, në pikën 6.b Respektimi optimal i aspekteve ekologjike dhe mjedisore, Sigurimi i rrjedhës minimale në shtratin natyral të lumit, i vlerësuar me 5 pikë, citohet se projekti duhet të sigurojë një rrjedhje të vazhdueshme në të gjithë shtratin natyral të lumit, në masën jo më pak se 15 % të prurjeve natyrale, për të garantuar zhvillimin e florës dhe faunës në këtë lumë.

Në pjesën e kritereve të përgjithshme të pjesëmarrjes, lidhur me strukturat ekzistuese në Banjë, plani i zhvillimit duhet të ketë dhe modulimin e daljeve të ujit në rrjedhën e poshteme të HEC-it gjatë një viti të plotë hidrologjik (dalja outflow me të paktën 30 m<sup>3</sup>/s) për të përmirësuar vaditjen.

Në relacionin e oponencës teknike shtetërore, të ngritur nga METE me urdhrin nr. 303, datë 08.05.2007, me kryetar S. P. e anëtarë F. H., L. Dh., K. K., L. T., E. P. e K. Z., për studimin e fizibilitetit të paraqitur nga shoqëria austriake E., fituese e procedurës, në pjesën e konkluzioneve lidhur me hidrocentralin e Banjës citohet se duhet të planifikohet edhe për sigurimin e ujit për vaditje. Çfarëdo skeme që mund të zgjidhet për shfrytëzimin e lumit Devoll, asnjë nga hidrocentralet sipër hidrocentralit të Banjës nuk arrin të plotësojë nevojat për ujitje në të ardhmen të zonës poshtë këtij hidrocentrali.

Me ligjin Nr.10 083, datë 23.2.2009, është miratuar e kontrata e koncesionit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues dhe A. A., S. A. dhe D. H. sha, si bashkëkoncesionarë, për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin devoll në Republikën e Shqipërisë.

-Ligj nr. 10 337, datë 21.10.2010, “Për një shtesë dhe ndryshim në Ligjin nr. 10 083, datë 23.02.2009 “Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si Autoritet Kontraktues dhe A. A., S. A. dhe D. H. SHA, si bashkëkoncesionarë, për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Projektit të Hidrocentralit në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë””.

-Ligj nr. 105/20013, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10 083, datë 23.02.2009 “Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si Autoritet Kontraktues dhe A. A., S. A. dhe D. H. SHA, si bashkëkoncesionarë, për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Projektit të Hidrocentralit në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. ”

Sipas statutit të shoqërisë D. H., aksionarët fillestarë në momentin e themelimit të shoqërisë ishin shoqëria S. A. me 50% të aksioneve të kapitalit dhe shoqëria E. A. me 50% të aksioneve të kapitalit.

Më datë 28.01.2013, me anë të marrëveshjes së shitjes së aksioneve, shoqëria S. A. i shet 50% të aksioneve të saj shoqërisë S. M. B., kundrejt çmimit 21.213.000 (njëzet e një milion e dyqind e trembëdhjetë) Euro, duke u larguar kështu nga shoqëria.

Më datë 27.02.2013, me anë të marrëveshjes së shitjes së aksioneve, shoqëria E. A. i shet 50% të aksioneve që ajo zotëron shoqërisë E. B. 40 GmbH, duke u larguar kështu nga shoqëria.

Më datë 07.05.2013, me anë të kontratës së transferimit të kuotave No.1000 Kol, No.746 Rep, shoqëria E. B. 40 GmbH i shet aksionarit tjetër, shoqërisë “S. M. B.V”, 50% të aksioneve që ajo zotëron, duke u larguar kështu nga shoqëria. Pas shitjes shoqëria “S. M. B.V” mbetet aksionari i vetëm me 100% të kapitalit.

-Në procesin e auditimit mbi zbatimin e kriterëve dhe procedurave të përcaktuara sipas legjislacionit, për realizimin e kontratës së Koncesionit u konstatuan parregullsitë:

-Në studimin e fizibilitetit mbi përgatitjen e studimit paraprak të projektit, u konstatua se mungonte një paraqitje e detajuar e kostove paraprake të projektit.

-Nga autoriteti kontraktor nuk ishte bërë analizë nëse projekti i hartuar ishte ekonomikisht më i favorshëm krahasuar me alternativën e prokurimit tradicional.

**1. Titulli i gjetjes:** Ndryshime thelbësore në hartimet e kontratave me operatorët fitues nga kërkesat e kërkuara në dokumentet standarde të procedurës konkurruese.

**Situata:** Në kontratën përfundimtare të Autoritetit Kontraktor me Koncesionarin, të aprovuar me ligjin nr. 7/2015, datë 12.02.2015, dhe me ligjet e mëparshme janë kryer ndryshime të rëndësishme nga dokumentet e procedurës së koncesionit si vijon:

Në pjesën e kushteve të kontratës, në formularin e deklaramit të ofertës, ofertuesi konfirmon pajtimin e tij për të firmosur kontratën sipas formularit të Kushteve të Kontratës, nëse shpallet fitues. Në seksionin e Kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës Koncesionare përcaktohet se: A.Terma të Përgjithshme të MK, C. Të drejtat dhe detyrimet e palëve, koncesionari duhet të marrë masa të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet, që eventualisht mund t'i shkaktohen palëve të treta. E. 20. Çështjet e panegociueshme, - Akses të plotë të Autoritetit Kontraktues dhe ERE në regjistrat e punës së Koncesionarit. -Detyrimi i Koncesionarit dhe shoqërisë së projektit për të paguar taksat, detyrimet dhe taksat e tjera sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë. – Pagesa e të drejtës koncesionare do të jetë në % fituese kWh, jo më pak se 2% të vlefës absolute të prodhimit të energjisë elektrike. – detyrimi i koncesionarit për të përmbushur kërkesat e Autoritetit Kontraktues ose ERE për tu përshtatur me detyrimet e shërbimit publik. (cituar më sipër). F. Zbatimi dhe interpretimi i kësaj kontrate koncesioni do të bazohet në legjislacionin shqiptar në fuqi dhe çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë kontratë do të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Më pas në shtesat e kontratave kushtet fillestare kanë ndryshuar duke e kaluar riskun te Autoriteti Kontraktues.

-Pagesa e detyrimeve fiskale sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, në kontratë është ndryshuar duke e përjashtuar koncesionarin nga tatimi mbi vlerën e shtuar për mallrat e importit dhe ato brenda vendit si dhe të gjitha ndryshimet në taksa gjatë viteve.

-Gjykimi i mosmarrëveshjeve mes palëve është akorduar për tu zgjidhur në Gjykatën e Arbitrazhit.

**Kriteri:** Ndryshimi i kushteve thelbësore të kontratës është në kundërshtim me nenin nr.1., të Ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006, i ndryshuar, “Për koncesionet”, ku citohet: *Qëllimi i ligjit, Qëllimi i këtij ligji është të krijojë kuadrin e nevojshëm për nxitjen dhe lehtësimin e zbatimit të projekteve koncesionare, të financuara nga sektori privat, duke rritur transparencën, barazinë, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë në zhvillimin e projekteve të infrastrukturës dhe të shërbimeve publike. Ai synon zhvillimin e mëtejshëm të parimeve të përgjithshme në lidhjen e kontratave nga autoritetet publike, nëpërmjet përcaktimit të procedurave të veçanta për dhënien e projekteve koncesionare dhe me nenin nr.21., Caktimi i ofertuesit më të mirë dhe negociimet përfundimtar, pika 2, ku citohet: “**Kushtet kontraktuale, të deklaruara të panegociueshme në kërkesën përfundimtare për propozime, nuk do të jenë objekt i negociimeve përfundimtare.**”*

**Ndikimi/Efekti:** Ndryshimet e mëpasshme në kontratë kanë sjellë shkeljen e barazisë në procedurën e përzgjedhjes së koncesionarit.

**Shkaku:** Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit sa dhe si duhet nga autoriteti kontraktues

**Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në të ardhmen në procesin e finalizimit të kontratave me operatorët fitues, të mos ndryshojë termat e përgjithshme dhe të veçanta të procedurave të përzgjedhjes së ofertuesve pasi sjell shkeljen e barazisë në procedurën e përzgjedhjes së koncesionarit, dhe uljen e transparencës, barazisë, efikasitetit dhe qëndrueshmërinë afatgjatë në zhvillimin e projekteve të infrastrukturës dhe të shërbimeve publike.

**2. Titulli i gjetjes:** Marrja e risqeve jo të justifikuara nga autoriteti kontraktor

**Situata:** Në pikën C., të marrëveshjes koncesionare pjesë e dokumenteve të procedurës koncesionare citohet: *“Të drejtat dhe detyrimet e palëve, koncesionari duhet të marrë masa të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet, që eventualisht mund t'i shkaktohen palëve të treta.”*

Më pas në shtesat e kontratave kushtet fillestare kanë ndryshuar duke e kaluar riskun te Autoriteti Kontraktues. -Në pikën 3.7, të shtesës së kontratës është përcaktuar se d) *Autoriteti Kontraktues do të jetë përgjegjës ndaj Koncesionarit për të gjitha kostot, dëmet dhe humbjet që lindin nga çfarëdo mospërfundim i Infrastrukturës Zëvendësuese në afatet e përcaktuara; e) Autoriteti Kontraktues do të mbajë të pacenuar dhe do të dëmshpërblejë Koncesionarin për të gjitha pretendimet, dëmet dhe humbjet që vijnë prej furnitorëve dhe kontraktorëve të tjerë ose çdo palë tjetër të tretë në lidhje me planifikimin, projektimin dhe tenderimin e Infrastrukturës Zëvendësuese ose lidhen me Infrastrukturën Zëvendësuese.*

**-Për sa më sipër duke u nisur nga fakti që Koncesionari do kryejë të gjithë procesin e planifikimit, projektimit dhe tenderimin e Infrastrukturës Zëvendësuese, nuk janë të qarta arsyet justifikuese përse Autoriteti Kontraktues duhet të merrte përsipër risqet për dëmshpërblim për humbjet që mund të vinin nga furnitorët dhe kontraktorët ose çdo palë tjetër në proces.**

**Kriteri:** Ndryshimi i kushteve thelbësore të kontratës është në kundërshtim me nenin nr.2., të Ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006, i ndryshuar, “Për koncesionet”, pika 3, ku citohet: *“Koncesion” është marrëveshja, pavarësisht nga emri që i jepet, ndërmjet autoritetit kontraktues dhe koncesionarit, ku përcaktohen kërkesat dhe kushtet e saj dhe në kuptimin e së cilës koncesionari: a) realizon një veprimtari ekonomike që, në të kundërt, do të kryhej nga autoriteti kontraktues për një projekt koncesioni, kontratë administrimi apo shërbime të tjera publike; b) merr përsipër të gjitha ose një pjesë thelbësore të rrezikut të lidhur me këtë veprimtari ekonomike;”*

**Ndikimi/Efekti:** Marrja përsipër e përgjegjësive ndaj palëve të treta ku autoriteti kontraktor nuk ka asnjë lidhje kontraktuale rrit riskun e dëmeve ndaj Buxhetit të Shtetit.

**Shkaku:** Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit sa dhe si duhet nga autoriteti kontraktues

**Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në të ardhmen në procesin e lidhjes së kontratave me operatorët fitues, të mos marrë përsipër rreziqet e lidhura me veprimtarinë ekonomike të cilat i takojnë koncesionarit për tu përballuar.

**3. Titulli i gjetjes: Mos hartimi i kushteve të qarta për arritjen e qëllimit kryesor të koncesionit që ishte prodhimi i energjisë elektrike dhe rritja e sigurisë të furnizimit me energji elektrike në të gjithë vendin.**

**Situata:** Në Masterplanin e vitit 2003-2015, “Për zhvillimin e sektorit të gjenerimit të energjisë elektrike” është përcaktuar se për të përballuar nevojat shtese elektroenergjitike dhe për të reduktuar nivelin shumë të lartë të importit, parashikohet të ndërtohen HEC-e, që do të rrisin sigurinë e furnizimit me energji elektrike në të gjithë vendin.

Nga shqyrtimi i kushteve fillestare të procedurës së përzgjedhjes së koncesionarit dhe deri në ndryshimet përfundimtare të kontratës lidhur me operatorin ekonomik fitues u konstatua se ky objektivi nuk është përcaktuar qartë dhe me terma të matshëm në kushtet kontraktuale.

Në seksionin e Kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës Koncesionare, të dokumenteve të procedurës së koncesionit, përcaktohet se: A.Terma të Përgjithshme të MK, 7.

**Koncesionari është i interesuar të investojë në ndërtimin e hidrocentraleve me qëllimin e prodhimit të energjisë elektrike dhe rritjen e sigurisë të furnizimit me energji elektrike të gjithë vendit. 11. Shërbimi Publik, Marrëveshja Koncesionare bazohet në Ligjin për Koncesionet dhe pavarësisht Autoriteti Kontraktues ose ERE mund t'i kërkojnë Koncesionarit të përmbushë disa detyrime të shërbimit publik në furnizimin me energji elektrike.**

- Në kontratë është përcaktuar se koncesionari mund ta shesë energjinë elektrike në eksport pa asnjë kufizim. Ky përcaktim ka devijuar objektivin kryesor që ishte rritja e kapaciteteve energjitike në vend, pasi koncesionari pasi ka filluar prodhimin e energjisë ka vënë në dispozicion sasi të vogla energjie brenda vendit.

Termat e përgjithshme të Marrëveshjes Koncesionare nuk janë reflektuar në detyrime specifike për sasinë e energjisë elektrike për të furnizuar brenda vendit, të përcaktuara në sasi e vlera për tu bërë të detyrueshme për tu zbatuar gjatë zbatimit.

Arsyetimet e bëra nga Autoriteti Kontraktor ishin se duhet të zbatonin modelin e ri të tregut, nuk qëndrojnë pasi shumë vende të BE, në koncesione të ngjashme kanë vendosur kushte që detyronin koncesionarët të furnizojnë sasi dhe çmime të ulëta për komunitetin. I tillë është shembulli i Norvegjisë ku koncesionarët janë të detyruar të lëvrojnë 10 % të energjisë së prodhuar tek autoritetet lokale ku ndodhet ndodhet baseni, me kosto të ulët ose me kosto prodhimi.

**Kriteri:** Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me nenin nr.27., të Ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006, i ndryshuar, “Për koncesionet”, pika a, ku citohet: “Kontratat e koncesionit parashikojnë ato çështje që vlerësohen të përshtatshme nga palët, të tilla si: a) natyra dhe objekti i punëve që duhet të kryhen dhe shërbimet që duhet të jepen nga koncesionari”.

**Ndikimi/Efekti:** Mos reflektimi i detyrimeve për furnizimin me energji elektrike brenda vendit në kontratën përfundimtare ka sjellë dhe devijimin e qëllimit kryesor të koncesionit, që ishte rritja e kapaciteteve furnizuese me energji elektrike brenda vendit.

**Shkaku:** Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit sa dhe si duhet nga autoriteti kontraktues

**Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në të ardhmen në procesin e lidhjes së kontratave me operatorët fitues, të përcaktojë qartë, saktë, me vlera e sasi të matshme objektivat kryesore të koncesionit.

**4. Titulli i gjetjes:** Heqja e detyrimit të pagesës së tarifës së koncesionit për një periudhë 15 vjeçare.

**Situata:** Në dokumentet standarde të procedurës së zgjedhjes së operatorit fitues ishte parashikuar si kusht për zgjedhjen fitues, Tarifa e Koncesionit jo më e vogël se 2 %. Megjithëse në ofertën fituese kjo tarifë ishte 2 %, në kontratën e fundit përcaktohet mos pagesa e tarifës për 15 vjet, siç citohet në pikën 2.10, Në nenin 4.1.1. do të shtohet në fund paragrafi që vijon: “Pavarësisht sa më sipër, Koncesionari nuk do të paguajë Tarifën e Koncesionit sipas këtij neni 4.1.1 “a” dhe “b”, për hidrocentralin e Banjës dhe të Moglicës për një periudhë 15-vjeçare duke filluar nga data e lëshimit të Certifikatës së Përfundimit Final të Hidrocentralit të Banjës”.

Shpjegimi i dhënë nga zv. Ministri z. I. B. ishte se heqja e tarifës së koncesionit u bë për arsye se shoqëria e D.H. mori përsipër të kryej shërbimet e tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorëve për projektimin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen e Infrastrukturës Zëvendësuese, duke financuar fillimisht vetë dhe më pas nga financimet e buxhetit të shtetit. Ky justifikim nuk qëndron sepse Autoriteti Kontraktor mori përsipër pagesën e koston totale të shpenzimeve duke filluar nga viti 2015 deri në vitin 2019. Autoriteti Kontraktor nuk vuri në dispozicion vlerësimet e kryera se sa do të ishte kosto

nëse projekti do të finançohej me kredi nga bankat e nivelit të dytë krahasuar me variantin e financimit nga Devoll Hydropower sh.a.

**Kriteri:** Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me nenin nr.21., të Ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006, i ndryshuar, “Për koncesionet”, Caktimi i ofertuesit më të mirë dhe negocimet përfundimtar, pika 2, ku citohet: *“Kushtet kontraktuale, të deklaruara të panegociueshme në kërkesën përfundimtare për propozime, nuk do të jenë objekt i negociimeve përfundimtare.”*

**Ndikimi/Efekti:** Përjashtimi i pagesës së tarifës së koncesionit prej 2%, ka sjellë të ardhura të munguara për Buxhetin e Shtetit në vlerën 5,119,000 Euro deri në gusht 2022.

**Shkaku:** Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit si duhet e pasojave të heqjes së pagesës së tarifës së koncesionit.

**Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi:** Nga Autoriteti Kontraktor të analizohet vlera 5,119,000 euro, vlerë e cila vjen nga përjashtimi i pagesës së tarifës së koncesionit, dhe të merren masa për tu mos u përsëritur në të ardhmen, pasi kjo vlerë për Buxhetin e Shtetit, përbën të ardhura të munguara.

-Në lidhje me në pikën 6.b, Respektimi optimal i aspekteve ekologjike dhe mjedisore, Sigurimi i rrjedhës minimale në shtratin natyral të lumit, i vlerësuar me 5 pikë, ku citohet se projekti duhet të sigurojë një rrjedhje të vazhdueshme në të gjithë shtratin natyral të lumit, në masën jo më pak se 15 % të prurjeve natyrale, për të garantuar zhvillimin e florës dhe faunës në këtë lumë u konstatuan si vijon.

Kërkesës së METE për dhënie mendimi, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, i ka dhënë përgjigje me shkresën nr. 110 Prot., datë 11.01.2009.

-Duke qenë se lumi Devoll në pjesë të veçanta të rrjedhës së tij shërben edhe si burim ujor për ujitje, ka kërkuar që në kontratën e koncesionit ndërmjet autoritetit kontraktues dhe koncesionarit, të përcaktohen qartë nevojat për ujë për ujitje, që ka bujqësia gjatë periudhës së ujitjes (periudha Maj-Gusht). Kjo për faktin se me ujërat e lumit Devoll është e lidhur ujitja e rreth 70 000 ha tokë bujqësore dhe në funksion të kësaj janë bërë investime të konsiderueshme në rehabilitimin e infrastrukturës së ujitjes në mjaft zona të vendit. Për bujqësinë nga hidrocentrali i Banjës duhet të merren rreth 150 milion m<sup>3</sup> ujë nga rrjeti i poshtëm që shfrytëzohen me rrjedhje të lirë dhe konkretisht:

-nëpërmjet digës së Vlashukut dhe rezervuarit të Thanës dhe rrjetit ekzistues ujitës merren nga lumi Devoll rreth 100 milion m<sup>3</sup> ujë në periudhën Mars-Shtator për mbushjen e rezervuarit të Thanës nëpërmjet të cilit realizohet ujitja e rreth 40 000 ha tokë bujqësore në rrethet e Lushnjës dhe të Fierit;

-nëpërmjet kanalit lidhës Banjë -Shkumbin duke u kombinuar me rrjetin ekzistues të kanalit Peqin Kavajë (zona e poshtme e Dumresë dhe fushat e Cërrikut, Peqinit dhe Kavajës) shfrytëzohet rreth 40 milion m<sup>3</sup>; nëpërmjet digës së Vlashukut në rrethin e Kuçovës dhe Fierit shfrytëzohen rreth 10 milion m<sup>3</sup> ujë;

-bujqësisë për ujë për ujitje nga lumi Devoll gjatë sezonit të ujitjes i arrijnë në rreth 150 milion m<sup>3</sup> ujë. Në këto kushte kërkesa duhej marrë në konsideratë pasi plotësimi i nevojave për ujë për ujitje nga lumi Devoll është jetik për zhvillimin e bujqësisë në zonat fushore të Lushnjës, Fierit, Kavajës Elbasanit, Beratit e Korçës.

**-Kërkesa e Ministrit të MBUMK, për përcaktime të sakta për ujin për vaditje si dhe parametrat e projektit fillestar për sigurimin e rrjedhës së vazhdueshme të ujit gjatë gjithë**

**vitit për sigurimin e florës dhe faunës së lumit, nuk janë pasqyruar në kontratën përfundimtare mes palëve.**

Ndryshimi i kushteve thelbësore të kontratës ka sjellë shkeljen e barazisë në procedurën e përzgjedhjes së koncesionarit, veprime në kundërshtim me nenin nr.1., të Ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006, i ndryshuar, “Për koncesionet”, ku citohet: *Qëllimi i ligjit, Qëllimi i këtij ligji është të krijojë kuadrin e nevojshëm për nxitjen dhe lehtësimin e zbatimit të projekteve koncesionare, të financuara nga sektori privat, duke rritur transparencën, barazinë, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë në zhvillimin e projekteve të infrastrukturës dhe të shërbimeve publike. Ai synon zhvillimin e mëtejshëm të parimeve të përgjithshme në lidhjen e kontratave nga autoritetet publike, nëpërmjet përcaktimit të procedurave të veçanta për dhënien e projekteve koncesionare.*

-Në lidhje me zëvendësimin e infrastrukturës që do të përmbijet nga digat e ngritura është proceduar:

Në shtesën e 3-të të Kontratës së Koncesionit për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Projektit të Hidrocentralit në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë e lidhur më datë 19 dhjetor 2008, e cila është miratuar nga Parlamenti Shqiptar nëpërmjet ligjit nr. 10083, datë 23 shkurt 2009 dhe plotësuar nga shtesa e 1-rë e Kontratës së Koncesionit datë 3 gusht 2010, e cila është miratuar me ligjin nr. 10337, datë 21 tetor 2010, dhe plotësuar nga shtesa e 2-të e Kontratës së Koncesionit datë 19 mars 2013, e cila është miratuar me ligjin nr. 105/2013, datë 28 mars 2013 midis: 1. Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë së Republikës së Shqipërisë, ish-Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (“MEI” ose “Autoriteti Kontraktues”), dhe 2. a) S. A., një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit të Mbretërisë së Norvegjisë me seli në Lilleakerveien 6, 0283 Oslo, Norvegji, b) D. H. sh.a., një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, me seli në Tiranë, Shqipëri (Shoqëria e Projektit), janë bërë përcaktimet kryesore të modaliteteve të pagesave të kryera nga MIE (ish MEI, METE), për disbursimin e shpenzimeve për ngritjen e Infrastrukturës ekzistuese në Hidrocentralet e Banjës dhe Moglicës.

Sipas nenit 7.2.6 të Kontratës së Koncesionit dhe marrëveshjes “Për mënyrën e pagesave në lidhje me Infrastrukturën Zëvendësuese (“rrugët dhe urat”) të lidhur midis Shoqërisë së Projektit, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar më 5.9.2013 “Marrëveshje mbi mënyrën e pagesës” është rënë dakord se shumica që Koncesionari do t’i paguajë Autoritetit Kontraktues si kompensim për Infrastrukturën Zëvendësuese do të jetë 10.550.000 euro (dhjetë milionë e pesëqind e pesëdhjetë mijë euro).

Meqënëse Autoriteti Kontraktues nuk ka përmbushur në kohë detyrimet në lidhje me planifikimin, projektimin dhe ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese dhe nuk ka arritur të sigurojë fondet e nevojshme për planifikimin, projektimin dhe ndërtimin e saj, Ministria e Energjisë dhe Industrisë i kërkoi Koncesionarit në mbledhjen e datës 10.10.2013 gjetjen e një zgjidhjeje alternative për financimin, projektimin dhe ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese për shkak të mungesës së fondeve.

Shoqëria e Projektit, D. H. ., Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARRSH), në datë 14.2.2014, lidhën një kontratë “Në lidhje me projektimin dhe tenderimin e Infrastrukturës Zëvendësuese (Rrugët dhe Urat) dhe ndërtimin e rrugës M15 të Infrastrukturës Zëvendësuese të Moglicës” (Marrëveshja e Infrastrukturës Zëvendësuese), me anë të së cilës



Shoqëria e Projektit mori përsipër të projektonte dhe kryente procedurën e tenderimit të Infrastrukturës Zëvendësuese, si dhe të ndërtonte rrugën M15 të Infrastrukturës Zëvendësuese të Moglicës, me kusht që palët të nënshkruanin një shtesë të Kontratës së Koncesionit me anë të së cilës Koncesionari merr përsipër detyrimin të projektojë, tenderojë dhe ndërtojë Infrastrukturën Zëvendësuese kundrejt një kompensimi të drejtë dhe të kënaqshëm për shpenzimet shtesë të saj.

Në ndryshimet e reja është përcaktuar se Koncesionari do të jetë përgjegjës për punimet e Infrastrukturës Zëvendësuese përfshirë financimin, projektimin, planifikimin, tenderimin, ndërtimin, dhe dorëzimin e Infrastrukturës Zëvendësuese me kusht që Autoriteti Kontraktues të kompensojë plotësisht Koston e Infrastrukturës Zëvendësuese. Në veçanti, Koncesionari pritet që: Do të sigurojë mjetet financiare të nevojshme për planifikimin, projektimin dhe ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese, që përcaktohet në nenin 7.2.7.3. Vlerësimi fillestar kostove përkatëse përpara marrjes së ofertave të tenderit, bazuar në projekt-identë ishte në shumën 49,646,269 euro, siç është përcaktuar më hollësisht në aneksin I bashkëngjitur. Kjo shumë do të përditësohet pas miratimit të propozimit të projektit të detajuar nga enti shtetëror (ARRSH). Kostoja e parashikuar e projekteve përkatëse, e miratuar nga enti shtetëror përkatës (ARRSH) do të shërbejë si limit për procesin e tenderimit, siç përcaktohet në nenin 3 të kësaj Shtese të 3-të. Këto shuma të parashikuara në projektin e detajuar nuk përbëjnë kostot finale të rimbursueshme sipas kësaj Marrëveshjeje dhe janë përditësuar gjatë fazës së ndërtimit të Infrastrukturës Zëvendësuese, me miratimin paraprak të ARRSH-së, siç përcaktohet në paragrafin e dytë të nenit 3.5. Koncesionari do të sigurojë projektimin e Infrastrukturës Zëvendësuese në përputhje me kërkesat teknike, siç parashikohet në aneksin II bashkëngjitur dhe legjislacionin shqiptar përkatës deri në masën që ky i fundit është i zbatueshëm dhe në përputhje me aneksin II, si dhe të propozojë modifikime të këtyre projekteve ose riprojektme nëse konsiderohen të nevojshme;

Do të organizojë tenderë dhe lidhë kontratat për punimet lidhur me planifikimin, projektimin dhe ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në Marrëveshjen e Infrastrukturës Zëvendësuese bashkëngjitur si aneksi III, si dhe do të organizojë dhe mbikëqyrë punët për planifikimin, projektimin dhe ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese siç parashikohet në Marrëveshjen e Infrastrukturës Zëvendësuese bashkëngjitur si aneksi III dhe legjislacionin shqiptar përkatës deri në masën që ky i fundit është i zbatueshëm dhe në përputhje me aneksin III.

Nga Koncesionari pritet që të dorëzojë tek Autoriteti Kontraktues punimet e përfunduara. Autoriteti Rrugor shqiptar do të fitojë pronësinë mbi Infrastrukturën Zëvendësuese, përfshirë këtu edhe punën në proces gjatë ndërtimit.

Marrëveshja e Infrastrukturës Zëvendësuese ka qenë pjesë integrale e Kontratës së Koncesionit, siç është përcaktuar në aneksin III dhe detyrimet e marra përsipër nga palët e Marrëveshjes së Infrastrukturës Zëvendësuese do të konsiderohen si detyrime të Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit sipas Kontratës së Koncesionit. Pavarësisht kësaj, nëse dispozitat e Marrëveshjes së Infrastrukturës Zëvendësuese bien në kundërshtim me Kontratën e Koncesionit, dispozitat e kësaj të fundit do të kenë përparësi.

Në kontratë është përcaktuar se Koncesionari do të rimbursohet plotësisht për të gjitha shpenzimet e kryera në lidhje me planifikimin, projektimin, tenderimin dhe ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese që vijon: rruga zëvendësuese Banja - Gramsh, Ura e Trashovicës, rruga zëvendësuese Moglicë M15 dhe rruga zëvendësuese Moglice M03, minus 10.550.000 EURO (dhjetë milionë e pesëqind e pesëdhjetë mijë euro) e cila është shuma totale e kompensimit e

pagueshme nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues sipas nenit 7.2.6 të Kontratës së Koncesionit (Kostoja e Infrastrukturës Zëvendësuese).

Nga palët është dakortësuar se rimbursimi i Kostos së Infrastrukturës Zëvendësuese nga Autoriteti Kontraktues tek Koncesionari do të kryhet si më poshtë:

-Autoriteti Kontraktues do t'i paguajë Koncesionarit Koston e Infrastrukturës Zëvendësuese me këste në secilën datë pagese (Datë Pagese) në shuma sipas kështit të pagueshëm (Kësti i Pagueshëm) që aplikohen në Datë-Pagesën përkatëse sipas përcaktimeve në tabelën më poshtë:

Datë pagese	Kësti i pagueshëm
28-shkurt-2015	EUR 8 milionë
28-shkurt-2016	EUR 10 milionë
28-shkurt-2017	EUR 10 milionë
28-shkurt-2018	50% e: Koston totale të Infrastrukturës Zëvendësuese minus Këstet e Pagueshme të paguara dhe çdo shumë të kompensuar në zbatim të nenit 7.2.7.6
28-shkurt-2019	Shuma e mbetur

Në kontratë është përcaktuar qartë se rregullat e prokurimit publik të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar apo në ndonjë akt ligjor që mund të ndryshojë ose të zëvendësojë atë, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij ose në zbatim të ndonjë akti ligjor që mund të ndryshojë ose të zëvendësojë atë, nuk do të zbatohen nga Koncesionari në procesin e tenderimit të projektimit, ndërtimit, mbikëqyrjes ose shërbime të tjera ndihmëse në lidhje me Infrastrukturën Zëvendësuese.

*Përzgjedhja e kontraktorëve të angazhuar në procesin e projektimit, ndërtimit, mbikëqyrjes ose shërbime të tjera ndihmëse në lidhje me Infrastrukturën Zëvendësuese do të kryhet nëpërmjet një procedure konkurruese të përcaktuar nga Koncesionari.* Projektimi, ndërtimi, mbikëqyrja dhe testimi i Infrastrukturës Zëvendësuese do të kryhet nga subjekte të specializuara dhe të licencuara, në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara në aneksin II.

Autoriteti Kontraktues do të monitorojë procedurën e tenderimit të Infrastrukturës Zëvendësuese dhe për këtë qëllim do të caktojë 2 (dy) persona të autorizuar të cilët do t'i nënshtrohen detyrimeve të konfidencialitetit dhe mospublikimit të ndonjë informacioni të marrë gjatë procesit të mësipërm, dhe që do të nënshkruajnë një marrëveshje konfidencialiteti dhe mospublikimi të informacionit me përmbajtje që plotëson kërkesat e Koncesionarit.

Autoriteti Kontraktues dhe/ose çdo Ent tjetër Shtetëror (ARRSH) do të mbikëqyrë ndërtimin, mbikëqyrjen dhe testimin e Infrastrukturës Zëvendësuese nëpërmjet personelit të saj të specializuar.

Koncesionari do të dorëzojë projektin e detajuar final të propozuar dhe vlerat e përditësuara të parashikimit të kostove për çdo pjesë të Infrastrukturës Zëvendësuese përkatëse kur të jetë e mundur, tek Enti Shtetëror përgjegjës (ARRSH) për miratim, miratim i cili nuk duhet të refuzohet pa arsye. Bazuar në miratimin e projektit të detajuar nga Enti Shtetëror, Koncesionari do të realizojë procesin e tenderimit dhe do të njoftojë Autoritetin Kontraktues për vlerën e negociuar të kontratave përpara se të shpallet fituesi. Miratimi i projektit të detajuar nga Enti Shtetëror si dhe vlerat e kontratave do të shërbejnë si bazë për miratimin nga ana e Autoritetit Kontraktues të vlerës së kontratës fituese.

Nga palët është rënë dakord që ARRSH do të monitorojë dhe kontrollojë projektin dhe ndërtimin e aktiviteve në lidhje me Infrastrukturën Zëvendësuese deri në momentin që aktivitetet e përfunduara t'i kalojnë ARRSH-së. Në të njëjtën kohë, çdo ndryshim/devijim nga projekti i miratuar dhe nga pjesa teknike e dokumenteve të tenderit, duke përfshirë termat e referencës dhe specifikimet teknike do t'i nënshtrohen miratimit paraprak të ARRSH-së.

**5. Titulli i gjetjes:** Mos vënie në dispozicion e dokumentacionit të procedura të kryera nga D. H. sh.a.

**Situata:** Në lidhje me rregullshmërinë e procedurave të ndjekura nga shoqëria D. H. për projektimin, ndërtimin, mbikëqyrjes ose shërbime të tjera ndihmëse në lidhje me Infrastrukturën Zëvendësuese, nuk mund të shprehemi pasi nuk janë vënë në dispozicion të grupit të auditimit.

Ky dokumentacion është mbajtur nga vetë D.H. dhe nuk është përcjell në MEI për tu inventarizuar dhe arkivuar në Ministri. Me gjithë insistimin tonë të herëpashershëm që me fillimin e auditimit nëpërmjet kërkesave shkresore, e-mail, apo kërkesave verbale, drejtuar MEI dhe D.H. përsëri ky dokumentacion nuk na u vunë në dispozicion.

Në këto kushte, nuk u krye auditim, mbi ligjshmërinë e shqyrtimit, vlerësimit, kualifikimit, s' kualifikimit të ofertave teknike dhe ofertave ekonomike të shoqërive pjesëmarrëse në këtë procedure tenderimi për përzgjedhjen e kontratave fituese.

**Kriteri:** Mos vënia në dispozicion të auditimit të dokumentacionit të tenderimit bien në kundërshtim me: -Nenin 3.5 të shtesës nr.3 të kontratës së koncesionit të miratuar me ligjin nr. 7, datë 15.02.2015 -Nenin 15 dhe 26, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit".

**Ndikimi/Efekti:** Mos arritja e objektivave të auditimit.

**Shkaku:** Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit sa dhe si duhet nga organet drejtuese të Shoqërisë.

**Rëndësia:** E lartë

**2.2 Monitorimi dhe zbatimi i kontratës/kontratave të ndërtimit dhe mbikëqyrjes** nga Ministrinë/Bashkitë apo çdo Institucioni Publik, të përfshirë në ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Projektit të Hidrocentralit/Hidrocentraleve në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë.

- Realizimi i projektit të zbatimit, sipas përshkrimit konstruktiv, arkitektonik, funksional dhe teknik të projektit të miratuar dhe të zbatuar.

- Kryerja e punimeve civile të ndërtimit sipas preventivit dhe projektit të zbatimit dhe metodat e ndërtimit.

- Teknologjia e përdorur, përputhshmëria e të dhënave teknike për makineritë dhe pajisjet e vendosura në vepër, me specifikimet teknike të miratuara.

- Cilësia e materialeve dhe e punimeve të realizuara në vepër, përputhshmëria e tyre me Kushtet Teknike të Projektimit (KTP) dhe Kushtet Teknike të Zbatimit (KTZ) si dhe standardet përkatëse të PZ. Zbatimi i grafikut të punimeve.

- Ndryshimet në projektin e zbatimit, zbatimi i procedurës për argumentimin dhe miratimin e tyre nga Autoriteti Kontraktues.

**-Mbi auditimin e ushtruar për zbatimin e kontratës së punimeve civile “Rikonstruksion i segmentit 3B (Drizë-Gramsh)”.**

Kontrata e Punimeve Civile me kod Nr. RRC1 “Rikonstruksion i segmentit 3B (Drizë-Gramsh dhe Ura e Drashovicës)”, është nënshkruar me datë 19.12.2014, me Kontraktorin J. “E. & P.” SHPK, me vlerë 7,279,137.55 Euro pa TVSH. Afati i përfundimit të punimeve është 18 muaj. Punimet kanë filluar me datë 16.02.2015 dhe kanë përfunduar me datë 04.08.2016, brenda afatit të përcaktuar.

Projektzbatimi i punimeve është hartuar nga Shoqëria “I. & S.”, në vitin 2014.

Projekt-idea dhe projekti paraprak janë miratuar me Vendim të Këshillit Teknik të ARRSH (KT) nr. 29, datë 23.07.2014. Projektzbatimit i janë bërë ndryshime, rishikime, të miratuara në KT, të cilat kanë ndikuar edhe në vlerën e preventivit bazë, konkretisht:

Sipas Vendimit të KT nr.92 date 29.12.2016, në projektin origjinal ishte parashikuar ndërtimi i urës së Trashovicës me 12 hapësira drite, secila me gjatësi 24.7 m. Pas një studimi të projektit, u arrit në përfundimin që mund të bënin një reduktim të numrit të hapësirave nga 12 në 9 hapësira drite, secila me gjatësi 24.7 m, pa dëmtuar rrjedhën e lumit të Devollit.

Ndërtimi i pilotave të shpatullës A1 të urës ishte i pamundur sepse ajo ishte vendosur nën linjën 110 kv të tensionit të lartë. Për të realizuar ndërtimin e tyre nevojitej zhvendosja e linjës së tensionit të lartë gjë që ishte e pamundur.

Projektuesi vendosi të mos ndërtoheshin pilotat dhe propozoi rritjen e thellësisë së themelit të shpatullës së urës. Kursimi në koston e ndërtimit të urës pas këtij ndryshimi është 10.000 Euro.

Në Janar 2016 në rrethin e Gramshit pati reshje shirash të rëndë. Si pasojë një tombino rrethore dhe një mur në km 13+890 u shkatërruan. Si pasojë, doli i nevojshëm ndërtimi i tombinos dhe murit mbajtës.

Kontrata ka të bëjë me ndërtim seksioni rruge të re me gjatësi 1.933 kilometër dhe rehabilitim i asaj ekzistuese me gjatësi 4.195 kilometër dhe përfshin punimet si më poshtë:

Punime gjurmimi me vlerë 3.38 milionë Euro.

Shtesa rrugore me vlerë 1.29 milionë Euro.

Mure mbajtës, tombino dhe struktura të vogla betoni, drenazhime me vlerë 1.48 milionë Euro.

Ura e Drashovicës me vlerë 1.19 milionë Euro.

Ura nr. 13, me vlerë 1.07 milionë Euro.

Pajisje rrugore me vlerë 0.18 milionë Euro.

Në këtë kontratë përfshihen edhe shpenzime të përgjithshme me vlerë 0.56 milionë Euro.

Vlera fillestare e objektit ishte 7,279,137.55 Euro (pa TVSH), ku pas rishikimeve, vlera e objektit është përcaktuar 9,303,155.55 Euro (pa TVSH). Situacioni përfundimtar i punimeve mban vlerën 9,303,155.55 Euro (pa TVSH).

Nga auditimi i dokumentacionit teknik rezulton se janë realizuar punimet për rialokimin e linjave elektrike dhe tubacione të ujit. Vlera e parashikuar sipas zërit 1.A.10, ishte 40,000 Euro, e cila gjatë zbatimit të kontratës është shtuar duke e certifikuar me vlerë 95,947.9 Euro. Për realizimin e punimeve janë hartuar preventivat përkatës. Në preventiv janë përfshirë edhe furnizim vendosje shtylla betoni të centrifuguara, reference e të cilëve janë dhe në manualet e çmimeve të ndërtimit. Çmimi i aplikuar dhe çmimi i referencës në manualet, paraqitet si më poshtë:

Përshkrimi	Sasia	Çmimi i aplikuar lekë	Çmimi sipas manualit lekë	Diferenca lekë
Shtyllë e centrifuguar betoni TM 8 m	4	20,000	14,210	23,160
Shtyllë e centrifuguar betoni TM 9 m	1	41,020	15,225	25,795
Shtyllë e centrifuguar betoni TM 10 m	9	37,000	22,000	135,000
Shtyllë e centrifuguar betoni TM 12 m	11	42,500	25,000	192,500
Shuma:				376,445

Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me Kontratën F., pika 14.01.c, si dhe VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Pika 2, ku përcaktohet:

*“Manuali teknik i çmimeve për punimet e ndërtimit ose thjesht manuali i çmimeve të ndërtimit, është buletini periodik i çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe i analizave teknike të çmimeve, i detyrueshëm për zbatim, sipas pikës 2 të këtij vendimi”.*

**Vlera 376,445 lekë ose 2,690 Euro**, është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori J. “E.& P.” SHPK dhe përbën dëm ekonomik.

Gjatë zbatimit të kontratës është bërë ndryshim sa i takon testimit të pilotave, dokumentacioni në proces shqyrtimi.

Nga verifikimi i punimeve sipas zërit 8 “Ditë pune”, u konstatuan mangësi si më poshtë:

- Paraqiten të angazhuara mekanizma dhe punëtori mbi 8 orë pune, në ndonjë rast dhe 16 orë pune. Si rast mund të përmendim periudhën nga data 06.01.2016 deri me datë 11.01.2016, ku është paraqitur marrja e masave mbrojtëse dhe realizimi i devijimit në dëmtimin e rrugës nga kilometër 13+ 880 deri kilometër 13 + 910. Për një distancë 30 ml, janë angazhuar automjete dhe mekanizma si më poshtë:


- Automjet transport punonjësish 31 orë.
- Fuoristradë 5 orë.
- Kamion 10 deri 20 ton - 100 orë.
- Ekskavator 0.65 m<sup>3</sup> – 66 orë.
- Ekskavator 360<sup>0</sup>, kovë 2.5 m<sup>2</sup>, 123 orë.
- Fadromë 3 m<sup>3</sup> – 30 orë.
- Rrul pneumatik 15 ton 70 orë.
- Gjenerator 10 kVA – 66 orë.
- Vinç – 6 orë.

Për realizimin e një devijimi jo të konsiderueshëm, është likuiduar vlera 19,070 Euro.

Në lidhje me proceset e realizuara si më sipër nuk justifikohet përdorimi i një vinçi apo përdorimi i një gjeneratori. Angazhimi njëherësh i tre mjeteve të rënda gjermues nuk justifikon angazhimin e vetëm dy automjeteve të transportit, po ashtu gjatë realizimit të procesit të gjermimit të tre mjeteve të rënda gjermimi në një seksion 30 ml, nuk mund të përdoret njëkohësisht rul për ngjeshje shtresash. Në dokumentin justifikues (format excel), është paraqitur shënimi se ruli nuk punoi, por ishte prezent gjithë ditën. Në dokumentacionin justifikues nuk është paraqitur asnjë foto e realizuar gjatë zbatimit të punimeve. **Vlera 5,960 Euro** (Rrul 70 orë x 30 Euro/orë, gjenerator 66 orë x 40 Euro/orë, vinç 6 orë x 75 Euro/orë), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.

- Për datat 05.09.2016 dhe datë 21.09.2016, janë përfshirë në ditë pune punëtorë të pa kualifikuar 46 orë, punëtorë të kualifikuar 12 orë, drejtues punimesh 14 ore dhe teknikë 3 orë, po ashtu edhe

mjet transporti 6 orë, me vlerë 854 Euro. Procesi i punimeve ka të bëjë me riparim defektesh në shtresat asfaltike, sipas fotos më poshtë:



**Vlerë 854 Euro**, është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.

- Punimet nuk shoqërohen me fotografi gjatë realizimit të tyre, për të vërtetuar pjesëmarrjen në proceset e punimeve të mekanizmave, po ashtu në raste të veçanta, fotot e realizuara ditë të tjera, i bashkëngjiten ditës përkatëse, si psh fotot e realizuara me datë 19.06.2015, i bashkëngjiten edhe datës 20.06.2016, etj.

-Sipas zërit 5.H.05 “Metal bridge parapet”, punime të raportuara në Urën e Drashovicës, është certifikuar sasia 131 ml. Nga verifikimi në objekt nuk rezultojnë punime të tilla. Në urë janë ndërtuar vetëm guardrail tip H3, në të dy anët e rrugës dhe nuk është parashikuar dhe rrjedhimisht ndërtuar kalim për këmbësorët, duke vënë në rrezik kalimin e tyre.

**Vlera 3,720 Euro** (62 ml x 60 Euro/ml), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori J. “E.& P.” SHPK dhe përbën dëm ekonomik.

Është në proces shqyrtimi dokumentacioni që ka lidhje me pagesat (ditë pune), pasi ka tejkalime të konsiderueshme nga parashikimi.

Nga ana e Kontraktorit dhe mbikëqyrësit të punimeve nuk është bërë asnjë koment, ndryshim apo analizë kostoje për ndryshimin.



Ky veprim është në kundërshtim me specifikimet teknike, Pika 6.08.3, si dhe Kontratën F., pika 12.2, ku përcaktohet:

*“Përjashtuar rastet kur është përcaktuar ndryshe në kontratë dhe praktikat lokale:*

- *Matjet duhet të bëhen në sasi neto faktike për secilin zë të punimeve të përhershme;*
- *metoda e matjeve duhet të jetë në përputhje me volumet dhe çmimet, referuar specifikimeve teknike, apo ndonjë përcaktimi në anekse”.*

**6. Titulli i gjetjes:** Punime të certifikuar, por të pa realizuara.

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit teknik rezulton se janë realizuar punimet për rialokimin e linjave elektrike dhe tubacione të ujit. Vlera e parashikuar sipas zërit 1.A.10, ishte 40,000 Euro, e cila gjatë zbatimit të kontratës është shtuar duke e certifikuar me vlerë 95,947.9 Euro. Për realizimin e punimeve janë hartuar preventivat përkatës. Në preventiv janë përfshirë edhe furnizim vendosje shtylla betoni të centrifuguara, referencë e të cilëve janë dhe në manualët e çmimeve të ndërtimit. Nga krahasimi i vlerave përkatëse rezulton se **vlera 376,445 lekë ose 2,690 Euro**, është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori J. “E.& P.” SHPK dhe përbën dëm ekonomik.

Nga verifikimi i punimeve sipas zërit 8 “Ditë pune”, u konstatuan mangësi si më poshtë:

- Paraqiten të angazhuara mekanizma dhe punëtori mbi 8 orë pune, në ndonjë rast dhe 16 orë pune. Si rast mund të përmendim periudhën nga data 06.01.2016 deri me datë 11.01.2016, ku është paraqitur marrja e masave mbrojtëse dhe realizimi i devijimit në dëmtimin e rrugës nga kilometër 13+ 880 deri kilometër 13 + 910. Për një distancë 30 ml, janë angazhuar automjete dhe mekanizma si më poshtë:
- Automjet transport punonjësish 31 orë.
- Fuoristradë 5 orë.
- Kamion 10 deri 20 ton - 100 orë.
- Ekskavator 0.65 m<sup>3</sup> – 66 orë.
- Ekskavator 360<sup>0</sup>, kovë 2.5 m<sup>2</sup>, 123 orë.
- Fadromë 3 m<sup>3</sup> – 30 orë.
- Rrul pneumatik 15 ton 70 orë.
- Gjenerator 10 kVA – 66 orë.

- Vinç – 6 orë.

Për realizimin e një devijimi jo të konsiderueshëm, është likuiduar vlera 19,070 Euro.

Në lidhje me proceset e realizuara si më sipër nuk justifikohet përdorimi i një vinçi apo përdorimi i një gjeneratori. Angazhimi njëherësh i tre mjeteve të rënda gërmuese nuk justifikon angazhimin e vetëm dy automjeteve të transportit, po ashtu gjatë realizimit të procesit të gërmimit të tre mjeteve të rënda gërmimi në një seksion 30 ml, nuk mund të përdoret njëkohësisht rul për ngjeshje shtresash. Në dokumentin justifikues (format excel), është paraqitur shënimi se ruli nuk punoi, por ishte prezent gjithë ditën. Në dokumentacionin justifikues nuk është paraqitur asnjë foto e realizuar gjatë zbatimit të punimeve. **Vlera 5,960 Euro** (Rrul 70 orë x 30 Euro/orë, gjenerator 66 orë x 40 Euro/orë, vinç 6 orë x 75 Euro/orë), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.

- Për datat 05.09.2016 dhe datë 21.09.2016, janë përfshirë në ditë pune punëtorë të pa kualifikuar 46 orë, punëtorë të kualifikuar 12 orë, drejtues punimesh 14 ore dhe teknikë 3 orë, po ashtu edhe mjet transporti 6 orë, me vlerë 854 Euro. Procesi i punimeve ka të bëjë me riparim defektesh në shtresat asfaltike, **Vlera 854 Euro**, është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.

-Sipas zërit 5.H.05 “Metal bridge parapet”, punime të raportuara në Urën e Drashovicës, është certifikuar sasia 131 ml. Nga verifikimi në objekt nuk rezultojnë punime të tilla. Në urë janë ndërtuar vetëm guardrail tip H3, në të dy anët e rrugës dhe nuk është parashikuar dhe rrjedhimisht ndërtuar kalim për këmbësorët, duke vënë në rrezik kalimin e tyre.

**Vlera 3,720 Euro** (62 ml x 60 Euro/ml), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori J. “E.& P.” SHPK dhe përbën dëm ekonomik.

**Kriteri:** Kontrata F., pika 12.2 dhe 13.06. VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Pika 2. Specifikimet teknike, Pika 6.08.3.

**Ndikimi:** Është shkaktuar dëm ekonomik me vlerë 13,494 Euro.

**Shkaku:** Raportim i pasaktë e volumit të punimeve të realizuara në fakt.

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **13,494Euro**, nga Kontraktori J. “E.& P.” SHPK, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

- Në shumë zëra punimesh si: Pastrim tombino, problematika nga shpronësimet, dhera të rena nga reshjet etj., janë raportuar punime nga mekanizmat të rëndë gërmimi, ndërkohë që këto punime mund të realizohen nga mekanizma më të lehtë siç janë ekskavatorët 0.65 m<sup>3</sup>, duke rritur në këtë mënyrë koston e punimeve.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kontratën F., pika 13.06, ku përcaktohet:

*“Për punime të vogla të natyrës incidentale, Punëdhënësi mund të instruktojë një ndryshim i cili do të ekzekutohet me bazë ditë pune.*

*Para urdhërimit të mallrave për punimet, kontraktori duhet të paraqesë kuotimet tek punëdhënësi. Kur të bëhet aplikimi për pagesë, kontraktori duhet të paraqesë evidencë, kuponë dhe faturat me vlera.*

*Përveç sa është përcaktuar ndryshe, Kontraktori duhet të paraqesë çdo ditë tek punëdhënësi në dy kopje evidencë me të dhënat:*



- Emrat dhe angazhimin (kohën e punës) të punonjësve të kontraktorit.
- Të dhënat e mjetit, lloji dhe koha e angazhimit të mekanizimit/mjetit të kontraktorit.
- sasia dhe lloji i materialeve të përdorura..”

Nga auditimi rezulton se për gërmimet ishte parashikuar volumi sipas zërit 2.c.02 “Gërmim në material dherash”, në sasinë 434550 m<sup>3</sup>, i cili është certifikuar në sasinë 228067.5 m<sup>3</sup>, me çmim 2.7 Euro/m<sup>3</sup>. Po ashtu, sipas zërit 2.c.03 “Gërmim në material shkëmbor”, ishte parashikuar sasia 6636 m<sup>3</sup> dhe është certifikuar sasia 264964 m<sup>3</sup>, me çmim 6 Euro/m<sup>3</sup>. Ky ndryshim është bërë me argumentimin e ndryshimit të gjendjes së parashikuar me atë të rezultuar faktike. Vlera e punimeve të gërmimit si më sipër është rritur në shumën rreth 900 mijë Euro. Sa më sipër kemi të bëjmë me mangësi gjatë procesit të projektimit të rrugës. Nga ana e kontraktorit dhe mbikëqyrësit të punimeve nuk është përcaktuar fortësia e formacionit të tokës në seksionet përkatëse të gërmimit, për klasifikimin e mundshëm si zë të ri punimi, i cili do të kishte çmim tjetër nga ai i referuar, si dhe nuk është përcaktuar metoda e gërmimit e nevojitur, apo njëtrajtshmëria e formacionit, veprim në kundërshtim me specifikimet teknike Pika 2.03.2.3 “Gërmim në seksion rruge në shkëmb”, ku përcaktohet:

“Shkëmb nënkupton material solid i cili mund të thyhet me përdorim eksplozivi, në seksione të specifikuara, ose me përdorim të pajisjeve apo mekanizmave pneumatike, e cila nuk mund të gërmohet nga një ekskavator 40 tonësh. Pjesët me dimensione mbi 1 m<sup>3</sup>, do të konsiderohen si shkëmb”.

Nga verifikimi i punimeve të realizuara në objekt rezulton se gërmimi i seksioneve të konsideruara shkëmb, ka pësuar thërrmim natyral, duke vënë në dyshim fortësinë e tij. Më poshtë paraqiten foto në disa seksione, realizuar gjatëauditimit.



Janë certifikuar punime sipas zërit 4.f. 05 “Reinforcedconcrete pipe culvert, 500 mm (half pipe), në sasinë 3411 ml, me çmim 22 Euro/ml. Nga verifikimi i punimeve të realizuara nuk rezultojnë punime me specifikime të tilla. Kanalet mbrojtëse nga ujërat janë ndërruar me beton të derdhur në vend, me seksion trapezoidal. Ky veprim është në kundërshtim me specifikimet teknike, Pika 6.08.3, si dhe Kontratën F., pika 7.01.a, ku përcaktohet:

*“Për secilin seksion, kontraktori duhet të realizojë dhe punimet dhe prodhimin e materialeve dhe çdo punim tjetër në mënyrën e përcaktuar në kontratë”.*

Në specifikimet teknike, pika 1.03.2 “Punime të pa autorizuar”, përcaktohet:

*“Ndonjë punim i realizuar në zgjatim të kërkesave të projektit, si germim në thellësi më të madhe, trashësi më e madhe e shtresave, trashësi më e madhe e shtresave të betonit, trashësi më e madhe e shtresave me gurë, apo punime të ngjashme, nuk do të konsiderohet si një bazë për pretendim për kompensim, përshtuar kur është autorizuar nga punëdhënësi, nga direktiva apo urdhër ndryshimi...”.*

**7. Titulli i gjetjes:** Punime të certifikuara, por të pa realizuara.

**Situata:** -Në shumë zëra punimesh si: Pastrim tombino, problematika nga shpronësimet, dhera të rëna nga reshjet etj., janë raportuar punime nga mekanizmat të rëndë germimi, ndërkohë që këto punime mund të realizohen nga mekanizama më të lehtë siç janë ekskavatorët 0.65 m<sup>3</sup>, duke rritur në këtë mënyrë koston e punimeve.

-Nga auditimi rezulton se për germimet ishte parashikuar volumi sipas zërit 2.c.02 “Gërmim në material dherash”, në sasinë 434550 m<sup>3</sup>, i cili është certifikuar në sasinë 228067.5 m<sup>3</sup>, me çmim 2.7 Euro/m<sup>3</sup>. Po ashtu, sipas zërit 2.c.03 “Gërmim në material shkëmbor”, ishte parashikuar sasia 6636 m<sup>3</sup> dhe është certifikuar sasia 264964 m<sup>3</sup>, me çmim 6 Euro/m<sup>3</sup>. Ky ndryshim është bërë me argumentimin e ndryshimit të gjendjes së parashikuar me atë të rezultuar faktike. Vlera e punimeve të germimit si më sipër është rritur në shumën rreth 900 mijë Euro. Sa më sipër kemi të bëjmë me mangësi gjatë procesit të projektimit të rrugës. Nga ana e kontraktorit dhe mbikëqyrësit të punimeve nuk është përcaktuar fortësia e formacionit të tokës në seksionet përkatëse të germimit, për klasifikimin e mundshëm si zë të ri punimi, i cili do të kishte çmim tjetër nga ai i referuar, si dhe nuk është përcaktuar metoda e germimit e nevojitur, apo njëtrajtshmëria e formacionit

**Kriteri:** - Kontrata F., pika 13.06. - Specifikimet teknike, pika 1.03.2

**Ndikimi:** Rritje e shpenzimeve mbi parashikimin.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kushteve teknike të projektimit

**Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** -Njësia e Zbatimit të Projektit, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të marrin masa për analizimin dhe përcaktimin e fortësisë së formacionit të gërmuar, për përcaktimin e saktë të kategorisë dhe çmimit përkatës për këtë zë punimi.

-Të merren masa për analizimin e çmimit të kanalizimeve të realizuara me beton monolit në raport me kanalizimin e parashikuar me tombino beton arme 500 mm (gjyeshëm tombino), duke bërë zbritjen e çmimit përkatës.

-Për auditimin e zbatimit të kontratës së koncensionit, grupi i auditimit i është referuar vendimit nr. 547, datë 09.08.2006, i azhornuar “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore” në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr. 9000, datë 30.01.2003 “Për

organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave VENDOSI:

1. Krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), si institucion në varësi të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me seli në Tiranë.

2. Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore ka objekt të veprimtarisë zhvillimin, mbikëqyrjen e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, në bazë të politikave qeverisëse, dhe monitorimin e postshfrytëzimit të tyre, në sektorin minerar, hidrokarbur dhe energjetik.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga AKBN por dhe nga inspektimet e kryera në terren, ka rezultuar si në vijim.

Kontrata e koncesionit, nënshkruar midis METE (MIE) dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “E. A.” SH.A & “S. A.” SH.A & “D. H.” SH.A për ndërtimin e hidrocentraleve në Kaskadën e Lumit Devoll, Ligji Nr.10 083, datë 23.02.2009. Botuar në Fletoren Zyrtare F.Z.28, Dt.17.03.2009. Ndryshuar me Ligjin Nr.10 337, Dt.21.10.2010, F.Z.154, Dt.24.11.2010. Ndryshuar me Ligjin Nr.105/2013, Dt.28.03.2013, F.Z.53, Dt.15.04.2013. Ndryshuar me Ligjin Nr.7/2015, Dt.12.02.2015, F.Z.28, Dt.17.03.2015. Hyrja në fuqi e kontratës është data 01.04.2009.

Krijimi i Njësisë së Zbatimit të Projektit (NJZP) (brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e kontratës koncesionare), në datë 01.05.2009. Fillimi i punimeve është dita që koncesionari njofton me shkrim AK. Afati i vënies në punë, brenda 72 muajve nga data e fillimit të punimeve. Vlera e Investimit sipas kontratës: Varianti I – 525,900,000 Euro, Varianti II – 590,600,000 Euro. Vlera e makineri pajisje: Varianti I - 192,400,000 Euro, Varianti II - 169,000,000 Euro. Fuqia – 278,200 kw (sipas ligjit 105/2013, Dt. 28.03.2013). Energjia – 789,000,000 kwh (sipas ligjit 105/2013, Dt.28.03.2013). Në total nga AKBN janë mbajtur tre raporte monitorimi.

Raporti i fundit i monitorimit të HECEVE, është mbajtur në 3-Mujorin e III dhe të IV të vitit 2020 dhe është dërguar në MIE me shkresën me nr. 4598/1 Prot., datë 22.08.2020.

Nga ky raport monitorimi, AKBN në mënyrë të përmbledhur ka cilësuar se:

*Lidhur me kontratën për ndërtimin e Hec- Banjës dhe Hec- Moglicës dhe Hec-Kokelit, nga AKBN disponohet ky dokumentacion:*

- a. Themelimi i shoqërisë “D. H.” SHA me aksionarët, “E. A.” dhe “S. A.”.
- b. Ekstrakti i regjistrimit të shoqërisë.
- c. Mbështetur në nenin 3 pika 3.1.1 brenda një muaji nga data e hyrjes në fuqi e kontratës, palët do të krijojnë Njësinë e Zbatimit të Projektit (NJZP). Referuar shkresës Prot .No. 00001, datë 21.01.2010. *Shoqëria Koncesionare e ka krijuar 7 muaj më vonë NJZP nga sa parashikohet në kontratë.*
- d. Për plotësimin e detyrimit të përcaktuar në nenin 3.1, të kontratës së koncesionit janë zëvendësuar disa anëtarë të njësisë së zbatimit të projektit të ndërtimit të hidrocentralit D, respektivisht me shkresën nr. 3745 prot datë 19.04.2010, shkresën nr. 213, datë 31.01.2011, me shkresën nr. 3199, datë 18.04.2011.
- e. *Referuar nenit 3.4.2 të kontratës së koncesionit miratohet programi i paraqitur nga shoqëria (i njohur në Kontratën e Koncesionit si leje për Zhvillimin e punimeve) vënë në dispozicion me shkresën nr. 138/1, datë 08.02.2016 të drejtorisë Hidroenergjetike.*

1. Përshkrim mbi objektin e kontratës koncesionare

Kontrata e koncesionit, nënshkruar midis METE (MIE) dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “E. A.” SHA & “S. A.” SHA & “D. H.” SHA për ndërtimin e hidrocentraleve në Kaskadën e Lumit Devoll, miratuar me ligjin nr.10 083, datë 23.02.2009, botuar në Fletoren Zyrtare nr.28, datë 17.03.2009, plotësuar nga shtesa e 1-rë e kontratës së Koncesionit datë 3 gusht 2010, e cila është

miratuar me ligjin nr. 10337, datë 21 tetor 2010, dhe publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 154, datë 24 nëntor 2010, plotësuar nga shtesa e 2-të e Kontratës së Koncesionit datë 19 mars 2013, e cila është miratuar me ligjin nr. 105/2013, datë 28 mars 2013 dhe publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 53, datë 15 prill 2013, plotësuar nga shtesa e 3-të e Kontratës së Koncesionit datë 12 shkurt 2015, e cila është miratuar me ligjin nr. 7/2015, datë 12 shkurt 2015 dhe publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 28, datë 17.03.2015.

-Analiza Ligjore Faktike.

Lidhur me kontratën për ndërtimin e Hec- Banjës dhe Hec- Moglicës dhe Hec-Kokelit, nga AKBN disponohet ky dokumentacion:

a. Ka themeluar shoqërinë “D.H.” SHA me aksionerët, “E.A.” dhe “S. A.”.

b. Ekstrakti i regjistrimit të shoqërisë.

c. Mbështetur në nenin 3 pika 3.1.1 brenda një muaji nga data e hyrjes në fuqi e kontratës, palët do të krijojnë Njësinë e Zbatimit të Projektit (NJZP). Referuar shkresës Prot.No. 00001, datë 21.01.2010. Shoqëria Koncesionare e ka krijuar 7 muaj më vonë NJZP nga sa parashikohet në kontratë.

d. Për plotësimin e detyrimit të përcaktuar në nenin 3.1, të kontratës së koncesionit janë zëvendësuar disa anëtarë të njësisë së zbatimit të projektit të ndërtimit të hidrocentralit Devoll, respektivisht me shkresën nr. 3745 Prot., datë 19.04.2010, shkresën nr. 213 Prot., datë 31.01.2011, me shkresën nr. 3199 Prot., datë 18.04.2011.

e. Referuar nenit 3.4.2 të kontratës së koncesionit miratohet programi i paraqitur nga shoqëria (i njohur në Kontratën e Koncesionit si leje për Zhvillimin e punimeve) vënë në dispozicion me shkresën nr. 138/1 Prot., datë 08.02.2016 të Drejtorisë Hidroenergjitike.

f. Me shkresën nr. 138/1 Prot., datë 08.02.2016 të Drejtorisë Hidroenergjitike, na është vënë në dispozicion vendimi nr. 2, datë 06.06.2012, si dhe kërkesa për miratimin e projektit të zbatimit, nga Drejtoria e Përgjithshme e PMNZSH-së është dhënë Leje për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin me nr. 4393/2, datë 06.07.2012. Vendimi nr. 1, datë 28.03.2012 nga Këshilli Kombëtar i Ujit, për tre hecet. Vendimi nr. 189, datë 17.04.2012 nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë.

Detyrimet e fazës para ndërtimit nën përgjegjësinë e Koncesionarit.

Mbështetur në nenin 3.3 pika 3.3.1 brenda 12 muajsh nga hyrja e fuqi e kontratës Koncesionari do të kujdesej që të dërgojë tek Autoriteti Kontraktor një konfirmim me shkrim për “Njoftim të Mbylljes Financiare”. Me shkresën datë 12 Janar 2011, Koncesionari ka dërguar tek Autoriteti Kontraktor “Njoftim të Mbylljes Financiare”, i cili është 8 muaj më vonë nga sa parashikohen në kontratë. Mbështetur në nenin 3.3 pika 3.3.2, Koncesionari jo më vonë se 5 muaj nga hyrja në fuqi e kontratës do të fillojë procedurën për tu pajisur me pronësinë mbi parcelat e kërkuara të sheshit. Referuar shkresës datë 23.03.2011, Book. No Tr-2011-00103 drejtuar METE-s, koncesionari e ka depozituar kërkesën tek Autoriteti Kontraktor 18 muaj më vonë nga sa parashikohet në kontratë. Bazuar në pikën 3.3.5 të nenit 3.3, brenda 24 muajve, pasi të ketë marrë Lejet për Zhvillimin e Punimeve, leja është marrë me datë 03.02.2011 me nr. 11354/3 Prot., koncesionari do të paraqesë AK Projektin e Detajuar. Në dosje disponojmë shkresën nr. 702/4 prot, datë 15.04.2011 "Mbi Projekt Idene e Rishikuar të Projektit Hidroenergjetik në lumin Devoll", Vendimin nr. 2, datë 06.06.2012, si dhe kërkesë për Miratimin e Projekt Zbatimit (nuk disponojmë miratimin e projektit). Gjithashtu mbështetur në nenin 3.3, pika 3.3.6, koncesionari jo më vonë se një muaj para finalizimit të punimeve përgatitore të ndërtimit (brenda 18 muajve pasi të jetë pajisur me të gjitha autorizimet e kërkuara për qëllimet e fazës së ndërtimit, e përcaktuar në nenin 3.3.7), duhet të vërë në dispozicion AK policat e sigurimit dhe garancite mbuluese në përputhje me nenin 9. Theksojmë se nëse koncesionari nuk do të pajiset, mbajë ose ripërtërijë garancitë e sigurimit të

parashikuara në nenin 9.1, AK mund ti kryejë vetë ato garanci sigurimi me shpenzimet e koncesionarit.

#### Fillimi fazës së ndërtimit.

Bazuar në nenin 3.6 të ndryshuar, Fillimi i fazës së ndërtimit do të konsiderohet se ndodh në datën në të cilën secili prej angazhimeve të dhëna në nenin 3.3 dhe 3.4 do të jenë përmbushur për sa i përket Hidrocentralit të Banjës dhe Moglicës. Nuk disponojmë procesverbal mbi fillimin e punimeve.

#### Ndërtimi i Hidrocentraleve.

Në bazë të pikës 7.2.3 të nenit 7.2, të ndryshuar, Koncesionari do ndërtojë; Hidrocentralin e Banjës, jo më vonë se 54 muaj nga data e fillimit të punimeve të ndërtimit, datë e cila do të përbëjë një datë grafiku. Me shkresën e saj 4723/1 Prot., dt 03.08.2016 (hyrë në AKBN me nr 7119 Prot., dt 04.08.2016) MIE dërgon Informacion për datat e kryerjes së testeve të funksionalitetit të Hec-it Banje. Me shkresës nr. 4723/8 datë 26.09.2016 "Mbi kryerjen e testeve të funksionimit të Hec-it Banje" grupi i punës i përbërë nga përfaqësues të MIE dhe AKBN informon mbi kryerjen e testimit të Hecit. Hidrocentrali i Moglicës do të fillojë ndërtimin në kohën e nevojshme për të finalizuar ndërtimin e hidrocentralit të Moglicës në përputhje me nenin 7.2.3. në mënyrë që të arrihet përfundimi paraprak jo më vonë se data e planifikuar e përfundimit të punimeve të ndërtimit, datë e cila do të përbëjë një datë grafiku. Datë e përfundimit të punimeve të ndërtimit sipas grafikut nënkupton datën që bie 90 muaj pas datës së fillimit të punimeve të ndërtimit. MIE me shkresën e saj 735/1 Prot., dt 13.02.2020 (hyrë në AKBN me nr 1106/1 Prot., dt 14.02.2020) "Mbi testet e funksionimit të hidrocentralit Moglicë" informon se Shoqëria "D. H." sha, me shkresën e datës 06.01.2020, protokolluar në MIE me nr 59 Prot., datë 06.01.2020 dhe me shkresën e datës 08.01.2020, ka njoftuar për fillimin e testeve të funksionimit të hec-it Moglicë dhe dërgim i programit të hollësishëm të testeve. Hidrocentrali i Kokelit, brenda 10 vjetësh nga përfundimi i hidrocentralit të Moglicës nëse koncesionari vendos.

#### Detyrimet pas përfundimit

Jo më vonë se një muaj pas datës faktike të përfundimit të punimeve Koncesionari do ti dërgojë AK sa më poshtë:

Dy kopje të të gjitha të dhënave teknike, duke përfshirë raportin e projektit dokumentet e përlllogaritjeve dhe të projektimit, që lidhen me projektimin dhe ndërtimin e hidrocentraleve. Dy kopje të skicimeve ashtu sic janë ndërtuar të hidrocentraleve nga koncesionari së bashku me dokumentet e evidencave të cdo Testi Funksionimi të Hidrocentraleve nga Koncesionari.

Dy kopje të të gjitha dokumenteve ose materialeve të tjera teknike që lidhen me hidrocentralet.

Koncesionari nuk ka plotësuar detyrimet e më poshtme:

Bazuar në nenin 3.6 të ligjit, koncesionari duhet të njoftojë me shkrim A K, për datën e fillimit të punimeve të ndërtimit. Në bazë të nenit 3.6 të ligjit, Koncesionari nuk e ka njoftuar AK mbi fillimin e punimeve të ndërtimit.

#### Lidhur me disponimin e Lejeve:

Nuk disponojmë lejen e ndërtimit. Disponojmë hartën e lejes infrastrukurore të miratuar bazuar në vendimin e KKT-së nr. 1, dt 20.12.2012, por jo formatin e lejes së zbardhur. Me shkresën nr. 3365/1 Prot., dt. 29.05.2020, MIE ka dërguar pranë AKBN-së Vendimin Nr. 17, dt. 28.02.2020, të KKT: Për Miratimin e Shtyrjes së afatit të Lejes së Ndërtimit për Objektivin Ndërtimi i Hec-it Moglicë dhe Banjë në Qarkun Korçë dhe Qarkun Elbasan. Lejen e zbardhur nuk e disponojmë.

#### Rekomandime konkluzione.

Bazuar në pikën 7.2.4, të nenit 7 të ligjit, Koncesionari nëse nuk arrin afatin e synuar me përjashtim të rasteve për të cilat zbatohen nenet 10.2 ose 10.3 dhe 7.3, do ti paguaj AK dëmet e likuidueshme

në përputhje me nenin 7.3.11, për çdo ditë vonesë përtej datës së parashikuar të përfundimit paraprak të punimeve ndërtimore dhe konkretisht:

Pika i) - vonesa në përfundimin paraprak. Përfundimi paraprak për sa i përket Hec-it të Banjës dhe Hec-it të Moglicës, nuk ndodh para ose në datën e përfundimit të punimeve sipas grafikut për shkak të neglizhencës së tij, dëmet e likujdueshme lidhur me këtë hidrocentral do ti paguhen AK në vlerën përkatëse të dëmeve të likujdueshme:

-Vlera e dëmeve të likujdueshme, do të thotë për të gjitha Hidrocentralet së bashku vlera totale prej: 20,000 euro për ditë vonesë nga dita e parë në ditën e 60 të periudhës së vonesës; 30,000 euro për ditë vonesë nga dita e 61 në ditën e 120 të periudhës së vonesës; 40,000 euro për ditë vonesë nga dita e 121 në ditën e 180 të periudhës së vonesës; 50,000 euro për ditë vonesë pas ose në ditën e 181; Ku vlera e dëmeve të likujdueshme për secilën nga tre hidrocentralet do të thotë një e treta e vlerave të sipërpërmendura.

Pika ii) -vonesa në veprimet rregulluese. Nëse koncesionari nuk ndërmerr të gjitha veprimet rregulluese për të ndrequr shkaqet thelbësore të mospërputhshmërisë të vënë re në njoftimin për mospërmbushje siç parashikohet në nenin 7.3.9 (b), dëmet e likujdueshme do ti paguhen AK nga koncesionari pas kalimit të periudhës së ndreqjes prej gjashtëdhjetë ditë punë në vlerën përkatëse të veprimit rregullues të dëmeve të likujdueshme. Vlera e veprimit ndreqës të dëmeve të likujdueshme, është për të gjitha hidrocentralet së bashku vlera e përgjithshme 5,000 euro për ditë vonesë pas kalimit të periudhës së ndreqjes prej 60 ditë pune nga dita e parë në ditën e 100, ku vlera e veprimit për ndreqjen e dëmeve të likujdueshme është një e treta e vlerës së sipër përmendur. Hidrocentrali i Banjës do të ndërtohet jo më vonë se 54 muaj nga data e fillimit të punimeve të ndërtimit, datë e cila do të përbëj një datë grafiku. Me shkresën e saj 4723/1 prot dt 03.08.2016 (hyrë në AKBN me nr 7119 prot dt 04.08.2016) MIE dërgon Informacion për datat e kryerjes së testeve të funksionalitetit të hec-it Banjë. Me shkresës nr. 4723/8 datë 26.09.2016 "Mbi kryerjen e testeve të funksionimit të Hec-it Banjë" grupi i punës i përbërë nga përfaqësues të MIE dhe AKBN informon mbi kryerjen e testimit të hec-it. Për sa i përket fillimit të punimeve; Në dosjen koncesionare nuk disponohet procesvervali i fillimit të punimeve ose dokumentacion që të vërtetoi periudhën në të cilën koncesionari ka nisur punimet për ndërtimin e hec-it Banjë. Hidrocentrali i Moglicës do të fillojë ndërtimin në kohën e nevojshme për të finalizuar ndërtimin e hidrocentralit të Moglicës në përputhje me nenin 7.2.3. në mënyrë që të arrihet përfundimi paraprak jo më vonë se data e planifikuar e përfundimit të punimeve të ndërtimit, datë e cila do të përbëjë një datë grafiku. Datë e përfundimit të punimeve

të ndërtimit sipas grafikut nënkupton datën që bie 90 muaj pas datës së fillimit të punimeve të ndërtimit. MIE me shkresën nr. 735/1 prot dt 13.02.2020 (hyrë në AKBN me nr 1106/1 prot dt 14.02.2020) "Mbi testet e funksionimit të hidrocentralit Moglicë" bën me dije se Shoqeria "D. H." sha, me shkresën e datës 06.01.2020, protokolluar në MIE me nr 59 prot datë 06.01.2020 dhe me shkresën e datës 08.01.2020, ka njoftuar për fillimin e testeve të funksionimit të hec-it Moglicë dhe dërgim i programit të hollësishëm të testeve. Për sa i përket fillimit të punimeve; Në dosjen koncesionare nuk disponohet procesverbali i fillimit të punimeve ose dokumentacion që të vërtetoi periudhën në të cilën koncesionari ka nisur punimet për ndërtimin e hec-it Moglicë. Bazuar në raportin e monitorimit për tremujorin e IV, të vitit 2013 protokolluar në AKBN me nr. 1594 datë 12.2.2014 dërguar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, rezulton se nga kontrolli i kryer në objekt në datën 05.12.2013 është konstatuar se, në objekt nuk kishin filluar punimet për ndërtimin e hece-ve. Po ti referohemi raportit të monitorimit për vitin 2013, rezulton se koncesionari është brenda afatit dhe në përmbushje të pikës 7.2.3 të nenit 7.2, të Kontratës së Koncesionit të ndryshuar.

### 3. Raporti Teknik

Parametrat e hidrocentralit

A) Kërkesat Teknike Minimale

a) Projekt-Ideja dhe Projekti i Detajuar.

Projekt-Ideja do të shërbejë si bazë për Projektin e Detajuar i cili do të paraqitet nga Koncesionari në kërkesën e tij për Lejen e Ndërtimit. Projekti i Detajuar mund të devijojë nga Projekt-Ideja si pasojë e shqyrtimeve të hollësishme gjeologjike, hidrologjike, mjedisore dhe teknike që do të kryhen nga Koncesionari pas datës së hyrjes në fuqi, me kusht që, megjithatë këto devijime nuk do të çojnë në një ndryshim në total prej plus/minus 20% të Kapacitetit të Instaluar siç është parashikuar në këtë Kontratë, gjithnjë nëse përdorimi i potencialit të lumit kryhet nga të paktën tre hidrocentrale.

b) Strukturimi i centraleve.

c) 7.2.7.1 Koncesionari do të jetë përgjegjës për punimet e Infrastrukturës Zëvendësuese projektimin, përfshirë financimin, tenderimin, ndërtimin, planifikimin, dhe dorëzimin e Infrastrukturës Zëvendësuese me kusht që Autoriteti Kontraktues të kompensojë plotësisht Koston e Infrastrukturës Zëvendësuese.

Në veçanti, Koncesionari: a) Do të sigurojë mjetet financiare të nevojshme për planifikimin, projektimin e Infrastrukturës dhe ndërtimin, që përcaktohet në nenin 7.2.7.3. Vlerësimi fillestar kostove përkatëse përpara marrjes së ofertave të tenderit, bazuar në projekt-identë ishte në shumën 49,646,269 euro. Kjo shumë do të përditësohet pas të propozimit të projektit shtetëror (ARRSH).

#### Fillimi i punimeve

Në dosjen e AKBN nuk ndodhet Proces-verbali apo njoftimi për fillimin e punimeve për hecin e Banjes.

#### Zbatimi i Projektit

Heci Banjës ka vite që është në fazën e shfrytëzimit. Heci Moglicës sapo ka kaluar në fazën e shfrytëzimit.

#### Përfundimi i punimeve dhe testimi

MIE me shkresën e saj 4723/1 prot dt 03.08.2016 (hyre në Akbn me nr 7119 prot dt 04.08.2016) "Informacion për datat e testeve të funksionalitetit të Hecit Banje" na bën me dije se Shoqëria "D. H." sha, me shkresën e datës nr. 2016-TR-01488 dt 15.07.2016" Informacion lidhur me datat e planifikuara të testeve që do të mbikëqyren nga Autoriteti Kontraktues Njoftim i Përfundimit Paraprak dhe fillimi i Testeve të Funksionalitetit të hecit Banje", ku referohet shkresën e datës nr. 2016-TR-01373 dt 04.07.2016 "Njoftim i Përfundimit

Paraprak, MIE me shkresën e saj 735/1 prot dt 13.02.2020 (hyre në Akbn me nr 1106/1 prot dt 14.02.2020) "Mbi testet e funksionimit të hidrocentralit Moglice" na bën me dije se Shoqëria "D. H." sha, me shkresën e datës 06.01.2020 "Njoftim i Përfundimit Paraprak dhe fillimi i Testeve të Funksionalitetit, protokolluar në MIE me Nr 59 prot date 06.01.2020. Me shkresën e datës 08.01.2020 "Njoftim për fillimin e testeve të funksionimit të hec Moglice dhe dërgim i programit të hollësishëm të testeve protokolluar në MIE me Nr 180 prot date 08.01.2020. MIE me shkresën e saj 59/2 prot dt 25.08.2020 (hyre në Akbn me nr 1106/5 prot dt 26.08.2020) "Dërgohet për mendim Raporti përfundimtar për hecin Moglice" na ve në dijeni për shkresën Nr 2020-TR-00354 date 15.07.2020 "Dërgim Raportit përfundimtar për hec Moglice dhe kërkesë për lëshimin e Certifikatës së Përfundimit final". Sipas Raportit përfundimtar: fuqia totale e konfirmuar e hecit Moglicë është 197.4 MW, dhe konfirmohet fuqia e instaluar të hecit Banje është 72 MW. Pra në total fuqia e instaluar e projektit me dy hece është 269.4 MW. MIE me shkresën e saj 6064/1 prot

dt 04.09.2020 (hyre ne Akbn me nr 1106/6 prot dt 09.09.2020) "Dërgohet Raporti i Mbikëqyrësit dhe Aktin e kolaudimit te hecit Moglices" ka përcjellë shkresën e koncesionarit 2020-TR-00414 date 18.08.2020. Raporti testimi per HEC Moglice derguar me Nr. 1106/3 prot, dt. 24.07.2020. Monitorimi i fundit i kryer me dt. 04.12.2020, HEC-i ka kaluar ne fazen e prodhimit.

#### Analiza Financiare

Në zbatim të marrëveshjes së koncensionit, të nënshkruar me shoqërinë "D.H.", shpk, për ndërtimin e hec-ve në "Kaskadën e Devollit", në bazë të nenit 4.3 Raporti Financiar dhe Revizionimi, i Marrëveshjes së Koncensionit, miratuar me Ligjin 10083, date 23.02.2009, i ndryshuar, pika 4.3.1, jo më pak se një herë në vit gjatë Afatit, në të njëjtën datë me Daten e Fillimit të Punimeve të Ndërtimit, Koncesionari do t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues Raportin e tij Financiar të revizionuar.

-Nga verifikimet e kryera në terren, në digën e Moglicës, u konstatua se shtresa e asfaltit mbi digë ose sipërfaqja e rrugës ka pësuar një rënie e cila është e dukshme me sy të lirë dhe lë vend për dyshime të arsyeshme të dëmtimit të kurorës së digës por që thellësia e këtij dëmtimi nuk mund të verifikohet nga grupi i auditimit për vet faktin se kërkon një analizë dhe teste teknike nga specialistë të fushës për të verifikuar nëse dëmtimi i shtresës së asfaltit mbi digë është dëmtim sipërfaqësor apo është më serioz se kaq me qëllim parandalimin e përkeqësimit të situatës.

Në zbatim të pikës 2 të Programit të Auditimit nr. 446/1 Prot., datë 27.05.2022, u shqyrtua loti M03 që përfshin ndërtimin e një segmenti rrugor në bregun verior të rezervuarit të HEC Moglicë.

-Kontrata midis D. H. SHA dhe "A." SHPK, është nënshkruar në datën 07.07.2016. Kontrata për këtë segment (M03) është me vlerë 6,328,080.85 Euro pa TVSH. Data e fillimit të punimeve sipas kontratës është data 30.09.2016. Data e përfundimit të punimeve sipas kontratës është data 19.12.2018. Data e përfundimit të punimeve sipas njoftimit të mbikëqyrësit është data 15.11.2018. Periudha e realizimit të punimeve, është 25.5 muaj. Vlera e objektit të përfunduar është 9,086,624.96 Euro pa TVSH.

Segmenti rrugor MO3, shërben si rrugë zëvendësuese e rrugës së vjetër nacionale pjesë e segmentit Gramsh-Lozhan-Maliq, e cila në pjesën më të madhe të gjurmës është përmytur duke u bërë e papërdorshme (sipas përcaktimit të dhënë në nenin 7.2.6 të Marrëveshjes së Koncensionit, e ndryshuar). Segmenti i ri rrugor ka gjatësinë 14.36 km nga te cilat 13 km është gjurme e re dhe 1.36 km gjurme ekzistuese. Data e përgatitjes së Projektit, Viti 2016. Miratimi i Projekt-idesë/Projektit paraprak të rrugës M03, është bërë më Vendimin e KT nr. 80, datë 17.12.2015. Miratimi i Projektit të detajuar/Projekt-zbatimit të rrugës M03, është bërë me Vendimin e KT nr. 11, datë 07.03.2016.

#### **Ndryshime në projekt gjatë zbatimit:**

Ka ndryshime të projektit të zbatimit (rishikime) të miratuara në Këshillat Teknik të ARRSH-së. Këto miratime kanë ndryshuar vlerën e preventivit bazë të kontratës. Ndryshimi nr.1 është bërë më Vendimin e KT nr.26 datë 04.05.2017. Ndryshimet kanë konsistuar në ndryshimin e gjurmës për shmangien e varrezave të zonës Popçisht, ndërtimi i një muri mbajtës për të shmangur ndërlihdjen e rrugës me varrezat ekzistuese, shmangia e serpentinave në disa seksione. Ndryshimi 2, është bërë me Vendimin e KT nr.45, datë 31.08.2017. Ndryshimet kanë konsistuar në ndryshimin e gjurmës së rrugës në pikë fillestare të M03 lidhja me M15. Domosdoshmëria e ndërhyrjes në rrëshqitjen e vjetër në km 12 + 600; zëvendësimi i murit gabion ekzistues në km 13 + 960 deri në km 13 + 996.-Ndryshimi 3, është bërë me Vendimin e KT nr.51, datë 18.10.2017. Ndryshimet kanë konsistuar në masat që janë marrë për qëndrueshmërinë e shpateve dhe



skarpatave në gjurmim në seksionet nga km 6+836 në km 7+105, nga km 7+105 në km 7+200, nga km 7+200 në km 7+300, nga km 7+405 në km 7+430, nga km 7+605 në km 7+680, nga km 7+805 në km 7+830 dhe sistemimi i nivelit të ujrave nga km 7+330 në 7+380. Ndryshimi 4, është bërë me Vendimin e KT nr.22, datë 18.05.2018. Ndryshimet kanë konsistuar në domosdoshmërinë e disa masave teknike shtesë për të bërë të mundur qëndrueshmërinë e skarpatave dhe të trupit të rrugës nga km 6+836 deri në km 6+900, në km 7+750 dhe në km 12+500. Vlera fillestare e objektit: 6,328,080.85 Euro (pa tvsh). Vlera e rishikuar pas ndryshimeve të miratuara dhe sipas situacionit përfundimtar, është 9,086,624.96 Euro (pa tvsh).

Nga verifikimi në terren, është konstatuar se:

Në kilometrin e 7-të deri 7.6, rruga ka rrëshqitje dhe çarje të asfaltit në pjesën e djathtë të saj.

Në vazhdim në kilometrin e 8-të deri 8.5, rruga ka rrëshqitje dhe dëmtim të bordurave mbajtëse në krahun e djathtë të saj. Në kilometrin e 10-të deri 14, rruga ka dëmtime të vazhdueshme dhe rrëshqitje të terrenit. Gjithashtu në këtë pjesë të aksit, janë dëmtuar reflektorët anësorë.

Defektet e mësipërme, përbëjnë rrezik aksidentesh për përdoruesit e rrugës, gjithashtu rritje të kostos për ndërhyrje, nëse nuk merren masa të shpejta për ndërhyrjen për riparim të tyre. Dëmtimet e sinjalistikës vertikale (reflektorë) nga individë të pa identifikuar krijojnë vështirësi në qarkullimin e automjeteve, kryesisht gjatë natës.

Punimet sipas kësaj kontrate janë marrë në dorëzim përfundimtar, bazuar në procesverbalin e mbajtur me datë 14.04.2022, nga komisioni i përbërë nga z. A. Z. dhe z. N. H.

### **2.3. Mbi shkallën e realizimit të objektivave dhe të komponentëve të projektit, administruar nga Institucionet Publike respektive.**

a. Realizimi i objektivit të përgjithshëm dhe objektivave specifike të projektit, skenarët teknikë dhe ekonomikë në arritjen e objektivave.

b. Skemat e implementimit të objektivit të përgjithshëm

c. Ndikimi mjedisor dhe social nga zbatimi dhe vendosja në punë e projektit me objekt “Ndërtimi i Hidrocentralit/Hidrocentraleve në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë”. Përputhja e treguesve mjedisorë dhe socialë me standardet e BE-së për mjedisin.

Nga auditimi mbi realizimin e objektivit të përgjithshëm dhe objektivave specifike të projektit, skenarët teknikë dhe ekonomike në arritjen e objektivave, si dhe ndikimin mjedisor e social nga zbatimi dhe vendosja në punë e projektit dhe përputhja e treguesve mjedisorë e socialë me standardet e BE-aë për mjedisin, rezultoi si më poshtë:

Kontrata e Koncesionit, nënshkruar midis METE (sot MIE) dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “E. A.” sh.a & “S. A.” sh.a & “D. H.” sh.a, për ndërtimin e hidrocentraleve në Kaskadën e Lumit Devoll, Ligji Nr.10 083, datë 23.02.2009, ndryshuar me Ligjin Nr.10 337, Dt.21.10.2010, ndryshuar me Ligjin Nr.105/2013, datë 28.03.2013, ndryshuar me Ligjin Nr.7/2015, Dt.12.02.2015. Hyrja në fuqi e kontratës është data 01.04.2009.

Zhvillimi i hidrocentraleve ka ndikime të rëndësishme në shoqëri dhe komunitet ekonomik, mjedisor dhe social. Këto ndikime mund të shkojnë përtej nivelit rajonal, madje edhe në të gjithë vendin. Megjithatë, zhvendosja, zhvillimi i koordinuar dhe ndikimet ekologjike në ekosistemin loka, paraqesin sfida të rëndësishme, për të cilat është e rëndësishme marrja e masave dhe monitorimi në uljen e ndikimit negative të tyre, pasi shumë projekte kërcënojnë ekologjikisht

lumenjtë. E rëndësishme të ndiqet një qasje proaktive, që ka potencialin për të dhënë rezultate të kënaqshme sigurie me kosto të moderuara për ndjekjen e një projekti hidrocentrali.

Shqipëria ka një potencial të madh hidroenergjetik nga i cili deri në vitin 2007, vetëm 35% është shfrytëzuar (sipas Strategjisë Kombëtare Energjetike të kësaj periudhe). Kapaciteti hidroenergjetik i instaluar deri në vitin 2002 ka qene 1446 MW. Prodhimi mesatar nga hidroenergja ka qene 4162 GWh. Leverdishmëria e shfrytëzimit të burimeve hidroenergjetike ende kushtëzohet nga kushtet gjeologjike, topografike për ndërtimin e digave dhe sidomos nga kushtet topografike për të pakësuar sa të jete e mundur përmbytjen e tokave. Gjithashtu ndërtimi i tyre varet edhe nga investimet fillestare të mëdha. Rezervat totale të hidroenergjisë deri në vitin 2003, vlerësoheshin rreth 3000 MW dhe potenciali vjetor i prodhimit mund të arrinte 10 TWh. Sipas gjendjes së sistemit energjetik të viteve 2002-2009, ishin preferuar impiantet e rinj të prodhimit në pjesën jugore të vendit (Vjosë dhe Devoll) sepse kjo do të bënte të mundur balancimin gjeografik të prodhimit me kërkesën. Mbështetur në punimet e Institutit të Studimeve dhe Projekttimeve të Veprave Hidroteknike u bë i mundur projektimi i skemës së plotë të shfrytëzimit të Drinit, Devollit dhe Vjosës.

Në objektivat e sistemit energjetik të periudhës 200-2007, HEC-e të reja më të mundshëm për t'u ndërtuar ishin: në lumin Drin-Bushati (84 MË), Peshkopi (Skavica 1) (130 MW), Skavica 2 (350 MW); në lumin Vjose-Kaludhe (75 MË), Dragot-Tepelena (130 MW) dhe Kalivaçi (100 MW); në lumin Devoll-Bratila (115 MW) dhe Banja (80 MW).

Strategjia e zhvillimit të sektorit energjetik përfshijnë të gjitha ndryshimet e nevojshme që duhet të ndodhin për të rritur sigurinë e furnizimit me burime energjetike dhe optimizimin e burimeve për mbulimin e nevojave me synim kryesor zhvillimin e qëndrueshëm të mbare ekonomisë për të ardhmen. **Në strategjinë e vitit 2007, për periudhën 2006-2020, është vënë theksi të ristrukturimi i sistemit energjetik që kërkon marrjen e masave të rëndësishme, duke pasur parasysh se ndryshimet në sektorin energjetik nuk ndodhin spontanisht. Kjo strategji ka synuar të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm të mbare ekonomisë kombëtare dhe të realizonte njëkohësisht edhe mbrojtjen e mjedisit gjatë të gjithë ciklit të shfrytëzimit të burimeve energjetike.**

Strategjia e Energjisë dhe objektivat e vendosur për periudhën 2006-2020 kanë qenë të domosdoshme për të plotësuar detyrimet e vendit tonë përkundrejt angazhimeve të marra në kuadrin e nismës së krijimit të Tregut Rajonal të Energjisë Elektrike në vendet e Evropës Jug-Lindore, **për të përmbushur të gjitha detyrimet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe për të harmonizuar e konvergjuar zhvillimin e sektorit energjetik në përputhje me Direktivat e Bashkimit Evropian.**

Objektivat specifike të Strategjisë Kombëtare të Energjisë deri në vitin 2020:

1. Rritja e sigurisë dhe besueshmërisë në furnizimin me energji në përgjithësi dhe energji elektrike në veçanti si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë rajonal;
2. Krijimi i një sektori energjetik të afte si nga ana financiare ashtu edhe nga ajo teknike;
3. Krijimi i një kuadri efektiv institucional dhe rregullator dhe ristrukturimi i plotë i kompanive të energjisë;
4. Rritja e efikasitetit të energjisë, si gjatë prodhimit ashtu dhe gjatë përdorimit të burimeve energjetike, me synim ndotjen minimale të mjedisit;

5. Optimizimi i sistemit të furnizimit me burime energjetike duke u mbështetur në konceptin e planifikimit me kosto me të ulët dhe ndikim minimal në mjedis;
6. Rritjen e ndjeshme të investimeve në sektorin e energjisë nëpërmjet tërheqjes së kapitalit nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare si dhe të kapitalit privat;
7. Krijimin e një tregu elektrik konkurrues bazuar në kërkesat e Bashkimit Evropian për reformimin e sektorit elektroenergjetik (Direktiva 96/92 EU) dhe detyrat e Shqipërisë në kuadrin e Memorandumit të Mirëkuptimit të Athinës, (15 Nëntor 2002), për integrimin e sektorit elektroenergjetik shqiptar në Tregun Rajonal Energjetik të Evropës Juglindore dhe interkonjeksionin me rrjetin e UCTE-së.

Gjithashtu qëllimet kryesore janë përcaktuar si më poshtë:

1. Ristrukturimi i sektorit energjetik shqiptar, bazuar në parimet e ekonomisë së tregut dhe në zhvillimin e një politike bashkëkohore energjetike për krijimin e një kuadri efektiv institucional, ligjor dhe rregullator të shoqërive publike energjetike me synim privatizimin e shpejtë të tyre.
2. Nxitja e përdorimit me efikasitet të energjisë, ekonomik dhe me ndikim minimal në mjedis, në mënyrë të tillë që sektori energjetik të ishte një sektor mbështetës për një zhvillim të qëndrueshëm të gjithë sektorëve të tjerë ekonomik dhe shoqëror.
3. Optimizimi i sistemit të furnizimit me burime energjetike, duke u mbështetur në konceptin e planifikimit me kosto me të ulët dhe ndikim minimal në mjedis.
4. Rritja e sigurisë së furnizimit me burime energjetike nëpërmjet diversifikimit të sistemit energjetik dhe ndërtimit të veprave të reja gjeneruese dhe linjave të interkonjeksionit.
5. Nxitja e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë (diellore, HEC-et, erës dhe biomases), për të bërë të mundur shfrytëzimin në maksimum të burimeve lokale.
6. Hapja e tregut të brendshëm të energjisë elektrike dhe pjesëmarrje aktive në tregun rajonal të saj, në kuadrin e Traktatit të Komunitetit të Energjisë të Vendeve të Evropës Juglindore, i cili bazohet në kërkesat e Bashkimit Evropian për reformimin e sektorit elektroenergjetik (Direktiva 54/2003 e BE-së). Pjesë e objektivave 2007-2020, ka qenë dhe përafrimi i legjislacionit shqiptar me Acquis Communautaire të BE-së. Për këtë qëllim, METE (sot MIE) do të punonte për një zgjerim dhe forcim të sektorit të përafrimit të legjislacionit me atë të BE-së, i cili duhet të koordinonte me të gjitha institucionet në varësi të METE të gjithë procesin të përfarimit të legjislacionit në sektorin e energjisë. Kjo Ministri në fokus të punës do të kishte identifikimin dhe licencimin e koncesioneve të mundshme në sektorin e energjisë.

**Një rëndësi të madhe, përsa i përket promovimit të koncesioneve, do të merrnin propozimet e kërkuara të cilat kërkojnë dhe studime të detajuara të atyre objekteve që planifikohen të jepen me koncesion.**

Bazuar në nenin 3 pika 3.1.1 të Kontratës, brenda një muaji nga data e hyrjes në fuqi të saj, palët do të krijojnë Njësinë e Zbatimit të Projektit (NJZP). Referuar dokumentacionit, u konstatua se janë krijuar me vonesë NJZP-të me nga sa parashikohet në kontratë pra shoqëria koncesionare e ka krijuar me datë 21.01.2010, ndërsa autoriteti kontaktor me datë 19.04.2010.

Koncesionari, me të cilin është lidhur kontrata e projektit të HEC Devoll, në objektivat e tij ka synuar të zhvillojë, planifikojë, ndërtojë dhe operojë dy HEC-e përgjatë Lumit Devoll me kapacitet total të instaluar në turbina prej rreth 248 MW. HEC-et do të prodhojnë rreth 703 GWh/vit energji të rinovueshme dhe miqësore me mjedisin, sapo të jetë gati përshfrytëzim, duke e rritur prodhimin e energjisë në Shqipëri me 17%.

Në Shqipëri, është shitur një sasi e vogël energjie në tregun e brendshëm nga sasia totale e prodhuar e energjisë nga vënia në punë e dy HEC-eve, e si rezultat nuk është rritur furnizimi i energjisë në vend sikurse është parashikuar në objektivat e koncesionarit.

Gjithashtu, sa i takon objektivave për rritjen ekonomike prej vënies në funksion të Hec-eve të Devollit, bazuar në shtesën e trete, pika 2.10 (Nr. 8993 datë 26.02.2015), të Kontratës së Koncesionit miratuar me ligjin nr. 10083, datë 23.02.2009, në nenin 4.1.1 pika "a" dhe "b", është shtuar se Koncesionari nuk do të paguajë Tarifën e Koncesionit për Hidrocentralin e Banjës dhe Moglicës për një periudhë 15-vjecare, duke filluar nga data e lëshimit të Certifikatës së Përfundimit Final të Hidrocentralit të Banjës. Pra, deri në vitin 2031, nuk ka tarifë koncesioni për energjinë e prodhuara nga dy hidrocentralet.

Sipas dokumentacionit, fuqia totale e konfirmuar e Hecit Moglicë është 197.4 MW, dhe konfirmohet fuqia e instaluar të Hecit Banjë është 72 MW. Pra, në total fuqia e instaluar e projektit me dy Hec-e është 269.4 MW, duke përmbushur kërkesat teknike të projektit, të parashikuar në Shtojcën A të Kontratës.

U konstatua se në Kontratë nuk është parashikuar sigurimi i rezervës ujore për ujitje. Nga dokumentacioni, konstatohet se me shkresën nr. 1431 /1 prot., datë 03.03.2016 MBZHRAU bën me dije D.H. sh.a dhe MEI se edhe me shkresë 3268 datë 26.07.2012 ka informuar mbi nevojat për ujë për ujitje, në pjesën e poshtme, pas digës së Rezervuarit të Banjës, duke kërkuar që të negociohet niveli i shkarkimeve nga rezervuari i Banjës në funksion të plotësimit të kërkesave për ujë dhe rrjedha e ujit 2m 3/sekondë e propozuar nga D.H. është krejtësisht e pamjaftueshme për sezoin e ujitjes maj-shtator.

Nuk është respektuar neni 6 pika 1/a i ligjit nr. 111/2012 "Për menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore".

Referuar Politikave të Bashkimit Evropian për mjedisin, e sidomos për ndërtimin dhe operimin e hidrocentraleve janë shumë të gjera dhe komplekse. Por ato janë afirmative dhe strikte për mbrojtjen e mjedisit nga operatorët që e prodhojnë energjinë elektrike përmes shfrytëzimit të ujit. Janë disa nga direktiva evropiane, që shtetet anëtar të BE-së dhe ato që aspirojnë të bëhen pjesë e këtij tij, duhet t'i respektojnë dhe t'i bëjnë pjesë të politikave të tyre shtetërore. Një nga këto direktiva, përcakton një kornizë të bazuar në parimin se ndotësi paguan për të parandaluar dhe korrigjuar dëmet mjedisore. Ajo është e fokusuar në dëmin mjedisor që shkaktohet te speciet e mbrojtura, habitatet natyrore, dëmtimin e ujit dhe tokës. Kjo Direktivë i bën përgjegjës direkt operatorët të cilët kryejnë aktivitete të rrezikshme e që bien nën përgjegjësi të rreptë (nuk ka nevojë të vërtetimit të fajit). Për këtë çështje, gjithmonë kërkohet vendosja e një lidhje shkakësore midis aktivitetit dhe dëmit. Personat fizikë ose juridikë të prekur dhe OJQ-të mjedisore kanë të drejtë të kërkojnë nga autoriteti kompetent të vendosë për masat përmirësuese. Masat e përshtatshme për të siguruar sanimin e dëmtimit mjedisor: Çdo dëmtim mjedisor në lidhje me ujin ose speciet e mbrojtura, apo hapësirat e natyrës duhet të rikthehet në gjendjen e mëparshme përmes rehabilitimit primar, plotësues dhe kompensues. Këto veprime do të kontribuojnë në kthimin e burimeve natyrore të dëmtuara në gjendjen fillestare. Për më shumë, kjo direktivë nuk i parandalon shtetet që të mbajnë ose të miratojnë dispozita më të rrepta në lidhje me parandalimin dhe sanimin e dëmtimit të mjedisit.

Disa nga direktivat e Bashkimit Evropian janë si më poshtë:

1. Direktiva 2004/35/CE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Unionit Evropian mbi përgjegjësinë mjedisore në lidhje me parandalimin dhe sanimin e dëmit mjedisor.
2. Direktiva 2008/99 EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Evropës mbi mbrojtjen e mjedisit përmes rrugëve penale.
3. Direktiva 2009/28 siguron kornizën në të cilën të gjithë shtetet anëtare dhe ato që pretendojnë të bëhen në një të ardhme pjesë e BE-së, mund të vendosin Planet e tyre Kombëtare për rritjen e përdorimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë (BRE), në mënyrë që të përmbushin objektivat e energjisë të Bashkimit Evropian.
4. Direktiva 2009/28/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit të Evropës mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme. Njëri nga instrumentet më të rëndësishme evropiane, në lidhje me mbrojtjen e mjedisit është Direktiva për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. Kjo direktivë ka pësuar shumë ndryshime prej se është miratuar. Ndryshimet e fundit i kanë kushtuar vëmendje më të madhe kërcënimeve dhe sfidave që janë shfaqur si efikasiteti i burimeve, ndryshimi i klimës dhe parandalimi i katastrofave, të cilat tani reflektohen më mirë në procesin e vlerësimit. Sipas kësaj direktive, vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet t'i identifikojë dhe të vlerësojë në mënyrë të përshtatshme, në dritën e secilit rast individual dhe të drejtpërdrejtë, efektet indirekte të një projekti në faktorët e mëposhtëm: a) qeniet njerëzore, fauna dhe flora; b) toka, uji, ajri, klima dhe peizazhi; c) pasuritë materiale dhe trashëgimia kulturore. Ndikimi mjedisor dhe social nga zbatimi dhe vendosja në punë e projektit me objekt "Ndërtimi i Hidrocentralit/Hidrocentraleve në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë".

Zbatimi i Projektit duhet të përmbushë kërkesat e IFC-së (International Finance Corporation) si një standard reference ndërkombëtarë për strategjitë sociale dhe mjedisore.

Standardet e Performancës të IFC janë:

- Standarti i Performancës 1: Vlerësimi Social dhe Mjedisor dhe Sistemi i Administrimit.
- Standarti i Performancës 2: Kushtet e Punësimit dhe Punës.
- Standarti i Performancës 3: Parandalimi dhe Pakësimi i Ndotjes .
- Standarti i Performancës 4: Shëndeti, Mbrojtja dhe Sigurimi i Komunitetit.
- Standarti i Performancës 5: Blerja e Tokës dhe Zhvendosja e Pavullnetshme e Banimit.
- Standarti i Performancës 6: Konservimi i Biodiversitetit dhe Administrimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore .
- Standarti i Performancës 7: Popullatat Indigjene.
- Standarti i Performancës 8: Trashëgimia Kulturore.

Aplikimi i standarteve të IFC kërkon gjithashtu proceset e mëposhtme:

- Ekzaminimin (Scoping): një proces prej të cilit palët e interesuara konsultohen të kontribuojnë në identifikimin e çështjeve kyç që duhet të investigohen si pjesë e VNMS-së.
- Angazhimi i Palëve të Interesuara: një përafrim gjithë përfshirës për komunikim dhe konsultim me palët e interesuara të identifikuar gjatë ciklit jetësor të projektit.

- Fokusi mbi Çështjet Mjedisore: ndërsa legjislacioni shqiptar i referohet kryesisht ndikimeve mjedisore, përafrimi i IFC-së fokusohet gjithashtu mbi identifikimin e ndikimeve mbi komunitetet e ndikuara.

## Dëgjesa publike

Kuadri ligjor për procedurat e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) në Shqipëri bazohet në Ligjin Nr. 10440 mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të aprovuar në 07 Korrik 2011. Kapitulli II i ligjit nr. 10440 kërkon pjesëmarrjen e publikut në procesin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis në linjë me kërkesat e legjislacionit të ri mbi mjedisin dhe direktivat përkatëse të BE.

Me shkresën nr. 4575/1 datë 01.06.2010, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, i ka dërguar Ministrisë së Mjedisit Pyjeve e Administrimit të Ujërave materialin për dëgjuesën publike (Marrëveshja e Koncesionit lidhur me Projektin Hidroenergjetik të lumit të Devollit, ku informon se në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në Marrëveshjen e Koncesionit dhe kërkesave ligjore për vlerësimin mjedisor, D. H. sh.a ka paraqitur pranë METE materialin “Dëgjuesë publike për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe Propozimin për Planifikimin Energjetik në lumin Devoll”, për t’u konsideruar nga MMPAU në procedurat për pajisjen e kësaj shoqërie me Lejen Mjedisore. Gjithashtu, bazuar Marrëveshjen midis Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe D.H., më 14.02.2014, D.H. angazhoi J. I. dhe S., si Kompani Projektuese për Rrugën Banjë–Gramsh dhe Urën e Trashovicës, të cilët përgatitën projektin paraprak së bashku me Raportet Ekzaminues dhe Qëllimor Mjedisor dhe Social të cilët detajuan vlerësimin e ndikimeve. DHP, Projektuesi dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar në bashkëpunim, realizuan Dëgjuesë Publike në 30.07.2014, në të cilën u publikuan këto ndikime dhe u propozuan tre alternativa për Rrugën Zëvendësuese Banjë – Gramsh dhe Ura e Trashovicës. Gjithashtu, është realizuar edhe një dëgjuesë publike e dytë, më datë 8.10.2014, mbi Raportin e Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor e Social lidhur me ndërtimin e kësaj rruge.

Ndikimi social i parashikuar nga zbatimi dhe vendosja në punë e projektit:

- Rrugë të reja.
- Humbje e rrugëve dhe kalimeve ekzistuese për shkak të përmbytjeve dhe vërshimeve.
- Humbja e urave dhe pikave të kalimit mbi lumë.
- Humbja e shtëpive dhe pronave.
- Dëmtimi i ndërtesave për shkak të rritjes së erozionit dhe shkarjes së tokës.
- Humbje e të korrave dhe tokës bujqësore.
- Prekja e zonave me potencial arkeologjik.

Ndikimi mjedisor i parashikuar nga zbatimi dhe vendosja në punë e projektit:

- Ndryshim të ekosistemeve ujore dhe përbërjes së llojeve.
- Humbje të Florës dhe Faunës ujore.
- Humbje të bimësisë tokësore dhe habitateve të kafshëve të egra.
- Humbje të tokës pyjore dhe bujqësore.
- Humbje e ujërave ose furnizim i paqëndrueshëm me ujë, që vështirëson sigurimin e ujit për ujë.

Në vlerësimin e ndikimit mjedisor e social (VNMS) është parashikuar një plan menaxhimi (PMMS) në kuadër të masave që do të merreshin për lehtësimin e ndikimeve mjedisore e sociale

negative, si dhe kryerjen e monitorimit, si një element i rëndësishëm për implementimin efikas të PMMS-së.

**Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion u konstatua se nuk ka asnjë raport lidhur me monitorimin e efekteve të mundshme negative mjedisore të krijuara nga vënia në zbatim e projektit.**

#### **2.4. Mbi menaxhimin financiar të projektit, shkallën e realizimit të disbursimeve financiare kundjet nivelit të programuar. Raportimi i tyre në Ministrinë e Financave.**

Në zbatim të pikës nr. 4, të programit të auditimit nr. 446/1 prot., datë 27.05.2022, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

4. Kontrata e lidhur nga MIE si AK me Koncesionarin
5. Urdhra pagesa sipas kushteve të kontratës së lidhur me Koncesionarin
6. Dokumentet shoqëruese të urdhër pagesave
7. Dokumente të tjera

#### **Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:**

Më datë 14.02.2014, mes palëve Ministria e Energjisë dhe Industrisë (AK), Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARSH) dhe shoqërisë D. H. Sh.A., është lidhur marrëveshja “Në lidhje me projektimin, tenderimin e Infrastrukturës Zëvendësuese (Rrugë dhe Ura) dhe ndërtimin e rrugës M15 të Infrastrukturës Zëvendësuese të Moglicës”.

Objekti i marrëveshjes është realizimi i ndërtimit të infrastrukturës zëvendësuese të HEC Banjë, a. Rruga zëvendësuese nga Banja në Gramsh, b. Ura e Trashovicës, si dhe infrastruktura zëvendësuese e HEC Moglicë, me a. Rrugën zëvendësuese në Moglicë M-15 dhe rrugën zëvendësuese Moglicë M-03.

Në shtesën e 3-të të Kontratës së Koncesionit për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Projektit të Hidrocentralit në lumin Devoll në Republikën e Shqipërisë e lidhur më datë 19 dhjetor 2008, e cila është miratuar nga Parlamenti Shqiptar nëpërmjet ligjit nr. 10083, datë 23 shkurt 2009 dhe plotësuar nga shtesa e 1-rë e Kontratës së Koncesionit datë 3 gusht 2010, e cila është miratuar me ligjin nr. 10337, datë 21 tetor 2010, dhe plotësuar nga shtesa e 2-të e Kontratës së Koncesionit datë 19 mars 2013, e cila është miratuar me ligjin nr. 105/2013, datë 28 mars 2013 midis:

1. Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë së Republikës së Shqipërisë, ish-Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (“MEI” ose “Autoriteti Kontraktues”).

2.a) S.AS, një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit të Mbretërisë së Norvegjisë me seli në Lilleakerveien 6, 0283 Oslo, Norvegji, dhe e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Norvegjisë.

b)D. H. sh.a., një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, me seli në Tiranë, Shqipëri (Shoqëria e Projektit), janë bërë përcaktimet kryesore të modaliteteve të pagesave të kryera nga MIE (ish MEI, METE), për disbursimin e shpenzimeve për ngritjen e Infrastrukturës ekzistuese në Hidrocentralet e Banjës dhe Moglicës.

Sipas nenit 7.2.6 të Kontratës së Koncesionit dhe marrëveshjes “Për mënyrën e pagesave në lidhje me Infrastrukturën Zëvendësuese (“rrugët dhe urat”) të lidhur midis Shoqërisë së Projektit, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar më 5.9.2013 “Marrëveshje mbi mënyrën e pagesës” është rënë dakord se shuma që Koncesionari do t’i paguajë Autoritetit Kontraktues si kompensim për Infrastrukturën Zëvendësuese do të jetë 10.550.000 euro (dhjetë milionë e pesëqind e pesëdhjetë mijë euro).

Meqënëse Autoriteti Kontraktues nuk ka përmbushur në kohë detyrimet në lidhje me planifikimin, projektimin dhe ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese dhe nuk ka arritur të sigurojë fondet e nevojshme për planifikimin, projektimin dhe ndërtimin e saj.

Ministria e Energjisë dhe Industrisë i kërkoi Koncesionarit në mbledhjen e datës 10.10.2013 gjetjen e një zgjidhjeje alternative për financimin, projektimin dhe ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese për shkak të mungesës së fondeve.

Në ndryshimet e reja të kontratës është përcaktuar se Koncesionari do të jetë përgjegjës për punimet e Infrastrukturës Zëvendësuese përfshirë financimin, projektimin, planifikimin, tenderimin, ndërtimin, dhe dorëzimin e Infrastrukturës Zëvendësuese me kusht që Autoriteti Kontraktues të kompensojë plotësisht Koston e Infrastrukturës Zëvendësuese.

Në veçanti, Koncesionari pritet që: Do të sigurojë mjetet financiare të nevojshme për planifikimin, projektimin dhe ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese, që përcaktohet në nenin 7.2.7.3. Vlerësimi fillestar kostove përkatëse përpara marrjes së ofertave të tenderit, bazuar në projektidetë ishte në shumën 49,646,269 euro, siç është përcaktuar më hollësisht në aneksin I bashkëngjitur. Kjo shumë do të përditësohet pas miratimit të propozimit të projektit të detajuar nga enti shtetëror (ARRSH). Kostoja e parashikuar e projekteve përkatëse, e miratuar nga enti shtetëror përkatës (ARRSH) do të shërbejë si limit për procesin e tenderimit, siç përcaktohet në nenin 3 të kësaj Shtese të 3-të. Këto shuma të parashikuara në projektin e detajuar nuk përbëjnë kostot finale të rimbursueshme sipas kësaj marrëveshjeje dhe janë përditësuar gjatë fazës së ndërtimit të Infrastrukturës Zëvendësuese, me miratimin paraprak të ARRSH-së, siç përcaktohet në paragrafin e dytë të nenit 3.5. Koncesionari do të sigurojë projektimin e Infrastrukturës Zëvendësuese në përputhje me kërkesat teknike, siç parashikohet në aneksin II bashkëngjitur kontratës dhe legjislacionin shqiptar përkatës deri në masën që ky i fundit është i zbatueshëm dhe në përputhje me aneksin II, si dhe të propozojë modifikime të këtyre projekteve ose riprojektme nëse konsiderohen të nevojshme;

Do të organizojë tenderë dhe lidhë kontratat për punimet lidhur me planifikimin, projektimin dhe ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në Marrëveshjen e Infrastrukturës Zëvendësuese bashkëngjitur si aneksi III, si dhe do të organizojë dhe mbikëqyrë punët për planifikimin, projektimin dhe ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese siç parashikohet në Marrëveshjen e Infrastrukturës Zëvendësuese bashkëngjitur si aneksi III dhe legjislacionin shqiptar përkatës deri në masën që ky i fundit është i zbatueshëm dhe në përputhje me aneksin III.

Nga Koncesionari pritet që të dorëzojë tek Autoriteti Kontraktues punimet e përfunduara dhe Autoriteti Rrugor shqiptar do të fitojë pronësinë mbi Infrastrukturën Zëvendësuese, përfshirë këtu edhe punën në proces gjatë ndërtimit.

Marrëveshja e Infrastrukturës Zëvendësuese ka qenë pjesë integrale e Kontratës së Koncesionit, siç është përcaktuar në aneksin III dhe detyrimet e marra përsipër nga palët e Marrëveshjes së Infrastrukturës Zëvendësuese do të konsiderohen si detyrime të Autoritetit Kontraktues dhe



Koncesionarit sipas Kontratës së Koncesionit. Pavarësisht kësaj, nëse dispozitat e Marrëveshjes së Infrastrukturës Zëvendësuese bien në kundërshtim me Kontratën e Koncesionit, dispozitat e kësaj të fundit do të kenë përparësi.

Në kontratë është përcaktuar se Koncesionari do të rimburohet plotësisht për të gjitha shpenzimet e kryera në lidhje me planifikimin, projektimin, tenderimin dhe ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese që vijon: rruga zëvendësuese Banja - Gramsh, Ura e Trashovicës, rruga zëvendësuese Moglicë M15 dhe rruga zëvendësuese Moglice M03, minus 10.550.000 EURO (dhjetë milionë e pesëqind e pesëdhjetë mijë euro) e cila është shuma totale e kompensimit e pagueshme nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues sipas nenit 7.2.6 të Kontratës së Koncesionit (Kostoja e Infrastrukturës Zëvendësuese).

Nga palët është dakortësuar se rimbursimi i Kostos së Infrastrukturës Zëvendësuese nga Autoriteti Kontraktues tek Koncesionari do të kryhet si më poshtë:

-Autoriteti Kontraktues do t'i paguajë Koncesionarit Koston e Infrastrukturës Zëvendësuese me këste ne secilën datë pagese (Datë Pagese) në shuma sipas kështit të pagueshëm (Kësti i Pagueshëm) që aplikohen në Datë-Pagesën përkatëse sipas përcaktimeve në tabelën më poshtë:

Datë pagese	Kësti i pagueshëm
28-shkurt-2015	EUR 8 milionë
28-shkurt-2016	EUR 10 milionë
28-shkurt-2017	EUR 10 milionë
28-shkurt-2018	50% e: Kostos totale të Infrastrukturës Zëvendësuese minus Këstet e Pagueshme të paguara dhe çdo shumë të kompensuar në zbatim të nenit 7.2.7.6
28-shkurt-2019	Shuma e mbetur

Në kontratë është përcaktuar qartë se *rregullat e prokurimit publik* të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar apo në ndonjë akt ligjor që mund të ndryshojë ose të zëvendësojë atë, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij ose në zbatim të ndonjë akti ligjor që mund të ndryshojë ose të zëvendësojë atë, *nuk do të zbatohen nga Koncesionari në procesin e tenderimit të projektimit, ndërtimit, mbikëqyrjes ose shërbime të tjera ndihmëse në lidhje me Infrastrukturën Zëvendësuese.*

*Përzgjedhja e kontraktorëve të angazhuar në procesin e projektimit, ndërtimit, mbikëqyrjes ose shërbime të tjera ndihmëse në lidhje me Infrastrukturën Zëvendësuese do të kryhet nëpërmjet një procedure konkurruese të përcaktuar nga Koncesionari. Projektimi, ndërtimi, mbikëqyrja dhe testimi i Infrastrukturës Zëvendësuese do të kryhet nga subjekte të specializuara dhe të licencuara, në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara në aneksin II.*

**Autoriteti Kontraktues do të monitorojë procedurën e tenderimit të Infrastrukturës Zëvendësuese dhe për këtë qëllim do të caktojë 2 (dy) persona të autorizuar të cilët do t'i nënshtrohen detyrimeve të konfidencialitetit dhe mospublikimit të ndonjë informacioni të marrë gjatë procesit të mësipërm, dhe që do të nënshkruajnë një marrëveshje konfidencialiteti dhe mospublikimi të informacionit me përmbajtje që plotëson kërkesat e Koncesionarit.**

Autoriteti Kontraktues dhe/ose çdo Ent tjetër Shtetëror (ARRSH) do të mbikëqyrë ndërtimin, mbikëqyrjen dhe testimin e Infrastrukturës Zëvendësuese nëpërmjet personelit të saj të specializuar.

Koncesionari do të dorëzojë projektin e detajuar final të propozuar dhe vlerat e përditësuara të parashikimit të kostove për çdo pjesë të Infrastrukturës Zëvendësuese përkatëse kur të jetë e mundur, tek Enti Shtetëror përgjegjës (ARRSH) për miratim, miratim i cili nuk duhet të refuzohet pa arsye. Bazuar në miratimin e projektit të detajuar nga Enti Shtetëror, Koncesionari do të realizojë procesin e tenderimit dhe do të njoftojë Autoritetin Kontraktues për vlerën e negociuar të kontratave përpara se të shpallet fituesi. Miratimi i projektit të detajuar nga Enti Shtetëror si dhe vlerat e kontratave do të shërbejnë si bazë për miratimin nga ana e Autoritetit Kontraktues të vlerës së kontratës fituese.

Nëse vlerat e negociuara të kontratave nuk i tejkalojnë kostot e projektit të detajuar të miratuar nga Enti Shtetëror, atëherë Koncesionari do të lidhë kontrata ndërtimi mbi këtë bazë dhe do të vazhdojë me ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese përkatëse. Për të shmangur çdo dyshim, kontratat e ndërtimit bazohen në sasi dhe nuk janë kontrata me çmim fiks. Çdo punim shtesë mbi volumet e përcaktuara në projektin e detajuar sipas kontratës, duhet të miratohet, në mënyrë progresive me realizimin e projektit, si nga Enti Shtetëror (ARRSH) ashtu edhe nga Koncesionari. Në këtë mënyrë, kostot finale të ndërtimit, të cilat do të përbëjnë shumën për t'u rimbursuar sipas nenit 7.2.7 të Kontratës së Koncesionit, nuk do të konfirmohen përpara se ndërtimi të jetë përfunduar.

Nëse vlerat e kontratave tejkalojnë parashikimin e kostove të projektit të detajuar, atëherë vlerat do të miratohen nga të dyja Palët e Kontratës së Koncesionit dhe Koncesionari do të punojë për rishikimet e projektit, rinegocimet e ofertave të tenderit dhe masa të tjera dhe Palët do të synojnë të bien dakord në mirëbesim për një përditësim të kostos së parashikuar.

Nga palët është rënë dakord që ARRSH do të monitorojë dhe kontrollojë projektin dhe ndërtimin e aktiviteteve në lidhje me Infrastrukturën Zëvendësuese deri në momentin që aktivitetet e përfunduara t'i kalojnë ARRSH-së. Në të njëjtën kohë, çdo ndryshim/devijim nga projekti i miratuar dhe nga pjesa teknike e dokumenteve të tenderit, duke përfshirë termat e referencës dhe specifikimet teknike do t'i nënshtrohen miratimit paraparak të ARRSH-së.

Në aneksin V të Kontratës së Koncesionit (e ndryshuar me Shtesën e 3-të të Kontratës së Koncesionit), janë caktuar dokumentet që duhet ti paraqiten Autoritetit Kontraktues për Kostot e Infrastrukturës Zëvendësuese te kryera si vijon më poshtë:

- 1) Kërkesë për rimbursim nga Shoqëria e Projektit që përmban një përmbledhje të hollësishme e Kostove re Infrastrukturës Zëvendësuese të kryera
- 2) Kopje të urdhër pagesave për qëllimin e shpronësimeve të truallit.
- 3) Pasqyra tabelë e Shoqërisë së Projektit për shpenzimet sociale dhe ambientaliste.
- 4) Kopje të faturave dhe urdhër pagesave për shpenzimet sociale dhe ambientaliste.
- 5) Kopje të kontratave të lidhura me Kontraktorët e Infrastrukturës Zëvendësuese.
- 6) Kopje të Situacioneve Progresive të Punimeve të lëshuara nga Kontraktorët e Infrastrukturës Zëvendësuese dhe të bashke-nënshkuara nga një përfaqësues i Autoritetit Rrugor Shqiptar në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara në paragrafin e fundit të nenit 3 të Shtesës së 3 të Kontratës së Koncesionit.
- 7) Kopje të faturave të lëshuara nga Kontraktorët e Infrastrukturës Zëvendësuese për furnizimin e mallrave dhe shërbimeve në lidhje me Infrastrukturën Zëvendësuese.

8) Dokumentacion nga Shoqëria e Projektit për kostot e veta në lidhje shpenzimet për mbikëqyrje/menaxhim të kontratave. Këtu përsihen dietat dhe shpenzimet e lidhura me kryerjen e punës dhe kostoja për ore pune e personelit e dokumentuar nga përshkrimi i punës i punëmarrësit. Kosto e orës së punës për person do llogaritet bazuar në pagën përkatëse dhe shpenzimet e përgjithshme administrative të dokumentuara nga analizat e kostove të shpenzimeve të përgjithshme administrative.

9) Kopje të faturave për kërkimet gjeologjike bashkë me kopje të urdhër pagesave.

10) Kopje e çdo urdhër pagese për tarifa të ndryshme ndaj Organeve Publike.

11) Kopje e kontratave të sigurimit, faturat për kostot e sigurimit dhe urdhër pagesa përkatëse.

12) Kopje e çdo fature tjetër ose dokumentacioni të Kostos së Infrastrukturës Zëvendësuese.

13) Pasqyrë/tabelë nga Shoqëria e Projektit ku përmbahen të dhëna për llogaritjen e çdo kamatë vonese sipas pikës b) të Nenit 72.7.5 të Kontratës së Koncesionit.

Kosto totale e projektit është 61,017,123 Euro, nga këto janë zbritur 10,500,000 euro dhe janë disbursuar 50,517,123 Euro.

Nga MIE (ish -MEI), gjatë periudhës 2015-2019 janë kryer pagesat si më poshtë:

Nr	Data	Vlera Lekë	Vlera Euro
1	10.4.2015	225.303.064	2.367.965
2	27.3.2015	332.604.347	1.604.494
3	8.9.2015	562.092.589	4.023.568
4	7.12.2015	547.241	3.973
5	1.3.2016	1.384.300.000	10.000.000
6	1.3.2017	1.351.200.000	10.000.000
7	23.3.2018	1.355.108.108	10.435.950
8	3.4.2019	1.505.821.613	12.031.173
	<b>Totali</b>	<b>6.716.976.962</b>	<b>50.467.123</b>

Për kryerjen e pagesave nga Ministria ka pritur miratimin e shtesës së tretë nga Parlamenti i Shqipërisë me Ligjin Nr. 7/2015 në datën 12.02.2015.

Shkresat e D.H. rreth Rimbursimit të kostove të Infrastrukturës Zëvendësuese janë si vijon:  
-Shkresa e D.H. date 31.01.2015, nr. Prot. 2015-TR-00132 - për vitin 2014.

Në këtë shkresë është kërkuar rimbursimi i Kostove të Infrastrukturës Zëvendësuese për vitin kalendarik 2014, në përputhje me nenin 7.2.7.5, 7.2 7.7 të Shtojcës së 3-1 të Kontratës së Koncesionit. Kësaj shkrese i janë bashkëngjitur kostot e dokumentuara deri me 31 janar 2015 në vlerën 3,972,459 milion euro.

Rruga Banjë Gramsh, seksioni 3A-3B, bregu verior i rezervuarit të Banjës dhe ura e Trashovicës

	Lloji i kostove	Totali i kostove të kërkuara më parë në Euro	Totali i kostove për këtë kërkesë në Euro
A	Kosto që lidhen me pronat		
A 1	Kosto për shpronësimet		
A 2	Kosto mjedisore dhe sociale		7,720
B	Kosto për punimet e ndërtimit		
C	Shërbime inxhinierike		
C 1	Projekti paraprak, projekti i detajuar, projekti i zbatuar, azhurnimi i projektit gjatë ndërtimit		995,567
C 2	Mbikëqyrja, Kostot e menaxhimit		210,989
C 3	Investigimet gjeologjike		255,123
D	Kosto shtesë		
D 1	Tarifa/taksa për autoritetet		6,595
D 2	Kostot e investitorit/pronarit për cdo seksion		4,240
D 3	Kostot e policave të sigurimit		
E	Kostot e paparashikuara		
E 1			
<b>TOTALI</b>	<b>Rruga Banjë Gramsh, seksioni 3A-3B, bregu verior i rezervuarit të Banjës dhe ura e Trashovicës</b>		<b>1,480,234</b>

#### Moglicë M15

	Lloji i kostove	Totali i kostove të kërkuara më parë në Euro	Totali i kostove për këtë kërkesë në Euro
A	Kosto që lidhen me pronat		
A 1	Kosto për shpronësimet		
A 2	Kosto mjedisore dhe sociale		
B	Kosto për punimet e ndërtimit		2,367,965
C	Shërbime inxhinierike		
C 1	Projekti paraprak, projekti i detajuar, projekti i zbatuar, azhurnimi i projektit gjatë ndërtimit		26,215
C 2	Mbikëqyrja, Kostot e menaxhimit		22,000
C 3	Investigimet gjeologjike		
D	Kosto shtesë		
D 1	Tarifa/taksa për autoritetet		2,189
D 2	Kostot e investitorit/pronarit për cdo seksion		
D 3	Kostot e policave të sigurimit		
E	Kostot e paparashikuara		
E 1			
<b>TOTAL I</b>	<b>Moglicë M15</b>		<b>2,418,369</b>

#### Moglicë bregu verior seksioni 4

	Lloji i kostove	Totali i kostove të kërkuara më parë në Euro	Totali i kostove për këtë kërkesë në Euro
A	Kosto që lidhen me pronat		

A 1	Kosto për shpronësimet			
A 2	Kosto mjedisore dhe sociale			
B	Kosto për punimet e ndërtimit			
C	Shërbime inxhinierike			
C 1	Projekti paraprak, projekti i detajuar, projekti i zbatuar, azhurnimi i projektit gjatë ndërtimit			43,356
C 2	Mbikëqyrja, Kostot e menaxhimit			30,500
C 3	Investigimet gjeologjike			
D	Kosto shtesë			
D 1	Tarifa/taksa për autoritetet			
D 2	Kostot e investitorit/pronarit për cdo seksion			
D 3	Kostot e policave të sigurimit			
E	Kostot e paparashikuara			
E 1				
<b>TOTALI</b>	<b>Moglicë M15</b>			<b>73,856</b>

<b>TOTALI i kërkesës</b>	<b>Totali i kërkuar më parë</b>	<b>Totali i kostove që kërkohe</b>
	<b>Euro</b>	<b>Euro</b>
		<b>3,972,459</b>

Për kërkesën sa më sipër Ministria e Energjitikës dhe Infrastrukturës ka kryer pagesën me datë 27.03.2015, në vlerën 332,604,347 lekë, (2,367,964.88 euro x 140,46 lek) dhe pagesën datë 08.04.2015 në vlerën 225,303,064 lekë (1,604,494,.12 euro x 140.42 lek).

Me urdhër shpenzimin nr. 78, datë 27.03.2015, e firmosur nga z. K. B. si person urdhërues, për certifikatat me nr 11-19, të paraqitura nga D.H., në vlerën 2,367,964,.88 Euro. Me urdhrin nr. 80, datë 25.03.2015, z. I. B., në cilësinë e zëvendësimit të Ministrit, ka urdhëruar pagesën sa më sipër. Në kartelën shoqëruese të praktikës së paraqitur nga D.H., me nr. prot. 1157/2 datë 10.03.2015, nën trajtim nga z. K. B. dhe zv. Ministri z. I. B. ishte bashkëlidhur dokumentacioni që vijon. Kërkesa e D.H. për rimbursim të shpenzimeve të kryera, përmbledhëse të shpenzimeve, kopje e kontratës së lidhur me MEI dhe ARRSH, dhe përmbledhje të orëve të punës së ekspertëve mbikëqyrës të rrugëve.

Numri i IPC	Fornitori	Seksioni i rrugës	Numri i faturës	Data e fatures	Vlera në Euro
EUR IPC 12/1	E.	Moglice M15 Section 4	64	06/06/2014	364
EUR IPC 12/2	E.		63	31/05/2014	17,200
EUR IPC 11	E.		42	30/04/2014	14,040
EUR IPC 13	E.		80	30/06/2014	171,372
EUR IPC 14/1	E.		98	06/08/2014	390
EUR IPC 14/2	E.		97	31/07/2014	327,908
EUR IPC 15	E.		106	31/08/2014	270,702
EUR IPC 17	E.		13	30/09/2014	392,021

EUR IPC 18	E.		150	31/10/2014	726,627	
EUR IPC 19	E.		163	30/11/2014	447,341	
Invoice 28	G.G. shpk		30	16/12/2014	4,940	
Invoice 30	G. G. shpk		15	28/05/2014	21,275	
Invoice 32	G.G.shpk		2	13/06/2014	2.189	
DHP	D.H. Internal Hours		N//A	30/01.2015	22,000	
Total					2,418,369	EURO

Në shkresën e D.H., date 31.01.2015, nr. Prot. 2015-TR-00132 - për vitin 2014, dhe shkresën e D.H. date 02.03.2015, nr. Prot. 2015-TR-00349, janë kërkuar rimbursimi i Kostove të Infrastrukturës Zëvendësuese për vitin kalendarik 2014, në përputhje me nenin 7.2.7.5, 7.2 7.7 të Shtojcës së 3-1 të Kontratës së Koncesionit. Shkresave i janë bashkëngjitur kostot e dokumentuara deri me 31 janar 2015 në vlerën 3,972,459 milion euro.

Për kërkesat sa më sipër Ministria e Energjitikës dhe Infrastrukturës ka kryer pagesën më datë 27.03.2015, në vlerën 332,604,347 lekë, (2,367,964.88 euro x 140,46 lek) dhe pagesën datë 08.04.2015 në vlerën 225,303,064 lekë (1,604,494,.12 euro x 140.42 lek).

Me urdhër shpenzimin nr. 78, datë 27.03.2015, e firmosur nga z. K. B. si person urdhërues, për certifikatat me nr 11-19, të paraqitura nga D.H., në vlerën 2,367,964,.88 Euro. Me urdhrin nr. 80, datë 25.03.2015, z. I. B., në cilësinë e zëvendësit të Ministrit, ka urdhëruar pagesën sa më sipër. Me urdhër shpenzimin nr. 100, datë 08.04.2015, MEI ka urdhëruar pagesën e 225,303,064 lekë për shpenzime të kryera nga D.H.. Për këtë pagesë është lëshuar dhe urdhri nr. 92 datë 02.04.2015, nga Ministri i përfaqësuar nga z. I. B., për shlyerjen e vlerës 1,604,494 Euro.

Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e përfaqësuar nga Zëvendësministri z. I. B., dhe z. K. B. kanë urdhëruar pagesat e mësipërme në kundërshtim me ligjin për koncesionet.

Në shtesën e tretë të Kontratës së Koncesionit, është përcaktuar se në nenin 1 të Kontratës së Koncesionit “Marrëveshja e Infrastrukturës Zëvendësuese” nënkupton marrëveshjen e lidhur më datë 14.2.2014 midis Autoritetit Kontraktues, Shoqërisë së Projektit dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar për projektimin, tenderimin e Infrastrukturës Zëvendësuese (rrugët dhe urat) dhe ndërtimin e Rrugës M15 të Infrastrukturës Zëvendësuese të Moglicës, bashkëngjitur si Aneksi III. Pra kjo marrëveshje është pjesë e Kontratës së Koncesionit dhe si e tillë aprovohet në Këshillin e Ministrave, siç përcaktohet në pikën 4 të Nenit 21, Caktimi i ofertuesit më të mirë dhe negociimet përfundimtare, të ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006, i ndryshuar, ku citohet: *Pas përfundimit të negociimit për kontratën koncesionare, Njësia e Trajtimit të Koncesioneve, brenda 45 ditëve, jep mendim me shkrim për kushtet e kontratës. \*Pas marrjes së mendimit dhe nënshkrimit, kontratat koncesionare me vlerë investimi mbi 20 milion euro paraqiten për miratim në Këshillin e Ministrave. Kontratat koncesionare me vlerë nën 20 milion euro hyjnë në fuqi pas nënshkrimit nga autoriteti kontraktues.*

Me ligjin nr. 7/2015, miratuar më datë, 12.02.2015, “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 10 083”, datë 23.2.2009, i ndryshuar Këshilli i Ministrave ka miratuar dhe përmbajtjen e shtesës së

tretë të kontratës së koncesionit. Në lidhje me procesin e projektimit dhe zbatimit të Infrastrukturës Zëvendësuese”, janë përcaktuar rregulla dhe procedura që do të ndiqen nga D.H., dhe do të monitorohen nga Autoriteti Kontraktor.

Me urdhër pagesat e mësipërme janë urdhëruar të likuidohen shpenzime për të cilat nuk janë zbatuar këto procedura si dhe i përkasin periudhës 2013-2014, para se të aprovohej shtesa e tretë e kontratës nga Këshilli i Ministrave.

Gjithshtu në shtesën e tretë të kontratës ishte parashikuar se Autoriteti Kontraktues do të monitorojë procedurën e tenderimit të Infrastrukturës Zëvendësuese dhe për këtë qëllim do të caktojë 2 (dy) persona të autorizuar.

Me autorizimin nr.39/153, datë 14.11.2014 të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë është ngarkuar përfaqësues i Autoritetit Kontraktor z. A. B., për të: "Verifikuar procedurat e aplikueshme, dokumentacionin e procedurës, ftesat e nisura në adresë të pjesëmarrësve, ofertat e paraqitura, procesin e vlerësimit, dhe çdo fazë tjetër që lidhet me shqyrtimin dhe vlerësimin korrekt të ofertuesve. I autorizuari ka të drejtë të informojë menjëherë Autoritetin Kontraktues, në rast se do të konstatojë ndonjë devijim nga procedurat apo shkelje në procesin e hartimit të dokumentacionit, vlerësimit e përzgjedhjes së ofertuesve dhe është i detyruar të mos përhap këtë informacion tek personat e tretë". Kontratat për ndërtimin e kësaj rruge (projektimi, ndërtimi dhe mbikëqyrja) janë lidhur gjatë viti 2013-2014, ndërsa përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor është caktuar në datën 14.11.2014.

Në zbatim të autorizimit nr.39/153, datë 14.11.2014, me marrjen e detyrës përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor të paktën duhet t'i këkonte D.H. që të përcillte të gjithë dokumentacionin e inventarizuar të përzgjedhjes së kontraktorëve dhe ta arshivonte në MEI procedurat konkurruese, për hartimin e projektit të zbatimit të infrastrukturës që do të zëvendësohet.

Gjithashtu nga personi i autorizuar znj. E. K., me autorizimin nr. 406/23 Prot., datë 03.04.2015, për monitorimin e procedurave nuk u disponuan relacione, dokumente, akte të ndryshme për të vërtetuar rregullshmërinë e procedurave të kryera në periudhën e mëvonshme nga shoqëria D.H.. Pa u miratuar, në Këshillin e Ministrave dhe në Kuvend, -shtesa nr.3 e kontratës së koncesionit të sipërcituar, menjëherë, pas lidhjes së marrëveshjes në datën 05.09.2013 dhe para lidhje së marrëveshjes së datës 14.2.2014 "Pëi projektimin dhe tenderimin e Infrastrukturës Zëvendësuese", koncesionari, ka filluar procedurat e konkurimit për hartimin e projektit të zbatimit të infrastrukturës që do të zëvendësohet: riga Banja-Gramsh dhe Ura e Trashovics, rruga Moglicë M03 dhe mbështetje projektimi për punimet në vazhdim në rrugën Moglice M15.

**Pra del qartë se, këto kontrata nuk janë nuk janë monitoruar dhe mbikëqyrur nga Autoriteti Kontraktor.**

**Vlera 3,972,459 milion euro përbën shpenzime jo të justifikuar për Buxhetin e Shtetit.**

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi z. I. B..

-Gjatë auditimit të dokumentacionit justifikues për rimbursimet e kryera u konstatua se D.H. ka vendosur në situacione kosto për shpronësime të truallit si dhe shpenzime sociale dhe ambientaliste.

Në shkresën e D.H., dërguar MIE, datë 31.01.2019, për rimbursimin e kështit të fundit, janë paraqitur si kosto të akumuluar dhe të kërkuara për rrugën zëvendësuese Banjë Gramsh dhe ura e Trashovicës në vlerën 282,316 Euro, dhe për rrugët zëvendësuese të Moglicës 102,626 euro, në total vlerën 384,942 Euro.

Në lidhje me shpronësimet e truallit Këshilli i Ministrave ka nxjerrë VKM nr. 674, datë 15.10.2014, "Për shpronësimin, për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Gramsh-Lozhan", me vlerë totale 2,726,182 lekë, e cila do të rimburohet nga D.H., VKM nr. 285, datë 13.4.2016 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "hidrocentrali i Banjës – Gramsh dhe ura e Trashovicës", me vlerë 30,929,985 lekë, të cilat do të përballohen nga buxheti i shoqërisë D. H. dhe VKM nr.464, datë 26.7.2018," Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Rrugët zëvendësuese M03 për ndërtimin e hidrocentralit të Moglicës" me vlerë prej 4,780,005 lekë.

**Duke qenë se në VKM e sipërcituara përcaktohet qartë se shpenzimet e shpronësimeve kryhen nga shoqëria D. H., si dhe nga konstatimet që në dokumentet justifikuese nuk janë paraqitur fatura ose dokumente për shpenzimet sociale dhe ambjentaliste, vlera 384,942 Euro përbën shpenzime jo të justifikuara për Buxhetin e Shtetit.**

-Në kërkesën e bërë për rimbursime të shpenzimeve të kryera në periudhën janar – qershor 2015, u konstatua zëri kosto supervizimi dhe menaxhimi për rrugën Banjë Gramsh, sektorët 3A dhe 3 B, dhe ura e Trashovicës, me një total prej 631,330 Euro. Pagesa është kryer për 15 specialistë, që renditen nga specialistë të kualifikuar, ekspertë, në punonjës të huaj të rajonit si dhe në punonjës të huaj ndërkombëtarë. Për të parët pagesa orare është 25 euro, ekspertët 40 euro, më pas 100 euro dhe për punonjësit e huaj 250 euro në orë. Në total janë një punonjës i huaj ndërkombëtar i cili ka punuar 821 orë dhe ka marrë 205,250 euro, tre punonjës të huaj të rajonit të cilët kanë punuar 2175 orë dhe janë paguar 217,500 euro.

Për sa më sipër në dokumentet justifikuese nuk janë paraqitur proceset e punës të kryera, kualifikimet dhe licencat që vërtetojnë se ishin të aftë për të kryer punët e kërkuara, llogaritjet e orëve së punës për person bazuar në pagën përkatëse dhe shpenzimet e përgjithshme administrative të dokumentuara nga analizat e kostove të shpenzimeve të përgjithshme administrative.

Për sa më sipër është në kundërshtim me aneksin V të Kontratës së Koncesionit (e ndryshuar me Shtesën e 3-të të Kontratës së Koncesionit), ku janë caktuar dokumentet që duhet ti paraqiten Autoritetit Kontraktues për Kostot e Infrastrukturës Zëvendësuese të kryera, pika 8 ku citohet: *"Dokumentacion nga Shoqëria e Projektit për kostot e veta në lidhje shpenzimet për mbikëqyrje/menaxhim të kontratave. Këtu përshihen dietat dhe shpenzimet e lidhura me kryerjen e punës dhe kostoja për ore pune e personelit e dokumentuar nga përshkrimi i punës i punëmarrësit. Kosto e orës së punës për person do llogaritet bazuar në pagën përkatëse dhe shpenzimet e përgjithshme administrative të dokumentuara nga analizat e kostove të shpenzimeve të përgjithshme administrative."*

**Vlera prej 631,330 Euro përbën shpenzime jo të justifikuara për Buxhetin e Shtetit.**

-Kostot e projektimit dhe të mbikëqyrjes së punimeve për rrugën M15 Moglicë nuk janë llogaritur në përputhje me, tarifatat e përcaktuara në VKM nr. 444, datë 05.09.1994 "Për tarifatat e studimit, drejtimit mbikëqyrjes dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit" dhe VKM nr. 704, datë 29.10.2014 Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".



Këto VKM rregullojnë, llogaritjen e pagesave për të gjitha shërbimet që kryhen brenda vendit për projektimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin. Konkretisht tarifa mbikëqyrjes është llogaritur shumë më e lartë se përcaktimet e VKM nr.704, datë 29.10.2014, e cila sipas kësaj VKM duhet të ishte në vlerën 44,043.4 Euro, ose rreth 0.66 % të vlerës së ndërtimit, që është 6,607,360 Euro. Theksojmë se, shpërblimi i punës projektuese dhe i punës mbikëqyrëse para vitit 2015 rregullohej, me VKM nr. 444, datë 05.09.1994, dhe më pas me VKM nr. 704, datë 29.10.2014. Këto vendime nuk kanë të bëjnë me prokurimin publik dhe nuk kanë dalë në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij apo të ndonjë akt ligjor dhe nënligjor që mund të përcaktoj rregullat të tjera e prokurimit publik, të cilat sipas pikës 3.1, të shtesës së kontratës së koncesionit të miratuar me ligjin nr. 7, datë 15.02.2015, të cilat nuk zbatohen nga Koncesionari në procesin e tenderimit të projektimit, ndërtimit, mbikëqyrjes ose shërbime të tjera ndihmëse në lidhje me Infrastrukturën Zëvendësuese. Por, këto VKM, kanë dale në zbatim të akteve ligjore që rregullojnë veprimtarinë e kontrollit dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit brenda vendit, konkretisht kanë dalë në zbatim të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit".

Pra vlerat e kontratave të projektimit dhe të kontratave të mbikëqyrjes të financuara me fonde buxhetore do të llogariten sipas tarifave të përcaktuara në këto akte ligjore e nënligjore dhe mbi bazën e këtyre vlerave do të vijohet me përzgjedhjen e projektuesit dhe mbikëqyrësit nëpërmjet procedurave të tenderimit të realizuara sipas rregullave të vetë koncesionarit të përcaktuar në neni 3.1 të sipërcituar. Për këtë procedurë konkurrimi, përveç dokumenteve financiar dhe kontratës së lidhur mbas miratimit të shtesës 3 të kontratës së koncesionit, në MEI nuk janë paraqitur, dokumente e procedurës së përzgjedhjes së kontraktorëve fitues për hartimin e projektit të zbatimit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes si dhe shkresat apo dokumente të DHP që i ka kërkuar MEI të konfirmoi dhe miratoi procedurat e konkurrimit dhe vlerave të ofertave përpara se ato të shpallen fitues.

-Sipas projektit dhe preventivit të zbatimit të hartuar nga projektuesi "I. &S.", rruga "Banjë-Gramsh dhe Ura e Trashovicës" kishte kosto ndërtimi 30,196,554 Euro. Kjo kosto (fondi limit) është llogaritur nga D.H. kryesisht në bazë të çmimet të tregut vendas në zbatimit manualit teknik te çmimeve të vitit 2014 të miratuara në VKM përkatëse. Ndërtimi i kësaj rruge është ndarë në dy kontrata (seksione), seksioni 3A "Banja pjesa lindore e luginës së Holtës me kosto 23,702,604 Euro dhe seksioni 3B "pjesa lindore e luginës së Holtës-Gramsh plus Urën e Trashovicës" me kosto 6,493,950 Euro. Rruga është parashikuar të ndërtohet e gjerë 7 m dhe me gjatësi 15.234 km (me dy korsi të asfaltuara me gjerësi 2x2.5 m = 5m plus dy bankina anësore të asfaltuara me gjerësi 1 m dhe me gjatësi urash 2.26 km me gjerësi 8.65 m). Projekti dhe preventivi i zbatimit me vlerë ndërtimore 30,196,554 Euro dhe është miratuar nga ARRSH me Vendimin e Këshillit Teknik nr.66, datë 10.12.2014. Në vijim nga D.H. është realizuar procedura e tenderimit për përzgjedhjen e kontratave fituese për ndërtimin e rrugës zëvendësuese Banjë -Gramsh dhe urës së Trashovicës:  
-Fitues e procedurës së konkurrimit për ndërtimin e seksioni 3A rruga Banjë-Gramsh është shoqëria "A.. D.H. në datën 16.12.2014 ka lidhur kontratën e sipërmarrjes me këtë shoqëri me vlerë 25,365,321.4 Euro, pa TVSH. -Fitues e procedurës së konkurrimit për ndërtimin e seksioni 3B, rruga Banjë-Gramsh përfshi edhe urën e Trashovicës është shoqëria "E". D.H. në datën 16.12.2014 ka lidhur kontratën e sipërmarrjes me vlerë 7,346,881.5 Euro, pa TVSH. Kosto e dy kontratave fituese që do të zbatohen për të gjithë rrugën Banjë-Gramsh është 32,712,202.4 Euro. Kjo kosto është më e madhe për 2,515,648 Euro se, kosto e llogaritur nga projektuesi, para zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe e miratuar nga ARSH që është në shumën 30,196,554

Euro, dhe justifikohet: "Bazuar në nenin 3.5 të draft shtesën 3 të marrëveshjes (e pa miratuar me ligj), D.H. me shkresën nr. 01579, datë 11. 12. 2014 i është Drejtuar Ministrit dhe Zv. Ministrit të MEI, për të miratuar koston e kontratave të negociuara të rrugës Zëvendësuese Banje-Gramsh dhe Ura e Raskovicës.

Dokumentacioni i procedurës së tenderimit të realizuar nga D.H. duke filluar, me dokumentet e tenderi, ftesat për ofertë, ofertat teknike dhe ofertat ekonomike të kompanive si dhe çdo dokument tjetër që lidhet me procesin e prokurimit dhe të miratimit të koston, nuk u vu në dispozicion të auditimit.

Ky dokumentacion është mbajtur nga vetë D.H. dhe nuk është përcjell në MEI për tu inventarizuar dhe arkivuar në Ministri. Me gjithë insistimin tonë të herëpashershëm që me fillimin e auditimit nëpërmjet kërkesave shkresore, e-mail, apo kërkesave verbale, drejtuar MEI dhe D.H. përsëri ky dokumentacion nuk na u vunë në dispozicion.

**Në këto kushte, nuk u krye auditim, mbi ligjshmërinë e shqyrtimit, vlerësimit, kualifikimit, s' kualifikimit të ofertave teknike dhe ofertave ekonomike të shoqërive pjesëmarrëse në këto procedura tenderimi për përzgjedhjen e kontratave fituese.**

Mos vënia në dispozicion të auditimit të dokumentacionit të tenderimit bien në kundërshtim me: Nenin 3.5 të shtesës nr.3 të kontratës së koncesionit të miratuar me ligjin nr. 7, datë 15.02.2015 - Nenin 15 dhe 26, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit".

Si konkluzion: fillimisht kosto e kësaj rruge sipas projektit të zbatimit ishte parashikuar për 30.196,554 Euro, në përfundim të procedurës tenderuese kontratat fituese u negociuan dhe u rritën në vlerën 32,7712,202 Euro dhe gjatë zbatimit të punimeve u rritën përsëri në vlerën 36,236,836, ose 20% më shumë se kosto së parashikuar në projektin e zbatimit (fondi limit) .

-Në vlerën e investimit të kësaj rruge përveç vlerës së ndërtimit, shoqëria D.H. ka përfshirë edhe, punën projektuese në vlerën 2,063,264 Euro, punën mbikëqyrëse në vlerën 3,291,766 studime gjeologjike në vlerën 267,169 Euro dhe disa kosto të tjera shtesë në vlerën 1,111,175 Euro (sociale, tarifa publike, sigurimi, etj.), dhe kosto totale e investimit të kësaj rruge për tu financuar nga buxheti i shtetit është 42,970,210 Euro, Mirëpo, për këtë rrugë me gjatësi totale 5.234 km, kosto fillestare përpara marrjes së ofertave të tenderit, sipas shtesës 3 të kontratës të miratuar me ligjin nr. 7, datë 15.02.2015 ishin parashikuar në shumën 38,142,457 Euro, përfshirë projektimin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen dhe kostove të tjera. Siç tregohet, kosto e përcaktuar në ligj vetëm për këtë rrugë është tejkaluar me 4,827,753 Euro më shumë. Kjo rritje ka të bëjë me rritjen e vlerës së punës projektuese, punës mbikëqyrëse dhe studimeve gjeologjike, tarifat e të cilave janë përcaktuar më të larta se, tarifat e tregut vendas, të përcaktuara në VKM nr. 444, datë 05.09.1994 "Për tarifat e studimit, drejtimit mbikëqyrjes dhe kolaudit të veprave të ndërtimit" dhe VKM nr. 704, datë 29.10.2014. Konkretisht: -Llogaritja e koston së punës projektuese (tarifa e projektimit) dhe studimit gjeologjik: Sipas projektit dhe preventivit të zbatimit të hartuar nga shoqëria projektuese "I. & S." në vitin 2013, vlera e investimit e llogaritur me çmimet e tregut vendas në zbatimit të manualit teknik të çmimeve të vitit 2014 të miratuara me VKM për ndërtimin e rrugës ka dale 30,196,554 Euro, dhe në përfundim të punimeve, kosto e ndërtimit është rritur në vlerën 36,236,836 Euro. Mbështetur në këtë vlerë dhe bazuar në VKM nr. 444, datë 05.09.1994, për këtë kategori rruge, tarifa e projektimit të llogaritur duhet të ishte në vlerën 722,265 Euro (36,236,836Euro x 2%) dhe tarifa e studimit gjeologjik duhet të ishte në vlerë 51,660 Euro (

36,236,836 Euro x 0.14%) në total duhet të ishin 774,285 Euro. Ndërsa puna projektuese është parashikuar për tu financuar nga buxheti i shtetit në vlerën 2,063,264 Euro dhe studimi gjeologjik në vlerën 267,169 Euro, në total në vlerën 2,330,433 Euro ose 6.43% të vlerës së ndërtimi.

**Pra në kundërshtim me VKM nr. 444, datë 05.09.1994, kosto e punës projektuese dhe e studimit gjeologjik është rritur padrejtësisht për vlerën 1,556,148 Euro (2,330,433 Euro - 774,285 Euro).**

Gjithashtu D.H. ka lidhur kontratë me shoqërinë projektuese "I. & S." në vitin 2013, në kushtet kur kjo shoqëri nuk kishte por dhe më vonë nuk ka pasur asnjë license për projektim.

### **Vlera 1,556,148 Euro përbën efekt ekonomik negativ për Buxhetin e Shtetit.**

-Nga ana e shoqërisë D. H. sh.a. janë dërguar në KLSH observacione në lidhje me projekt raportin, sipas një shkresë të administruar në MIE me email nga administratori i shoqërisë, datë 18.12.2022.

**Pretendimi i subjektit:** *"Kostot e shpronësimit dhe kosto mjedisore-sociale janë kosto të njohura dhe të pranuar për rimbursim në Shtesën e Tretë të Kontratës së Koncesionit, Shtojca I, përkatësisht në buxhetin e vlerësuar fillimisht janë kategorizuar si ""A. Kosto qe lidhen me pronat"" vlerësuar fillimisht në masën 730,600 Euro, me nenkategorite ""A1. Kosto per Shpronësimin e Tokes"" dhe ""A2. Kosto Mjedisore dhe Sociale"".*

*Kostot fillestare të parashikuara për shpronësim dhe kosto mjedisore-sociale kanë qenë në vlerën rreth 1% të vlerës së zbatimit të punimeve për secilin nenkategori.*

*Kostot e shpronësimit dhe kosto mjedisore-sociale janë pjesë integrale për ""planifikimin, projektimin, tenderimin dhe ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese"" në kuptimin e nenit 7.2.7.3 të Shtesës së Tretë të Koncesionit dhe nuk mund të vlerësohen si të ndara prej saj.*

*Këto kosto janë në përputhje edhe me kushtet e kontratës mes Autoritetit Kontraktues, ARRSH dhe Koncesionarit datë 14.02.2014, preambula pika G "Per shmangien e cdo dyshimi, ndërtimi i Infstrukturës Zëvendësuese përfshin edhe procesin e tenderimit dhe kualifikimin/perzgjedhjen e kompanisë zbatuese dhe mbikeqyrjen e punimeve dhe cdo proces tjetër të lidhur me të deri në përfundimin dhe dorëzimin e punimeve".*

*Koncesionari në kërkesat për rimbursim ka përcjellë edhe vlerësimin e kostove të shpronësimit dhe kostot mjedisore-sociale dhe ato ka qenë në brendësi të parashikimeve, madje edhe ndjeshëm më të ulëta se vlerësimi fillestar.*

*Dokumentacioni i përcjellë për këto kosto ka qenë në përputhje me parashikimet e Shtojcës 5 të Shtesës së Tretë të Koncesionit.*

*Koncesionari, pas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, ka përcjellë shpjegime dhe dokumentacion shtesë rreth kësaj çështjeje me anë të shkresës së Koncesionarit drejtuar Autoritetit Kontraktues datë 05.10.2022 me nr. prot. 2022-TR-00330, ref. Shtojca C, Nën -Shtojca C2, C3, C4*

*Vlera prej 384,942 Euro përben kosto të pranuar për rimbursim nga Autoriteti Kontraktues sipas parashikimeve ligjore dhe është shpenzim i justifikuar për Buxhetin e Shtetit."*

*-Kostot e menaxhim - supervizimit janë kosto të njohura dhe të pranuar në Shtesën e Tretë të Kontratës së Koncesionit, Shtojca I, në kategorinë "C. SHERBIME INXHINIERIKE".*

*Kostot e menaxhim-supervizimit janë pjesë integrale për "planifikimin, projektimin, tenderimin dhe ndërtimin e Infrastrukturës Zëvendësuese" në kuptimin e nenit 7.2.7.3 të Shtesës së Tretë të Koncesionit dhe nuk mund të vlerësohen si të ndara prej saj.*

*Keto kosto jane te perputhje edhe me kushtet e kontrates mes Autoritetit Kontraktues, ARRSH dhe Koncesionarit date 14.02.2014, preambula pika G "Per shmangien e cdo dyshimi, ndertimi i Infarstrukures Zevendesuese perfshin edhe procesin e tenderimit dhe kualifikimin/perzgjedhjen e kompanise zbatuese dhe mbikeqyrjen e punimeve dhe cdo proces tjetër te lidhur me te deri ne perfundimin dhe dorezimin e punimeve"*

*Koncesionari ne kerkesat per rimbursim ka percjelle edhe vleresimin e kostove te sherbimeve inxhinierike (menaxhim & supervizim).*

*Autoriteti Kontraktues eshte informuar rregullisht nga Koncesionari rreth ketyre kostove dhe dokumentacioni i percjelle per keto kosto ka qene vleresuar si ne perputhje me parashikimet e Shtojces 5 te Shteses se Trete te Koncesionit: "Dokumentacion nga Shoqeria e Projektit per kostot e veta ne lidhje me shpenzimet per mbikeqyrje / manaxhim te kontratave. Ketu perfshihen dietat dhe shpenzimet e lidhura me kryerjen e punes dhe kostove per ore pune e personelit e dokumentuar nga pershkrimi i punes se punemarresit. Kosto e ores se punes per person do te llogaritet bazuar ne pagen perkatese dhe shpenzimet e pergjithshme administrative te dokumentuara nga analizat e kostove te shpenzimeve te pergjithshme administrative."*

*Autoriteti Kontraktues ka qene informuar rreth menyres se llogaritjeve te kostove perkatese perpara miratimit dhe pageses se rimbursimit te ketyre kostove me te njejtin informacion qe eshte percjelle nga Koncesionari me ane të shkresës së D.H. drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë datë 05.10.2022 me nr. prot. 2022-TR-00330, ref. Shtojca C, Nën -Shtojca C3.*

*Koncesionari ka percjelle dokumentacion rreth kostove për ore pune të personelit si edhe përshkrimet përkatëse të punës së punëmarresve.*

*Vlera prej 631,330 Euro përbën kosto të pranuar për rimbursim nga Autoriteti Kontraktues sipas parashikimeve ligjore dhe është shpenzim i justifikuar per Buxhetin e Shtetit.*

#### **Qëndrimi i Audituesve shtetërorë të KLSH**

Pretendimet Tuaja mbi këtë pikë nuk merren në konsideratë pasi ato janë të një natyre të përgjithshme dhe nuk i përmbahen konstatimeve. Gjithashtu Grupit të Auditimit nuk u janë përcjellë dokumente shtesë lidhur me sa më sipër që të justifikojnë shpenzimet e kryera. Observacioni nuk merret në konsideratë.

*Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:*

### **IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET**

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Në auditimin e kontratës përfundimtare të koncesionit lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Koncesionarit, të aprovuar me ligjin nr. 7/2015, datë 12.02.2015, dhe me ligjet e mëparshme u konstatua se janë kryer ndryshime të rëndësishme thelbësore nga kushtet e përcaktuara në dokumentet e procedurës së koncesionit për përzgjedhjen e operatorit ekonomik fitues si vijon:

-Në pjesën e kushteve të kontratës, në formularin e deklaramit të ofertës, ofertuesi konfirmon pajtimin e tij për të firmosur kontratën sipas formularit të Kushteve të Kontratës, nëse shpallet fitues. Në seksionin e Kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës Koncesionare përcaktohet se: A. Terma të Përgjithshme të MK, C. Të drejtat dhe detyrimet e palëve,

koncesionari duhet të marrë masa të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet, që eventualisht mund t'i shkaktohen palëve të treta. E. 20. Çështjet e panegociueshme, - Akses të plotë të Autoritetit Kontraktues dhe ERE në regjistrat e punës së Koncesionarit. -Detyrimi i Koncesionarit dhe shoqërisë së projektit për të paguar taksat, detyrimet dhe taksat e tjera sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë. –Pagesa e të drejtës koncesionare do të jetë në % fituese kWh, jo më pak se 2% të vleftës absolute të prodhimit të energjisë elektrike. –detyrimi i koncesionarit për të përmbushur kërkesat e Autoritetit Kontraktues ose ERE për tu përshtatur me detyrimet e shërbimit publik. F. Zbatimi dhe interpretimi i kësaj kontrate koncesioni do të bazohet në legjislacionin shqiptar në fuqi dhe çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë kontratë do të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Më pas në shtesat e kontratave kushtet fillestare kanë ndryshuar duke e kaluar riskun te Autoriteti Kontraktues.

-Pagesa e detyrimeve fiskale sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, në kontratë është ndryshuar duke e përjashtuar koncesionarin nga tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH), për mallrat e importit dhe ato brenda vendit si dhe të gjitha ndryshimet në taksa gjatë viteve.

-Gjykimi i mosmarrëveshjeve mes palëve është akorduar për tu zgjidhur në Gjykatën e Arbitrazhit. Ndryshimi i kushteve thelbësore të kontratës ka sjellë shkeljen e barazisë në procedurën e përzgjedhjes së koncesionarit, veprime në kundërshtim me nenin nr.1., të Ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006, i ndryshuar, “Për koncesionet”, ku citohet: *Qëllimi i këtij ligji është të krijojë kuadrin e nevojshëm për nxitjen dhe lehtësimin e zbatimit të projekteve koncesionare, të financuara nga sektori privat, duke rritur transparencën, barazinë, efikasitetin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë në zhvillimin e projekteve të infrastrukturës dhe të shërbimeve publike. Ai synon zhvillimin e mëtejshëm të parimeve të përgjithshme në lidhjen e kontratave nga autoritetet publike, nëpërmjet përcaktimit të procedurave të veçanta për dhënien e projekteve koncesionar, dhe me nenin nr. 21., Caktimi i ofertuesit më të mirë dhe negociimet përfundimtar, pika 2, ku citohet: “**Kushtet kontraktuale, të deklaruara të panegociueshme në kërkesën përfundimtare për propozime, nuk do të jenë objekt i negociimeve përfundimtare.**” Trajtuar më hollësisht në Pikën 1, faqe 23 të Projektraportit të Auditimit.*

**1.1.Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në të ardhmen në procesin e finalizimit të kontratave me operatorët fitues, të mos ndryshojë termat e përgjithshme dhe të veçanta të procedurave të përzgjedhjes së ofertuesve pasi sjell shkeljen e barazisë në procedurën e përzgjedhjes së koncesionarit, dhe uljen e transparencës, barazisë, efikasitetit dhe qëndrueshmërinë afatgjatë në zhvillimin e projekteve të infrastrukturës dhe të shërbimeve publike.

*Në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Në Masterplanin e vitit 2003-2015, “Për zhvillimin e sektorit të gjenerimit të energjisë elektrike” është përcaktuar se për të përballuar nevojat shtesë Elektroenergjitike dhe për të reduktuar nivelin shumë të lartë të importit, parashikohet të ndërtohen HEC-e, që do të rrisin sigurinë e furnizimit me energji elektrike në të gjithë vendin.

Nga shqyrtimi i kushteve fillestare të procedurës së përzgjedhjes së koncesionarit dhe deri në ndryshimet përfundimtare të kontratës lidhur me operatorin ekonomik fitues u konstatua se ky objektivi nuk është përcaktuar qartë dhe me terma të matshëm në kushtet kontraktuale.

Në seksionin e Kushteve të Përgjithshme dhe të Veçanta të Kontratës Koncesionare, të dokumenteve të procedurës së koncesionit, përcaktohet se: A. Terma të Përgjithshme të MK, 7. **Koncesionari është i interesuar të investojë në ndërtimin e hidrocentraleve me qëllimin e prodhimit të energjisë elektrike dhe rritjen e sigurisë të furnizimit me energji elektrike të gjithë vendit. 11. Shërbimi Publik, Marrëveshja Koncesionare bazohet në Ligjin për Koncesionet dhe**

***pavarësisht Autoriteti Kontraktues ose ERE mund ti kërkojnë Koncesionarit të përmbushë disa detyrime të shërbimit publik në furnizimin me energji elektrike.***

- Në kontratë është përcaktuar se koncesionari mund ta shesë energjinë elektrike në eksport pa asnjë kufizim. Ky përcaktim ka devijuar objektivin kryesor që ishte rritja e kapaciteteve energjetike në vend, sepse koncesionari pasi ka filluar prodhimin e energjisë ka vënë në dispozicion sasi të vogla energjie brenda vendit. Termat e përgjithshme të Marrëveshjes Koncesionare nuk janë reflektuar në detyrime specifike për sasinë e energjisë elektrike për furnizim brenda vendit, të përcaktuara në sasi e vlera për tu bërë të detyrueshme për tu zbatuar gjatë zbatimit.

Arsyetimet e bëra nga Autoriteti Kontraktor se duhet të zbatonin modelin e ri të tregut, nuk qëndrojnë pasi shumë vende të BE, në koncesione të ngjashme kanë vendosur kushte që detyronin koncesionarët të furnizojnë sasi dhe çmime të ulëta për komunitetin. I tillë është shembulli i Norvegjisë ku koncesionarët janë të detyruar të lëvrojnë 10 % të energjisë së prodhuar tek autoritetet lokale ku ndodhet baseni ujqor, me kosto të ulët ose me kosto prodhimi.

Mos reflektimi i detyrimeve për furnizimin me energji elektrike brenda vendit në kontratën përfundimtare ka sjellë dhe devijimin e qëllimit kryesor të koncesionit, që ishte rritja e kapaciteteve furnizuese me energji elektrike brenda vendit.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me nenin nr.27., të Ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006, i ndryshuar, “Për koncesionet”, pika a, ku citohet: “*Kontratat e koncesionit parashikojnë ato çështje që vlerësohen të përshtatshme nga palët, të tilla si: a) natyra dhe objekti i punëve që duhet të kryhen dhe shërbimet që duhet të jepen nga koncesionari;*”. (Trajtuar më hollësisht në Pikën 1, faqe 23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

**2.1.Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në të ardhmen në procesin e realizimit të koncesioneve dhe finalizimit të kontratave me operatorët fitues të përcaktohen qartë, saktë dhe me parametra të matshëm objektivat kryesorë të koncesionit.

*Në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se në pikën 6. b, të dokumenteve të procedurës së koncesionit, respektimi optimal i aspekteve ekologjike dhe mjedisore, sigurimi i rrjedhës minimale në shtratin natyral të lumit, i vlerësuar me 5 pikë, ku citohet se projekti duhet të sigurojë një rrjedhje të vazhdueshme në të gjithë shtratin natyral të lumit, në masën jo më pak se 15 % të prurjeve natyrale, për të garantuar zhvillimin e florës dhe faunës në këtë lumë u konstatua se këto kërkesa nuk ishin përcaktuar qartë e saktë në kontratat e lidhura me operatorin fitues.

Kërkesës së dërguar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës për dhënie mendimi në lidhje me koncesionin, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, i ka dhënë përgjigje me shkresën nr. 110 Prot., datë 11.01.2009.

-Duke qenë se lumi Devoll në pjesë të veçanta të rrjedhës së tij shërben edhe si burim ujor për ujitje, ka kërkuar që në kontratën e koncesionit ndërmjet autoritetit kontraktues dhe koncesionarit, të përcaktohen qartë nevojat për ujë për ujitje, që ka bujqësia gjatë periudhës së ujitjes (periudha Maj-Gusht), kjo për faktin se me ujërat e lumit Devoll është e lidhur ujitja e rreth 70 000 ha tokë bujqësore dhe në funksion të kësaj janë bërë investime të konsiderueshme në rehabilitimin e infrastrukturës së ujitjes në mjaft zona të vendit. Për bujqësinë nga hidrocentrali i Banjës duhet të merren rreth 150 milion m<sup>3</sup> ujë nga rrjeti i poshtëm që shfrytëzohen me rrjedhje të lirë dhe konkretisht:

-Nëpërmjet digës së Vlashukut dhe rezervuarit të Thanës dhe rrjetit ekzistues ujitës merren nga lumi Devoll rreth 100 milion m<sup>3</sup> ujë në periudhën Mars-Shtator për mbushjen e rezervuarit të

Thanës nëpërmjet të cilit realizohet ujitja e rreth 40 000 ha tokë bujqësore në rrethet e Lushnjës dhe të Fierit;

-Nëpërmjet kanalit lidhës Banjë-Shkumbin duke u kombinuar me rrjetin ekzistues të kanalit Peqin Kavajë (zona e poshtme e Dumresë dhe fushat e Cërrikut, Peqinit dhe Kavajës) shfrytëzohet rreth 40 milion m<sup>3</sup>; nëpërmjet digës së Vlashukut në rrethin e Kuçovës dhe Fierit shfrytëzohen rreth 10 milion m<sup>3</sup> ujë;

Bujqësisë në basenin e Devollit, nevojat për ujë për ujitje nga lumi Devoll, gjatë sezonit arrijnë në rreth 150 milion m<sup>3</sup> ujë.

Në këto kushte kërkesa duhej marrë në konsideratë pasi plotësimi i nevojave për ujë për ujitje nga lumi Devoll është i domosdoshëm për zhvillimin e bujqësisë në zonat fushore të Lushnjës, Fierit, Kavajës, Elbasanit, Beratit e Korçës.

**-Kërkesa e Ministrisë së MBUMK, për përcaktim të saktë për ujin për vaditje si dhe parametrat e projektit fillestar për sigurimin e rrjedhës së vazhdueshme të ujit gjatë gjithë vitit për sigurimin e florës dhe faunës së lumit, nuk janë pasqyruar në kontratën përfundimtare mes palëve.**

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me Dokumentet e Procedurës së Koncesionit, pjesa “Nënshkrimi i kontratës, kushtet”, ku citohet: “*Autoriteti Kontraktues do të firmosë me atë ofertues, oferta e të cilit është përzgjedhur si oferta më e mirë. Drafti i kontratës përfshihet si pjesë e këtij dokumentacioni dhe ofertuesi duhet të plotësojë formularin me të dhënat dhe detajet e tij, që gjenden në Ofertë. (Trajtuar më hollësisht në Pikën 1, faqe 23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)*

**3.1.Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në të ardhmen në procesin e realizimit të koncesioneve dhe finalizimit të kontratave me operatorët fitues të përcaktohen qartë, saktë dhe me parametra të matshëm objektivat kryesorë të koncesionit.

*Në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit teknik sipas kontratës së punimeve civile “Rikonstrukcion i segmentit 3B, Drizë-Gramsh”, në shumë zëra punimesh (ditë pune) si pastrim tombino, problematika nga shpronësimet, dhera të rëna nga reshjet etj., janë raportuar punime nga mekanizmat të rëndë gjermimi, ndërkohë që këto punime mund të realizohen nga mekanizma më të lehtë siç janë ekskavatorët 0.65 m<sup>3</sup>, duke rritur në këtë mënyrë koston e punimeve.

-Nga auditimi rezulton se sipas zërit 2.c.02 “Gërmim në material dherash”, ishte parashikuar volumi në sasinë 434550 m<sup>3</sup>, i cili është certifikuar në sasinë 228067.5 m<sup>3</sup>, me çmim 2.7 Euro/m<sup>3</sup>. Po ashtu, sipas zërit 2.c.03 “Gërmim në material shkëmbor”, ishte parashikuar sasia 6636 m<sup>3</sup> dhe është certifikuar sasia 264964 m<sup>3</sup>, me çmim 6 Euro/m<sup>3</sup>. Ky ndryshim është bërë me argumentimin e ndryshimit të gjendjes së parashikuar me atë të rezultuar faktike. Vlera e punimeve të gjermimit si më sipër është rritur në shumën rreth 900 mijë Euro. Sa më sipër kemi të bëjmë me mangësi gjatë procesit të projektimit të rrugës. Nga ana e kontraktorit dhe mbikëqyrësit të punimeve nuk është përcaktuar fortësia e formacionit të tokës në seksionet përkatëse të gjermimit, për klasifikimin e mundshëm si zë të ri punimi, i cili do të kishte çmim tjetër nga ai i referuar, si dhe nuk është përcaktuar metoda e gjermimit e nevojitur, apo njëtrajtshmëria e formacionit, veprim në kundërshtim me specifikimet teknike Pika 2.03.2.3 “Gërmim në seksion rruge në shkëmb”.

Janë certifikuar punime sipas zërit 4.f. 05 “Reinforced concrete pipe culvert, 500 mm (half pipe)”, në sasinë 3411 ml, me çmim 22 Euro/ml. Nga verifikimi i punimeve të realizuara nuk rezultojnë punime me specifikime të tilla. Kanalet mbrojtëse nga ujërat, janë ndërruar me beton të derdhur

në vend, me seksion trapezoidal. Ky veprim është në kundërshtim me specifikimet teknike, Pika 6.08.3, si dhe Kontratën F., pika 7.01.a. (*Trajtuar më hollësisht në Pikën 2, faqe 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*)

**4.1. Rekomandimi:** Njësia e Zbatimit të Projektit, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të marrin masa për analizimin dhe përcaktimin e fortësisë së formacionit të gërmuar, për përcaktimin e saktë të kategorisë dhe çmimit përkatës për këtë zë punimi.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**4.2. Rekomandimi:** Të merren masa për analizimin e çmimit të kanalizimeve të realizuara me beton monolit në raport me kanalizimin e parashikuar me tombino beton arme 500 mm (gjysmë tombino), duke bërë zbritjen e çmimit përkatës.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kryer në terren lidhur me punimet e kryera për ndërtimin e digave dhe përkatësisht për ndërtimin e digës së Moglicës, rezultoi se shtresa e asfaltit mbi digë ose sipërfaqja e rrugës ka pësuar një rënie e cila është e dukshme në pamje vizuale dhe lë vend për dyshime të arsyeshme të dëmtimit të kurorës së digës.

Thellësia e këtij dëmtimi nuk mund të verifikohet nga grupi i auditimit për vet faktin se kërkon një analizë dhe teste teknike nga specialistë të fushës për të saktësuar nëse dëmtimi i shtresës së asfaltit mbi digë është dëmtim sipërfaqësor apo është më serioz se kaq me qëllim parandalimin e përkeqësimit të situatës. Për sa më sipër është në kundërshtim ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar. (*Trajtuar më hollësisht në Pikën 2, faqe 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*)

**5.1. Rekomandimi:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të marrë masat që të njoftojë Koncesionarin “D. H.” SH.A, duke e vënë në dijeni për dëmtimet e konstatuara vizualisht nga grupi i auditimit dhe në të njëjtën kohë duke i kërkuar kryerjen e një analize profesionale teknike me specialistë të fushës përkatëse me qëllim verifikimin e shkallës së dëmtimit të kurorës së digës së Moglicës dhe marrjen e masave të menjëhershme për rehabilitimin e situatës në varësi të seriozitetit të dëmtimit për shmangien e cdo të papriture në të ardhmen që mund të sjellë pasoja të rënda për investimin e kryer por edhe për zonën përreth.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të zbatimit të punimeve të kontratës së lidhur midis D. H. SHA dhe “A.” SHPK, me datë 07.07.2016 dhe vlerë 6,328,080.85 Euro, u konstatuan dëmtime të rrugës përsa i përket lotit M03. Konkretisht, në kilometrin e 7-të deri 7.6, rruga ka rrëshqitje dhe çarje të asfaltit në pjesën e djathtë të saj. Në vazhdim në kilometrin e 8-të deri 8.5, rruga ka rrëshqitje dhe dëmtim të bordurave mbajtëse në krahun e djathtë të saj. Në kilometrin e 10-të deri 14, rruga ka dëmtime të vazhdueshme dhe rrëshqitje të terrenit. Gjithashtu në këtë pjesë të aksit, janë dëmtuar reflektorët anësorë. Defektet e mësipërme, përbëjnë rrezik aksidentesh për përdoruesit e rrugës, gjithashtu rritje të kostos për ndërhyrje, nëse nuk merren masa të shpejta për ndërhyrjen për riparim të tyre. Dëmtimet e sinjalistikës vertikale (reflektorë) nga individë të pa identifikuar krijojnë vështirësi në qarkullimin e automjeteve, kryesisht gjatë natës. Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar. (*Trajtuar më hollësisht në Pikën 2, faqe 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*)



**6.1 Rekomandimi:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të marrë masat që të njoftojë ARRSH për dëmtimet e konstatuara nga grupi i auditimit, me qëllim riparimin e tyre për shmangien e avancimit të shkallës së dëmtimit dhe largimin e rrezikut për aksidente të mundshme në këtë segment.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit nga AKBN, lidhur me raportet e monitorimit të Konkensionit të mbajtura nga AKBN, u evidentua se raporti i fundit i monitorimit të HECEVE, është mbajtur në 3-Mujorin e III dhe të IV të vitit 2020 dhe është dërguar në MIE me shkresën me nr. 4598/1 Prot., datë 22.08.2020. Nga raportet e mbajtura nga AKBN, cilësohen mangësi në dokumentacionin e dorëzuar nga Konkensionari në kundërshtim me VKM nr. 547, datë 09.08.2006 i azhurnuar “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”, të cilat kanë të bëjnë me njoftimet për fillimin e punimeve të investimit, me njoftimin për përfundimin e punimeve, me mungesën e dokumentacionit që vërteton lejen e ndërtimit për fillimin e punimeve apo edhe mungesa të dokumentave të tjera të cilat janë të domosdoshme për të plotësuar dosjen e plotë të punimeve të kryera nga Konkensionari me qëllim që në fund të afatit të Konkensionit, Shteti Shqiptar të marrë në dorëzim cdo dokumentacion të domosdoshëm për vazhdimin e operimit të Hidrocentraleve të ndërtuara edhe pas largimit të konkensionarit. *(Trajtuar më hollësisht në Pikën 2, faqe 36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)*

**7.1. Rekomandimi:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me AKBN dhe institucione të tjera publike nëse është e nevojshme, të marrin masat për plotësimin e dosjes së Konkensionit me të gjitha dokumentet që mungojnë të cilësuar nga raportet e monitorimit të lëshuara nga AKBN.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**8. Gjetje nga auditimi:** Në pikën C., të marrëveshjes koncesionare pjesë e dokumenteve të procedurës koncesionare citohet: *“Të drejtat dhe detyrimet e palëve, koncesionari duhet të marrë masa të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet, që eventualisht mund t’i shkaktohen palëve të treta.”*

Më pas në shtesat e kontratave kushtet fillestare kanë ndryshuar duke e kaluar riskun te Autoriteti Kontraktues. -Në pikën 3.7, të shtesës së kontratës është përcaktuar se d) *Autoriteti Kontraktues do të jetë përgjegjës ndaj Konkensionarit për të gjitha kostot, dëmet dhe humbjet që lindin nga çfarëdo mospërfundim i Infrastrukturës Zëvendësuese në afatet e përcaktuara; e) Autoriteti Kontraktues do të mbajë të pacenuar dhe do të dëmshpërblejë Konkensionarin për të gjitha pretendimet, dëmet dhe humbjet që vijnë prej furnitorëve dhe kontraktorëve të tjerë ose çdo palë tjetër të tretë në lidhje me planifikimin, projektimin dhe tenderimin e Infrastrukturës Zëvendësuese ose lidhen me Infrastrukturën Zëvendësuese;*

**-Për sa më sipër duke u nisur nga fakti që Konkensionari do kryejë të gjithë procesin e planifikimit, projektimit dhe tenderimin e Infrastrukturës Zëvendësuese, nuk ka arsye justifikuese përse Autoriteti Kontraktues duhet të merrte përsipër risqet për dëmshpërblim për humbjet që mund të vinin nga furnitorët dhe kontraktorët ose çdo palë tjetër në proces.** Ndryshimi i kushteve të kontratës është në kundërshtim me nenin nr.2., të Ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006, i ndryshuar, “Për koncesionet”, pika 3, ku citohet: *“Koncesion” është marrëveshja,*

*pavarësisht nga emri që i jepet, ndërmjet autoritetit kontraktues dhe koncesionarit, ku përcaktohen kërkesat dhe kushtet e saj dhe në kuptimin e së cilës koncesionari: a) realizon një veprimtari ekonomike që, në të kundërt, do të kryhej nga autoriteti kontraktues për një projekt koncesioni, kontratë administrimi apo shërbime të tjera publike; b) merr përsipër të gjitha ose një pjesë thelbësore të rrezikut të lidhur me këtë veprimtari ekonomike;”*

Marrja përsipër e përgjegjësiave ndaj palëve të treta ku autoriteti kontraktor nuk ka asnjë lidhje kontraktuale rrit riskun e dëmeve ndaj Buxhetit të Shtetit. *(Trajtuar më hollësisht në Pikën 1 faqe 23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)*

**8.1 Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në të ardhmen në procesin e lidhjes së kontratave me operatorët fitues, të mos marrë përsipër rreziqet e lidhura me veprimtarinë ekonomike të cilat i takojnë koncesionarit për tu përballuar.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

## **B. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga Auditimi:** Me shkresën e shoqërisë D. H. sha., date 31.01.2015, nr. Prot. 2015-TR-00132 - për vitin 2014, dhe shkresën e D.H. date 02.03.2015, nr. Prot. 2015-TR-00349, është kërkuar rimbursimi i Kostove të Infrastrukturës Zëvendësuese për vitin kalendarik 2014, në përputhje me nenin 7.2.7.5, 7.2 7.7 të Shtojcës se 3-1 të Kontratës së Koncesionit. Shkresave i janë bashkëngjitur kostot e dokumentuara deri me 31 janar 2015 në vlerën 3,972,459 milion euro.

Për kërkesat sa më sipër Ministria e Energjetikës dhe Infrastrukturës ka kryer pagesën më datë 27.03.2015, në vlerën 332,604,347 lekë, (2,367,964.88 euro x 140,46 lek) dhe pagesën datë 08.04.2015 në vlerën 225,303,064 lekë (1,604,494,.12 euro x 140.42 lek).

Me urdhër shpenzimin nr. 78, datë 27.03.2015, për certifikatat 11-19, të paraqitura nga D.H., në vlerën 2,367,964,.88 Euro. Me urdhrin nr. 80, datë 25.03.2015, z. I. B., në cilësinë e zëvendësit të Ministrit, ka urdhëruar pagesën sa më sipër. Me urdhër shpenzimin nr. 100, datë 08.04.2015, MIE ka urdhëruar pagesën e 225,303,064 lekë për shpenzime të kryera nga D.H.. Për këtë pagesë është lëshuar dhe urdhri nr. 92 datë 02.04.2015, nga Ministri i përfaqësuar nga z. I. B., për shlyerjen e vlerës 1,604,494 Euro.

Pagesat e mësipërme i takojnë kontratave që ka lidhur D.H. me kontraktorë të tretë, për projekttime dhe punime në Infrastrukturën Zëvendësuese, në periudhën 2013-2014, kur shtesa e tretë e kontratës koncesionare e cila sqaronte kushtet në të cilat do të bëhej lidhja e kontratave është aprovuar në parlament në shkurt të 2015. Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës e përfaqësuar nga Zëvendësministri z. I. B., ka urdhëruar pagesat e mësipërme për shpenzime të paaprovuara nga Kuvendi i Shqipërisë, siç përcaktohet dhe në Ligjin për Koncesionet.

Në shtesën e tretë të Kontratës së Koncesionit, është përcaktuar se në nenin 1 të Kontratës së Koncesionit “Marrëveshja e Infrastrukturës Zëvendësuese” nënkupton marrëveshjen e lidhur më datë 14.2.2014 midis Autoritetit Kontraktues, Shoqërisë së Projektit dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar për projektimin, tenderimin e Infrastrukturës Zëvendësuese (rrugët dhe urat) dhe ndërtimin e Rrugës M15 të Infrastrukturës Zëvendësuese të Moglicës, bashkëngjitur si Aneksi III. Pra kjo marrëveshje është pjesë e Kontratës së Koncesionit dhe si e tillë aprovohet në Këshillin e Ministrave, siç përcaktohet në pikën 4 të Nenit 21, Caktimi i ofertuesit më të mirë dhe negociimet

përfundimtare, të ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006, i ndryshuar, ku citohet: *Pas përfundimit të negociimit për kontratën koncesionare, Njësia e Trajtimit të Koncesioneve, brenda 45 ditëve, jep mendim me shkrim për kushtet e kontratës. \*Pas marrjes së mendimit dhe nënshkrimit, kontratat koncesionare me vlerë investimi mbi 20 milion euro paraqiten për miratim në Këshillin e Ministrave. Kontratat koncesionare me vlerë nën 20 milion euro hyjnë në fuqi pas nënshkrimit nga autoriteti kontraktues.*

Me ligjin nr. 7/2015, miratuar më datë, 12.02.2015, “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 10 083”, datë 23.2.2009, i ndryshuar Këshilli i Ministrave ka miratuar dhe përmbajtjen e shtesës së tretë të kontratës së koncesionit. Në lidhje me procesin e projektimit dhe zbatimit të Infrastrukturës Zëvendësuese”, janë përcaktuar rregulla dhe procedura që do të ndiqen nga D.H., dhe do të monitorohen nga Autoriteti Kontraktor.

**Urdhër pagesat e mësipërme janë nxjerrë për të kryer likuidimin e shpenzimeve për të cilat nuk janë zbatuar procedurat përkatëse, si dhe monitorimi i tyre, pasi i përkasin periudhës 2013-2014, para se të aprovohej shtesa e tretë e kontratës nga Këshilli i Ministrave.**

Gjithashtu në shtesën e tretë të kontratës ishte parashikuar se Autoriteti Kontraktues do të monitorojë procedurën e tenderimit të Infrastrukturës Zëvendësuese dhe për këtë qëllim do të caktojë 2 (dy) persona të autorizuar.

Me autorizimin nr.39/153, datë 14.11.2014 të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë është ngarkuar përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor për të: "Verifikuar procedurat e aplikueshme, dokumentacionin e procedurës, ftesat e nisura në adresë të pjesëmarrësve, ofertat e paraqitura, procesin e vlerësimit, dhe çdo fazë tjetër që lidhet me shqyrtimin dhe vlerësimin korrekt të ofertuesve. I autorizuari ka të drejtë të informojë menjëherë Autoritetin Kontraktues, në rast se do të konstatojë ndonjë devijim nga procedurat apo shkelje në procesin e hartimit të dokumentacionit, vlerësimit e përzgjedhjes së ofertuesve dhe është i detyruar të mos përhap këtë informacion tek personat e tretë". Kontratat për ndërtimin e kësaj rruge (projektimi, ndërtimi dhe mbikëqyrja) janë lidhur gjatë viti 2013-2014, ndërsa përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor është caktuar në datën 14.11.2014.

Pa u miratuar, në Këshillin e Ministrave dhe në Kuvend, shtesa nr.3 e kontratës së koncesionit të sipërcituar, menjëherë, pas lidhjes së marrëveshjes në datën 05.09.2013 dhe para lidhje së marrëveshjes së datës 14.2.2014 "Për projektimin dhe tenderimin e Infrastrukturës Zëvendësuese", koncesionari, ka filluar procedurat e konkurrimit për hartimin e projektit të zbatimit të infrastrukturës që do të zëvendësohet: rruga Banja-Gramsh dhe Ura e Trashovicës, rruga Moglicë M03 dhe mbështetje projektimi për punimet në vazhdim në rrugën Moglice M15.

**Pra këto kontrata nuk janë monitoruar dhe mbikëqyrur nga Autoriteti Kontraktor. Vlera 3,972,459 euro përbën efekte negative financiare për Buxhetin e Shtetit. Trajtuar më hollësisht në Pikën 4, faqe 56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.**

**1.1. Rekomandimi:** Nga Autoriteti Kontraktor të analizohet vlera 3,972,459 euro, vlerë e cila ka të bëjë me disbursime për shpenzime të kontraktuara jo në kushtet e miratuara dhe jo të monitoruara, dhe të merren masa për tu mos u përsëritur në të ardhmen, pasi kjo vlerë për Buxhetin e Shtetit, përbën efekt ekonomik negativ.

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:** Në procesin e auditimit të shpenzimeve për rrugën M15 Moglicë u konstatua se kostot e projektimit dhe të mbikëqyrjes së punimeve nuk janë llogaritur në përputhje

me tarifat e përcaktuara në VKM nr. 444, datë 05.09.1994 "Për tarifat e studimit, drejtimin mbikëqyrjes dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit" dhe VKM nr. 704, datë 29.10.2014 Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime ne planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Këto VKM rregullojnë, llogaritjen e pagesave për të gjitha shërbimet që kryhen brenda vendit për projektimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin. Konkretisht tarifa mbikëqyrjes është llogaritur shumë më e lartë se përcaktimet e VKM nr. 704, datë 29.10.2014, e cila sipas kësaj VKM duhet të ishte në vlerën 44,043 Euro, ose rreth 0.66 % të vlerës së ndërtimit, që është 6,607,360 Euro. Theksojmë se, shpërblimi i punës projektuese dhe i punës mbikëqyrëse para vitit 2015 rregullohej, me VKM nr. 444, datë 05.09.1994, dhe më pas me VKM nr. 704, datë 29.10.2014. Këto vendime nuk kanë të bëjnë me prokurimin publik dhe nuk kanë dalë në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij apo të ndonjë akt ligjor dhe nënligjor që mund të përcaktoj rregullat të tjera e prokurimit publik, të cilat sipas pikës 3.1, të shtesës së kontratës së koncesionit të miratuar me ligjin nr. 7, datë 15.02.2015, të cilat nuk zbatohen nga Koncesionari në procesin e tenderimit të projektimit, ndërtimit, mbikëqyrjes ose shërbime të tjera ndihmëse në lidhje me Infrastrukturën Zëvendësuese. Por, këto VKM, kanë dale në zbatim të akteve ligjore që rregullojnë veprimtarinë e kontrollit dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit brenda vendit, konkretisht kanë dalë në zbatim të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit".

Pra vlerat e kontratave të projektimit dhe të kontratave të mbikëqyrjes të financuara me fonde buxhetore llogariten sipas tarifave të përcaktuara në këto akte ligjore e nënligjore dhe mbi bazën e këtyre vlerave do të vijohet me përzgjedhjen e projektuesit dhe mbikëqyrësit nëpërmjet procedurave të tenderimit të realizuara sipas rregullave të vetë koncesionarit të përcaktuar në neni 3.1 të sipërcituar. Për këtë procedurë konkurrimi, përveç dokumenteve financiar dhe kontratës së lidhur mbas miratimit të shtesës 3 të kontratës së koncesionit, në MIE nuk janë paraqitur, dokumente e procedurës së përzgjedhjes së kontraktorëve fitues për hartimin e projektit të zbatimit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, për kryerjen e shërbimit të mbikëqyrjes si dhe shkresat apo dokumente të D.H. që i ka kërkuar MIE për të konfirmuar dhe miratuar procedurat e konkurrimit dhe vlerave të ofertave përpara se ato të shpallen fitues.

-Sipas projektit dhe preventivit të zbatimit të hartuar nga projektuesi "I&S.", rruga "Banjë-Gramsh dhe Ura e Trashovicës" kishte kosto ndërtimi 30,196,554 Euro. Ndërtimi i kësaj rruge është ndarë në dy kontrata (seksione), seksioni 3A "Banja pjesa lindore e luginës së Holtës me kosto 23,702,604 Euro dhe seksioni 3B "pjesa lindore e luginës së Holtës-Gramsh plus Urën e Trashovicës" me kosto 6,493,950 Euro. Rruga është parashikuar të ndërtohet e gjerë 7 m dhe me gjatësi 15.234 km (me dy korsi të asfaltuara me gjerësi 2x2.5 m = 5 m plus dy bankina anësore të asfaltuara me gjerësi 1 m dhe me gjatësi urash 2.26 km me gjerësi 8.65 m). Projekti dhe preventivi i zbatimit me vlerë ndërtimore 30,196,554 Euro dhe është miratuar nga ARRSH me Vendimin e Këshillit Teknik nr. 66, datë 10.12.2014. Në vijim nga D.H. është realizuar procedura e tenderimit për përzgjedhjen e kontratave fituese për ndërtimin e rrugës zëvendësuese Banjë -Gramsh dhe urës së Trashovicës: -Fitues e procedurës së konkurrimit për ndërtimin e seksioni 3A rruga Banjë-Gramsh është shoqëria "A". D.H.në datën 16.12.2014 ka lidhur kontratën e sipërmarrjes me këtë shoqëri me vlerë 25,365,321.4 Euro, pa TVSH. -Fitues e procedurës së konkurrimit për ndërtimin e seksioni 3B, rruga Banjë-Gramsh përfshi edhe urën e Trashovicës është shoqëria "E.". D.H. në datën 16.12.2014 ka lidhur kontratën e sipërmarrjes me vlerë 7,346,881.5 Euro, pa TVSH. Kosto e dy kontratave fituese që do të zbatohen për të gjithë rrugën Banjë-Gramsh është 32,712,202.4 Euro. Kjo kosto është më e madhe për 2,515,648 Euro se, kosto e llogaritur nga projektuesi, para

zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe e miratuar nga ARSH që është në shumën 30,196,554 Euro, dhe justifikohet: "Bazuar në nenin 3.5 të draft shtesën 3 të marrëveshjes (e pa miratuar me ligj), D.H. me shkresën nr. 01579, datë 11. 12. 2014 i është Drejtuar Ministrit dhe Zv. Ministrit të MIE, për të miratuar koston e kontratave të negociuara të rrugës Zëvendësuese Banje-Gramsh dhe Ura e Raskovicës.

Si konkluzion: Fillimisht kosto e kësaj rruge sipas projektit të zbatimit ishte parashikuar për 30,196,554 Euro, në përfundim të procedurës tenderuese kontratat fituese u negociuan dhe u rritën në vlerën 32,7712,202 Euro dhe gjatë zbatimit të punimeve u rritën përsëri në vlerën 36,236,836, ose 20% më shumë se kosto së parashikuar në projektin e zbatimit (fondi limit).

-Në vlerën e investimit të kësaj rruge përveç vlerës së ndërtimit, shoqëria D.H. ka përfshirë edhe, punën projektuese në vlerën 2,063,264 Euro, punën mbikëqyrëse në vlerën 3,291,766 studime gjeologjike në vlerën 267,169 Euro dhe disa kosto të tjera shtesë në vlerën 1,111,175 Euro (sociale, tarifa publike, sigurimi, etj.), dhe kosto totale e investimit të kësaj rruge për tu financuar nga buxheti i shtetit është 42,970,210 Euro, Në fakt për këtë rrugë me gjatësi totale 5.234 km, kosto fillestare përpara marrjes së ofertave të tenderit, sipas shtesës 3 të kontratës të miratuar me ligjin nr. 7, datë 15.02.2015 ishin parashikuar në shumën 38,142,457 Euro, përfshirë projektimin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen dhe kostove të tjera. Siç tregohet, kosto e përcaktuar në ligj vetëm për këtë rrugë është tejkaluar me 4,827,753 Euro më shumë. Kjo rritje ka të bëjë me rritjen e vlerës së punës projektuese, punës mbikëqyrëse dhe studimeve gjeologjike, tarifat e të cilave janë përcaktuar më të larta se, tarifat e përcaktuara në VKM nr. 444, datë 05.09.1994 "Për tarifat e studimit, drejtimit mbikëqyrjes dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit" dhe VKM nr. 704, datë 29.10.2014. Llogaritja e kostonë së punës projektuese (tarifa e projektimit) dhe studimit gjeologjik: Sipas projektit dhe preventivit të zbatimit të hartuar nga shoqëria projektuese "I. & S." në vitin 2013, vlera e investimit e llogaritur me çmimet e tregut vendas në zbatimit të manualit teknik të çmimeve të vitit 2014 të miratuara me VKM për ndërtimin e rrugës ka dale 30,196,554 Euro, dhe në përfundim të punimeve, kosto e ndërtimit është rritur në vlerën 36,236,836 Euro. Mbështetur në këtë vlerë dhe bazuar në VKM nr. 444, datë 05.09.1994, për këtë kategori rruge, tarifa e projektimit të llogaritur duhet të ishte në vlerën 722,265 Euro (36,236,836Euro x 2%) dhe tarifa e studimit gjeologjik duhet të ishte në vlerë 51,660 Euro ( 36,236,836 Euro x 0.14%) në total duhet të ishin 774,285 Euro. Ndërsa puna projektuese është parashikuar për tu financuar nga buxheti i shtetit në vlerën 2,063,264 Euro dhe studimi gjeologjik në vlerën 267,169 Euro, në total në vlerën 2,330,433 Euro ose 6.43% të vlerës së ndërtimi.

**Pra në kundërshtim me VKM nr. 444, datë 05.09.1994, kosto e punës projektuese dhe e studimit gjeologjik është rritur padrejtësisht për vlerën 1,556,148 Euro (2,330,433 Euro - 774,285 Euro).**

Gjithashtu D.H. ka lidhur kontratë me shoqërinë projektuese "I. & S." në vitin 2013, në kushtet kur kjo shoqëri nuk kishte por dhe më vonë nuk ka pasur asnjë licence për projektim.

**Vlera 1,556,148 Euro përbën efekt ekonomik negativ për Buxhetin e Shtetit.**

-Dokumentacioni i procedurave të tenderimeve të realizuara nga D.H. duke filluar, me dokumentet e tenderi, ftesat për ofertë, ofertat teknike dhe ofertat ekonomike të kompanive si dhe çdo dokument tjetër që lidhet me procesin e prokurimit dhe të miratimit të kostonë, nuk u vu në dispozicion të grupit të auditimit. Ky dokumentacion është mbajtur nga vetë D.H. dhe nuk është përcjell në MIE për tu inventarizuar dhe arkivuar në Ministri.

**Në këto kushte, nuk u krye auditim, mbi ligjshmërinë e shqyrtimit, vlerësimit, kualifikimit, s' kualifikimit të ofertave teknike dhe ofertave ekonomike të shoqërive pjesëmarrëse në këto procedura tenderimi për përzgjedhjen e kontratave fituese.**

Mos vënia në dispozicion të grupit të auditimit, të dokumentacionit të tenderimit është në kundërshtim me nenin 3.5 të shtesës tretë të kontratës së koncesionit të miratuar me ligjin nr. 7, datë 15.02.2015, dhe me nenin 15 dhe 26, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe funksionimin e Kontrollin e Lartë të Shtetit". (Trajtuar më hollësisht në Pikën 4, faqe 56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

**2.1. Rekomandimi:** Nga Autoriteti Kontraktor të analizohet vlera 1,556,148 euro, vlerë e cila ka të bëjë me llogaritjen jo sipas kuadrit ligjor të kostos së punës projektuese, dhe të merren masa për të shmangur në të ardhmen, pasi kjo vlerë për Buxhetin e Shtetit, përbën efekt ekonomik negativ.

*Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Në dokumentet standarde të procedurës së zgjedhjes së operatorit fitues ishte parashikuar si kusht për zgjedhjen fitues, Tarifa e Koncesionit jo më e vogël se 2 %. Megjithëse në ofertën fituese kjo tarifë ishte 2 %, në kontratën e fundit përcaktohet mos pagesa e tarifës për 15 vjet, siç citohet në pikën 2.10, Në nenin 4.1.1. do të shtohet në fund paragrafi që vijon: ***“Pavarësisht sa më sipër, Koncesionari nuk do të paguajë Tarifën e Koncesionit sipas këtij neni 4.1.1 “a” dhe “b”, për hidrocentralin e Banjës dhe të Moglicës për një periudhë 15-vjeçare duke filluar nga data e lëshimit të Certifikatës së Përfundimit Final të Hidrocentralit të Banjës”***.

Shpjegimi i dhënë nga zv. Ministri z. I. B. ishte se heqja e tarifës së koncesionit u bë për arsye se shoqëria D. H. sh.a., mori përsipër të kryej shërbimet e tenderimit për përzgjedhjen e kontraktorëve për projektimin, ndërtimin dhe mbikëqyrjen e Infrastrukturës Zëvendësuese, duke financuar fillimisht vetë dhe më pas nga financimet e buxhetit të shtetit. Ky justifikim nuk qëndron sepse Autoriteti Kontraktor mori përsipër pagesën e kostos totale të shpenzimeve duke filluar nga viti 2015 deri në vitin 2019. Autoriteti Kontraktor nuk vuri në dispozicion vlerësimet e kryera se sa do të ishte kosto nëse projekti do të financohej me kredi nga bankat e nivelit të dytë krahasuar me variantin e financimit nga D. H. sh.a.

-Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me nenin nr. 21., të Ligjit Nr. 9663, datë 18.12.2006, i ndryshuar, “Për koncesionet”, Caktimi i ofertuesit më të mirë dhe negociimet përfundimtar, pika 2, ku citohet: ***“Kushtet kontraktuale, të deklaruara të pa-negociueshme në kërkesën përfundimtare për propozime, nuk do të jenë objekt i negociimeve përfundimtare.”***

**Përrjashtimi i pagesës së tarifës së koncesionit prej 2%, ka sjellë të ardhura të munguara për Buxhetin e Shtetit në vlerën 5,119,000 Euro deri në gusht 2022.** (Trajtuar më hollësisht në Pikën 1, faqe 23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)

**3.1. Rekomandimi:** Nga Autoriteti Kontraktor të analizohet vlera 5,119,000 euro, vlerë e cila ka të bëjë me përrjashtimin e pagesës së tarifës së koncesionarit nga shoqëria D. H. sh.a., pasi kjo vlerë për Buxhetin e Shtetit, përbën të ardhura të munguara.

*Menjëherë*

## C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit teknik sipas kontratës së punimeve civile “Rikonstrukcion i segmentit 3B (Drizë-Gramsh)”,rezulton se janë realizuar punimet për rialokimin e linjave elektrike dhe tubacione të ujit. Vlera e parashikuar sipas zërit 1.A.10, ishte 40,000 Euro, e cila gjatë zbatimit të kontratës është shtuar duke e certifikuar me vlerë 95,947.9 Euro. Për realizimin e punimeve janë hartuar preventivat përkatës. Në preventiv janë përfshirë edhe furnizim

vendosje shtylla betoni të centrifuguara, reference e të cilëve janë dhe në manualët e çmimeve të ndërtimit. Nga krahasimi i vlerave përkatëse rezulton se **vlera 376,445 lekë ose 2,690 Euro**, është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori J. “E. & P.” SHPK dhe përbën dëm ekonomik.

Nga verifikimi i punimeve sipas zërit 8 “Ditë pune”, për periudhën nga data 06.01.2016 deri me datë 11.01.2016, ku është paraqitur marrja e masave mbrojtëse dhe realizimi i devijimit në dëmtimin e rrugës nga kilometër 13+ 880 deri kilometër 13 + 910, në dokumentin justifikues (format excel), është paraqitur shënimi se ruli nuk punoi, por ishte prezent gjithë ditën. Në dokumentacionin justifikues nuk është paraqitur asnjë foto e realizuar gjatë zbatimit të punimeve. **Vlera 5,960 Euro** (Rrul 70 orë x 30 Euro/orë, gjenerator 66 orë x 40 Euro/orë, vinç 6 orë x 75 Euro/orë), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.

- Për datat 05.09.2016 dhe datë 21.09.2016, janë përfshirë në ditë pune punëtorë të pa kualifikuar 46 orë, punëtorë të kualifikuar 12 orë, drejtues punimesh 14 ore dhe teknikë 3 orë, po ashtu edhe mjet transporti 6 orë, me vlerë 854 Euro. Procesi i punimeve ka të bëjë me riparim defektesh në shtresat asfaltike, punime të cilat janë në përgjegjësinë e kontraktorit.

**Vlera 854 Euro**, është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori dhe përbën dëm ekonomik.

-Sipas zërit 5.H.05 “Metal bridge parapet”, punime të raportuara në Urën e Drashovicës, është certifikuar sasia 131 ml. Nga verifikimi në objekt nuk rezultojnë punime të tilla. Në urë janë ndërtuar vetëm guardrail tip H3, në të dy anët e rrugës dhe nuk është parashikuar dhe rrjedhimisht ndërtuar kalim për këmbësorët, duke vënë në rrezik kalimin e tyre.

**Vlera 3,720 Euro** (62 ml x 60 Euro/ml), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori J. “E. & P.” SHPK dhe përbën dëm ekonomik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kontratën F., pika 12.2. (*Trajtuar më hollësisht në Pikën 2, faqe 36 Raportit Përfundimtar të Auditimit.*)

**1.1. Rekomandimi:** Nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **13,494 Euro**, nga Kontraktori J. “E. & P.” SHPK, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit të dokumentacionit justifikues për rimbursimet e kryera u konstatua se shoqëria D. H. sh.a., ka vendosur në situacione kosto për shpronësime të truallit si dhe shpenzime sociale dhe ambientale. Në shkresën e D.H., dërguar MIE, datë 31.01.2019, për rimbursimin e kështit të fundit, janë paraqitur si kosto të akumuluar dhe të kërkuara për rrugën zëvendësuese Banjë Gramsh dhe ura e Trashovicës në vlerën 282,316 Euro, dhe për rrugët zëvendësuese të Moglicës 102,626 euro, në total vlerën 384,942 Euro.

Në lidhje me shpronësimet e truallit Këshilli i Ministrave ka nxjerrë VKM nr. 674, datë 15.10.2014, “Për shpronësimin, për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Gramsh-Lozhan”, me vlerë totale 2,726,182 lekë, e cila do të rimbursohet nga D.H., VKM nr. 285, datë 13.4.2016 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “hidrocentrali i Banjës - Gramsh dhe ura e Trashovicës”, me vlerë 30,929,985 lekë, të cilat do të përballohen nga buxheti i shoqërisë D. H. dhe VKM nr. 464, datë 26.7.2018,” Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rrugët zëvendësuese M03 për ndërtimin e hidrocentralit të Moglicës” me vlerë prej 4,780,005 lekë.

**Duke qenë se në VKM e sipërcituara përcaktohet qartë se shpenzimet e shpronësimeve kryhen nga shoqëria D. H., si dhe nga konstatimet që në dokumentet justifikuese nuk janë paraqitur fatura ose dokumente për shpenzimet sociale dhe ambientale, vlera 384,942 Euro përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.** *(Trajtuar më hollësisht në Pikën 4, faqe 56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)*

**2.1. Rekomandimi:** Nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykitimit, arkëtimin e vlerës **384,942 Euro**, nga Koncesionari D. H. Sh.A., pasi kjo vlerë për Buxhetin e Shtetit, përbën shpenzime jo të justifikuara të fondeve publike.

*Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Në kërkesën e bërë për rimbursime të shpenzimeve të kryera në periudhën Janar - Qershor 2015 nga shoqëria D. H. sh.a, u konstatua zëri kosto supervizimi dhe menaxhimi për rrugën Banjë Gramsh, sektorët 3A dhe 3 B, dhe ura e Trashovicës, me një total prej 631,330 Euro. Pagesa është kryer për 15 specialistë, që renditen nga specialistë të kualifikuar, ekspertë, në punonjës të huaj të rajonit si dhe në punonjës të huaj ndërkombëtarë. Për të parët pagesa orare është 25 euro, ekspertët 40 euro, më pas 100 euro dhe për punonjësit e huaj 250 euro në orë. Në total janë një punonjës i huaj ndërkombëtar i cili ka punuar 821 orë dhe ka marrë 205,250 euro, tre punonjës të huaj të rajonit të cilët kanë punuar 2175 orë dhe janë paguar 217,500 euro.

Për sa më sipër në dokumentet justifikuese nuk janë paraqitur proceset e punës të kryera, kualifikimet dhe licencat që vërtetojnë se ishin të aftë për të kryer punët e kërkuara, llogaritjet e orëve së punës për person bazuar në pagën përkatëse dhe shpenzimet e përgjithshme administrative të dokumentuara nga analizat e kostove të shpenzimeve të përgjithshme administrative.

Për sa më sipër është në kundërshtim me aneksin V të Kontratës së Koncesionit (e ndryshuar me Shtesën e 3-të të Kontratës së Koncesionit), ku janë caktuar dokumentet që duhet ti paraqiten Autoritetit Kontraktues për Kostot e Infrastrukturës Zëvendësuese të kryera, pika 8 ku citohet: *“Dokumentacion nga Shoqëria e Projektit për kostot e veta në lidhje shpenzimet për mbikëqyrje/menaxhim të kontratave. Këtu përshihen dietat dhe shpenzimet e lidhura me kryerjen e punës dhe kostoja për ore pune e personelit e dokumentuar nga përshkrimi i punës i punëmarrësit. Kosto e orës së punës për person do llogaritet bazuar në pagën përkatëse dhe shpenzimet e përgjithshme administrative të dokumentuara nga analizat e kostove të shpenzimeve të përgjithshme administrative.”*

**Vlera prej 631,330 Euro përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit.** *(Trajtuar më hollësisht në Pikën 4, faqe 56 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.)*

**3.1. Rekomandimi:** Nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykitimit, arkëtimin e vlerës **631,330 Euro**, nga Koncesionari D. H. Sh.A., pasi kjo vlerë për Buxhetin e Shtetit, përbën shpenzime jo të justifikuara të fondeve publik.

*Menjëherë*

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja.*



## **SHKURTIME**

<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave
<b>APP</b>	Agjencia e Prokurimit Publik
<b>TVSH</b>	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
<b>KVO</b>	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
<b>NJP</b>	Njësia e Prokurimit
<b>AK</b>	Autoriteti Kontraktor
<b>LPP</b>	Ligji i prokurimit publik
<b>RRPP</b>	Rregullat e prokurimit publik

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**